



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT  
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 1838/6 Prot.

Tiranë më 07.04.2026



**Lënda:** Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit

**Drejtuar:** DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE

**TIRANË**

*E nderuar Zj. Bollano,*

Në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, dhe në përfundim të angazhimit të auditimit “Angazhim për Shërbimet e Sigurisë/I kombinuar” nr. 1838/2 prot, datë 04.12.2025, për periudhën 17.01.2024-31.10.2025, është kryer auditimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI), bashkëlidhur kësaj shkrese ju dërgojmë Raportin Përfundimtar të Auditimit, Aneksi nr. 1 “Përmbledhëse e Rekomandimeve”, Aneksi nr. 2 “Observacionet”, Plan Veprimi i sugjeruar, të cilët janë edhe përfundimi i angazhimit të auditimit në Institucionin Tuaj.

Gjithashtu, ju informojmë se duhet të hartoni, firmosni dhe dërgoni pranë Njesisë së Auditimit të Brendshëm, Planin e Veprimit të miratuar nga ana juaj jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga marrja e raportit përfundimtar.

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve, si dhe të njoftojë me shkrim Njësinë e Auditimit të Brendshëm mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, periodikisht dhe deri në fund vitit kalendarik.

Ju faleminderit për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin e treguar gjatë procesit të auditimit.



**DREJTORI**

**Elida Sokoli**

Nr.kopjeve 3

Adresa: Rruga “Dëshmorët e 4 shkurtit”, Tiranë [www.ekonomia.gov.al](http://www.ekonomia.gov.al); email: [info@ekonomia.gov.al](mailto:info@ekonomia.gov.al)

**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI****Për auditimin e kombinuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale****I. Përmbledhje ekzekutive**

Angazhimi i auditimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale u krye në mbështetje të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, të ndryshuar, në zbatim të planit vjetor të auditimeve 2025 të miratuar nga Ministri me nr. 12908/1 prot, datë 18.10.2024, si dhe Programit të Angazhimit të Auditimit miratuar nga Drejtori i DAB-së me shkresën nr. 1838/2 prot, datë 04.12.2025.

Sistemet e identifikuara objekt auditimi për periudhën 17 Janar 2024 - 31 Tetor 2025 për subjektin e auditimit Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale janë:

1. Funksionimi i komponentëve të kontrollit të brendshëm; Vlerësimi i përputhshmërisë në funksionimin e strukturave të DPPI-së, lidhur me objektivat, regjistrimin, administrimin, trajtimin, analizës, ekzaminimit dhe promovimin objekteve të pronësisë industriale për vitin ushtrimor 2024 -2025.
2. Programi i zhvillimit ekonomik dhe efektiviteti i menaxhimit financiar;
3. Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore;
4. Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore;
5. Sistemi i prokurimeve të fondeve publike;
6. Sistemi i pagesave;
7. Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar, duke përfshirë edhe auditimin e detyrimeve të prapambetura dhe menaxhimin e aktiveve;
8. Vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, etj.

**Gjetjet dhe konkluzionet**

**Funksionimi i komponentëve të kontrollit të brendshëm; Vlerësimi i përputhshmërisë në funksionim e strukturave të DPPI-së, lidhur me objektivat, regjistrimin, administrimin, trajtimin, analizës, ekzaminimit dhe promovimin objekteve të pronësisë industriale për vitin ushtrimor 2024 -2025**

-Mungesa e informacionit shtesë për kthimin e dy projektligjeve të përgatitura nga stafi i DPPI-së, në dy ligje të veçanta sipas kushtetutës dhe miratimin me vendim të rregulloreve të përshtatur si të BE-së në fushën e treguesve gjeografik dhe emërtimeve të origjinës si dhe disenjos, ligje të cilët

japin ndikim pozitiv në përmbushjen e objektivave dhe rritjen e të ardhurave të institucionit dhe marrëdhënieve me pronarët dhe mbrojtjen ligjore të tyre, lidhur me pronësinë industriale.

Ligji ekzistues për treguesit gjeografik dhe emërtimeve të origjinës si dhe dizenjot ka një rregullim të përgjithshëm dhe sipërfaqësor me një numër i kufizuar dispozitash, ndersa projektligji i ri i përgatitur nga stafi i DPPI-së në bashkëpunim me ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë si dhe me organizata ndërkombëtare, do të sjelli një varg përmirësimesh të rëndësishme në përmbajtjet e dispozitave dhe një rregullim më të gjerë dhe më të saktë të treguesve gjeografik, emërtimeve të origjinës dhe dizenjot, si dhe siguron një interpretim dhe zbatim më të mirë të këtyre dispozitave, për të cilët duhet të kthehet në ligj dhe shoqërimin me rregullore përkatëse për Dppi-në, për arsye të përmirësimeve në disa aspekte nga ligji ekzistues.

-Vlen të theksohet se stafi i institucionit ka bërë një interpretim dhe një punë të mirë të dy projektligjeve, në bashkëpunim me ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë si dhe është konsultuar me organizata ndërkombëtare ku Shqipëria është anëtare në këtë fushë dhe përfaqësohet nga DPPI, si dhe është bazuar kryesisht edhe në paketën e re për disenjot (*EU Design Legislative Reform Package*) e cila daton në Nëntor 2024. Duke qenë se këto dy projektligje, presin të miratohen në ligje dhe bëjnë pjesë dhe në piketat përmbyllëse të kapitullit VII “Pronësia Intelektuale” me BE dhe ku nga ana e DPPI për pjesën që i përket Pronësisë Industriale është drejt përfundit dhe pritët që kapitulli VII me realizimin e këtyre angazhimeve të jetë nja nga kapitujt e parë që mbyllet dhe realizon me sukses për objektivat e marra nga Qeveria Shqiptare për përfundimin e këtij procesi, prandaj stafi duhet të ndjeki dhe të përmbylli punën me miratimin e dy ligjeve të shoqëruar me rregullore përkatëse, për të realizuar funksionimin më të mirë dhe zbatimin e objektivave të institucionit.

U konstatua nga grupi i auditimit se jo të gjitha aplikimet që vijnë nëpërmjet sistemit unik qeveritar e-albania nga shërbimet on-line që ofron Dppi, në përfundim të trajtimit të dosjes, nuk janë të fizikisht në protokoll në formatin Hardkopi, por janë vetëm në sistemin elektronik, por institucioni nuk dispononte ambiente dhe burime njerëzore të mjaftueshme për protokollim dhe arshivim të një numri të lartë aplikimesh për vitin 2024 prej 5019 aplikime dhe viti 2025 prej 5473 aplikime.

#### Më gjerësisht jemi shprehur në pikën IV. 1 të Raportit

#### Programi i zhvillimit ekonomik dhe efektiviteti i menaxhimit financiar

-Gjatë periudhës së audituar konstatohet mosrealizim dhe realizim mjaft i ulët në shpenzimet korrente, të akorduara për kryerjen e shpenzimeve të projekteve; si dhe mosrealizim në fondin e shpenzimeve kapitale të përcaktuara dhe të transferuara gjatë muajit dhjetor 2024. Mungesa e realizimit të fondeve të akorduara për kryerjen e shërbimeve dhe projekteve në art. 602/5 e art. 231/1, dhe realizimi i ulët në art. 605 dhe 602/1, nuk ka siguruar përmbushjen e objektivit institucional, për realizimin e fondeve buxhetore, të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

-Mungesa e informacionit shtesë për parashikimin e realizimit të pritshëm deri në fund të vitit për produktet dhe për shpenzimet, krijon mosrealizim të objektivave dhe qëllimit të programit ekonomik të shoqërisë për vitin 2024. Nuk kanë të argumentuar që realizimi mundet të jetë i njëjtë me planin fillestar, ose më i madh ose më i vogël se sa plani aktual, nga mungesa e raportimit të monitorimit të 8-mujorit 2024 dhe 2025, të buxhetit të siguruar nga të ardhurat e krijuara nga shërbimet e ofruara.

#### Më gjerësisht jemi shprehur në pikën IV. 2 të Raportit

### Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave të DPPI-së

Këshillojmë, regjistrimi i të ardhurave të krijuara nga tarifat në kontabilitet të bëhet sipas subjekteve aplikues dhe të rritet bashkëveprimi midis sektorëve të financës dhe buxhetit me sektorët e ekzaminimit për të bërë të mundur verifikimin e pagesave të kryera nga aplikantët në kohë reale me qëllim shmangien e deklaramit të pagesave jo të rregullta nga aplikuesit në e-albania.

Në vijimësi institucioni të komunikoj me administratën tatimore për mënyrën e deklaramit të të ardhurave të krijuara nga ana e tyre dhe raportimin nëpërmjet faturimit elektronik në platformën e fiskalizimit.

### Më gjerësisht jemi shprehur në pikën IV. 3 të Raportit

#### Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore

-Rekrutimi i punonjësve është kryer pa shpallje të vendit të lirë të punës në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe faqen zyrtare të institucionit; punonjësit janë marrë në punë me kontratë të përkohshme, duke shmangur procesin e konkurimit dhe sjellë si pasojë mos sigurimin e transparencës dhe konkurrencës gjatë punësimit të punonjësve në DPPI. Regullorja e brendshme nuk ka përcaktuar saktë procedurën e punësimit për punonjësit me arsim të lartë, dhe punonjësit mbështetës me arsim të mesëm, në lidhje me zhvillimin e procedurës së konkurimit dhe emërimit të punonjësve.

- Struktura përgjegjëse e dppi-së, nuk i është përmbajtur rregullave të hollësishme të procedurave dhe të administrimit të dosjeve të personelit e të regjistrimit të tyre në regjistrin qendror të personelit, nga auditimi u vërejtën disa mangësi të dokumentacionit, dosjet e personelit janë jo në përputhje, me të gjitha kërkesat e e legjislacionit në fuqi (dosjet e punonjësve me kontratë përkohshme). Mbi këtë bazë të bëhet rifreskimi i dokumentacionit dhe inventarizimi i saktë me përfshirjen e dokumenteve të tjera.

- Nga auditimi i regjistrimit aktev të dosjeve (emërime, urdhra, largime, etj) në regjistrin themeltar të personelit (libri themeltar), u konstatua ato janë regjistruar nga punonjësi i ngarkuar për personelin, por regjistri qendror i personelit, nuk është i protokolluar në protokollin e institucionit, për numrin rendor dhe total të faqeve që ka regjistri themeltar i punonjësve. Protokollimi sipas numrit rendor dhe total të faqeve të regjistrimit, jep siguri dhe nuk lejon ndërhyrje në regjister, ndryshime apo falsifikime të akteve të prodhuara të regjistruara për punonjësit në vite. Regjistrimet në platformën e bashkëpunimit të RQP-së nën adminstimin e DAP-it, funksiononte për raportimin e zhvillimin/menaxhimin e proceseve të burimeve njerëzore, i cili ndiqet nga punonjësi i personelit të institucionit. Dokumentacioni i dorëzuar nga kandidatët e interesuar për pozicionet vakante nuk është protokolluar nga punonjësi i ngarkuar me mbajtjen e protokollit në këtë institucion, *për asrye se dokumentat kanë kaluar menjëherë tek personeli*. Në këtë mënyrë jo vetëm që nuk respektohen normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në RSH, por nuk mund të verifikohet edhe përbushja e afatit të dorëzimit të dokumentacionit, sipas përcaktimeve përkatëse. Në këtë mënyrë nga ana institucionale nuk jepet siguri që të gjithë kandidatet i kanë dorëzuar dokumentet dhe janë marrë në punë pa konkurim nga strukturat përgjegjëse, duke shmangur konkurrencën dhe transparencën. Në rekrutimin e punonjësve me kontratë të përkohshme (G.V; A.B; F.L; D.M; F.XH; E.R; N.N; R.G; M.T, etj), janë marrë pa procedurë konkurimi, ku

duhej bërë njoftimi në institucion dhe në buletin e njoftimeve për pozicione pune, për të shprehur interesë dhe kandidatë të tjerë të interesuar për pjesëmarrje në rekrutim, për një vend vakant duhet të dorëzojnë pranë zyrës së protokollit të Institucionit dokumentat e kërkuara.

- Pagesa për punonjësit me kontratë të përkohshme është e pajustificuar dhe e parregullt, pasi nuk plotëson kriteret ligjore të Kodit të Punës dhe nuk mbështetet në kontratat e lidhura, pasi në listepagesen e muajit maj 2024 janë përfshirë dhe punonjësit me kontratë të perkoshme në punë për vitin 2024 dhe për 10 mujorin 2025. Pra rezulton se ka shkelje të vendimit të këshillit Mbikqyrës të pikës 1 të vendimit, duke krijuar pagesë mbi limitin e miratuar.

U konstatua, shkelje e kushteve të VKM nr. 795/2023 për shpërblimin në procesin e shqyrtimit të Acquis (integritet në BE), duke krijuar pagesë pa u bazuar në dokumentet e duhura. Gjithashtu kontratat për këshilltarë të jashtëm, nuk kanë respektuar dispozitat e VKM nr. 325/2023, të ndryshuar. Kontratat e lidhura nr. 534 prot, datë 07.02.2025 për D.M dhe nr. 535 date 07.02.2025 per D.XH, neni 7 dhe neni 8 janë hartuar jo në përputhje me VKM nr. 325 e cila sqaron se pagesa e tyre behet nga llogaria ekonomike sipas udhezimit te ministrit pergjegjës për financat (llog.602) dhe si rrjedhim nuk derdhen kontribute të sigurimeve shoqerore.

#### Më gjerësisht jemi shprehur në pikën IV. 4 të Raportit

#### Sistemi i prokurimeve të fondeve publike

-Komisioni i blerjeve të vogla në procedurat e realizuara nën dhe mbi 100,000 lekë, nuk ka kryer testim të tregut dhe nuk ka të dokumentuar treguesit e çmimeve në një procesverbal, mbi bazën e të cilit përcaktohet edhe fondi limit i blerjes së mallit apo shërbimit në procedurat e prokurimit, por komisioni çmimet e artikujve i ka hedhur drejtëpërdrejtë në çdo rast blerje në procesverbalin e specifikimeve, duke kryer nga zyra edhe përlllogaritjen e fondit limit, kur në fakt fondi limit merret i gatshëm nga procesverbali i testimit në treg për blerjet e vogla, i cili i bashkëlidhet procesverbalit të specifikimeve teknike dhe të përgjithshme në procedurat e blerjeve.

- Gjatë auditimit të blerjeve të vogla dhe nga verifikimi i procedurave lidhur me fazën e hapjes së ofertave nga kvo -ja u konstatua se në disa procedura personi përgjegjës për prokurimin nuk ka qenë i pranishëm, për të kryer funksione të karakterit ndihmës. Komisioni i vlerësimit të ofertave për të gjitha blerjet e vogla, *nuk ka mbajtur "Raportin Përmbledhës" siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore për prokurimet*, që do trajtohen në gjetjen vijuese.

- Të gjitha furnizimet nga blerjet e vogla, të zhvilluara gjatë vitit 2024- 10-mujori 2025, janë marrë në dorëzim me procesverbal "Për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve", të nënshkruar nga komisioni në të gjitha furnizimet e kryera, por marrja në dorëzim e mallrave nuk është kryer në mënyrë analitike, për çdo artikull zë për zë dhe sipas specifikimeve dhe kushteve teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë dhe kushtet e kontratës. Marrja në dorëzim rezultoi jo i plotë dhe formal, procesverbalet e marrjes në dorëzim (ose të kryerjes së shërbimit), nuk janë të mbështetur në aktet ligjore, nënligjore dhe urdhërit të brendshëm, sipas kushteve të kontratës në sasi, cilësi, lloji, specifikimet, etj, gjë për të cilat ka munguar në procesverbalet e mbajtura nga komisioni duke u shprehur me një format modeli të njëjtë.

-Marrja në dorëzim e mallrave dhe shërbimeve nga operatorët ekonomik fitues, të bëhet sipas përcaktimeve të specifikimeve teknike në ftesën për ofertë dhe kushteve të kontratës, nga komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave.

-Nëpunësi zbatues, përgjegjësi i financës dhe komisioni i pritjes së mallit, duhet të përditësohen me përcaktimet e akteve ligjore/nënligjore në fuqi; veçanërisht me aktet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollin, si dhe në fushën e menaxhimit të aktiveve në njësitë e sektorit publik.

- Nga auditimi i procedurave të prokurimeve të vogla rezulton se dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti kontraktor në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë respektive, nuk është dorëzuar me procesverbal nga operatori ekonomik fitues në Zyrën e Protokollit të DPPI, ato janë dorëzuar pa procesverbal mbi dorëzimin e dokumenave nga OE. Komisioni i blerjeve të vogla nuk është përditësuar me përcaktimet në udhëzimin për blerjet me vlera të vogla, të ndryshuar, për të krijuar një praktike më të mirë në drejtim të këtyre procedurave. Mungesa e protokollimit të këtyre dokumenteve me procesverbal, nuk jep siguri se operatori ekonomik i shpallur fitues i ka dorëzuar gjithë dokumentet e kërkuara sipas përcaktimit në Ftesën për Ofertë.

- Proçedurat e prokurimit me vlerë të vogël, zhvilluar gjatë periudhës 2024- 10/M/2025, janë administruar në dosje të veçantë nga njesia e prokurimit, por pa i arkivuar, sipas përcaktimeve në normat tekniko profesionale të shërbimit arkivor në RSH. Madje jo gjithë dokumentet e përgatitura gjatë procedurave të prokurimit janë protokolluar, siç është ftesa për ofertë e përgatitur nga njesia e prokurimit, në asnjë rast nuk është me nr. protokollit dhe datën e saj.

- Nga auditimi i projektit mbi studimin, identifikimin dhe nxitja e regjistrimit të treguesve gjeografik u konstatua se, komisioni i mbajtjes dhe përgatitjes së raporteve të monitorimit, ka realizuar nga data 4 shtator deri 16 tetor 2025 janë mbajtur 8 (tetë) raporteve të monitorimi, nga të cilët në shtatë raste ka devijime të takimeve përfundimtare me ato të projektuara me palëve sipas dokumenteve standart dhe aneksit 1 të kontratës së nënshkruar mes Subjektit “Optima Communication” shpk dhe DPPI-së, pa dhënë dakortësinë e ndryshimeve, pra nuk janë zbatuar dhe realizuar në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në DS dhe Aneksin 1 të kontratës. Gjatë takimeve të realizuara në kuadër të këtij projekti rezultoi se, zonat e prefekturës së Dibrës kanë shfaqur interes si sipërmarrës, prodhues të ndryshëm të zonave për traditat, natyrën dhe pasuritë autentike për zhvillimin prodhimit, lidhur me treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës, si dhe rendësinë e regjistrimit të subjekteve pranë DPPI-së.

U konstatua se raport monitorimi nr. 3493/10 prot, datë 21.10.2025, është mbajtur jashtë afatit 2 mujor të kontratës së shërbimit, në kundërshtim me nenin 22 “Zgjatja e kontratës”, ndersa aktiviteti përfundimtar është kryer më datë 21.10.2025, subjekti pa dorëzuar shërbimin e projektit ka prerë faturën elektronike më datë 17.10.2025 me nr. 99 (dy ditë më përpara), likujdimi i faturës është kryer më datë 24.10.2025. Rezultoi mospërputhje me nenin 15 “Dëmet e likujduara” për kryerjen e vonuar të vlerës së mbetur 470,400 lekë, duke krijuar penalitet për 4 ditë, dhe mungesë magazinimi të materialeve të pa përdorura, ngarkon me përgjegjësi strukturat e DPPI-së, si dhe për demin ekonomik të krijuar në total 153,626 lekë me tvsh, do ç’dëmtohet nga OE “Optima Communication” shpk Tiranë.

Projekti i realizuar në vlerën 4,244.000 lekë me tvsh, nuk ia ka aritur qëllimit, lidhur me krijimin e identifikimin, nxitjen dhe regjistrimin të treguesve gjeografik në zonat e përcaktuara në DST, pra në opinionin e audituesit rezulton se nuk ka dhënë produktin final dhe nuk ka informacion të detajuar si:

*Kryerja e një analize të tregut për evidentimin e bizneseve/grupeve të prodhuesve potencial për regjistrimin dhe mbrojtjen e objekteve të PI, kryesisht të treguesve gjeografik.*

*Mungesa e një informacioni për dokumentacionin e regjistrimit të shoqatave prodhuese në qarkun e Dibrës, etj.*

Mbi këtë bazë, investimi i këtij projekti të realizuar gjatë vitit ushtrimor 2025, nuk është menaxhuar në përputhje me të dhënat e DST dhe me zbatimin e kushteve të kontratës së lidhur midis palëve.

- Nga auditimi dhe analiza e situatës së paraqitur në proçedurën me objekt “Shërbime për panairin “Promovimi i Treguesve Gjeografikë dhe Kulturës Shqiptare” në Gjenevë (SIDE EVENT)”, konstatohet, mungesa e duhur e zbatimit të kontratës dhe monitorimit të saj, si dhe marrjes në dorëzim të shërbimit dhe pagesë pa dokumente justifikues, të realizimit të kontratës nr. 1592/11,

datë 11.06.2025, Gjithashtu rezultoi se mungojnë dokumente si relacion përmbledhës, proces verbal marrjeje në dorëzim, akt dorëzimi stende/materialësh, proces verbal për produktet ushqimore dhe materiale promocionale të mbetura), si dhe pagesa të parakohshme dhe jo në përputhje me afatet kontraktuale, monitorim me nënshkrim fiktiv, ka krijuar efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit në vlerën e paktën **6,331,980 lekë**. Veprime të cilët ngarkojnë me përgjegjësi, strukturat përgjegjëse të autoritetit kontraktues (AK).

- Proçedurat e prokurimit me vlerë të vogël, zhvilluar me proçedurë elektronike gjatë periudhës së audituar nuk janë administruar në dosje të veçantë të sistemuar me gjurmë auditi, e më pas nuk janë arkivuar, sipas përcaktimeve në normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në RSH. Madje jo gjithë dokumentet e përgatitura gjatë procedurave të prokurimit janë protokolluar.

Personi përgjegjës për prokurimin dorëzon gjithë dokumentet e procedurës së prokurimit te nëpunësi zbatues, nëpërmjet një procesverbali, i cili evidenton dokumentacionin e dosjeve dhe nënshkruhet nga dy palët.

Procesverbali ndër të tjera përmban edhe inventarizimin e gjithë dokumenteve të dorëzuara, pra emërtimin, njësinë dhe sasinë e fletëve.

Pra, gjithë dokumentacioni i procedurave të prokurimit administrohet në Sektorin e Financës (bashkëlidhur çdo urdhër shpenzimi) dhe administrohet në arkivën sektorit juridik (përgjegjesi i sistemit të App-së), dhe jo dokumentuar çdo dosje prokurimi me protokoll në Arkivën e Institucionit.

Nuk mund të administrojë nëpunësi zbatues dhe nëpunësi përgjegjës për sistemin të gjithë dosjen e procedurave të prokurimit, sepse është përcaktuar në udhëzimin e MFE se çfarë dokumentesh justifikuese duhet të përmbajë bashkëlidhur çdo urdhër shpenzim.

-Të administrohen në një dosje të veçantë dokumentet e procedurës së prokurimit për prokurimet elektronike, dosje të cilat duhet të arkivohen për llogari të çdo viti ushtrimor. Të mundësohet trajnimi i punonjësve të komisionit të blerjeve të vogla dhe punonjësit të ngarkuar me detyrën e sekretari-arkivit.

#### **Më gjerësisht jemi shprehur në pikën IV. 5 të Raportit**

##### **Sistemi i pagesave**

-Regjistrimi i shpenzimeve financiare dhe faturave të operatorëve ekonomik (OE), jo në përputhje me normat dhe parimet e përgjithshme për mbajtjen kronologjike të kontabilitetit, gjatë veprimtarisë ekonomiko-financiare të vitit ushtrimor 2024 deri në 10 mujin 2025, ndikon në mosidentifikimin e veprimeve të gabuara dhe në krijimin e risqeve të reja, si dhe ka ndikim në treguesit e performancës për kontabilitetin.

- Për periudhën e audituar Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues si dhe përgjegjësi i financës kanë krijuar detyrimeve të prapambetura (mbartur fatura për likuidim në vitin pasardhës), nuk kanë marrë masa lidhur me paraqitjen pranë BKT-së Tiranë, të faturës origjinale të OE dhe dokumentacionit justifikues të shpenzimeve, brenda afateve të përcaktuara ligjore. Gjatë vitit ushtrimor ka munguar respektimi i disiplinës financiare dhe përgatitjes së urdhër shpenzimit për likuidim, nuk është respektuar afati i likuidimit të shpenzimit prej 30 ditë, pas lëshimit të faturës tatimore origjinale të operatorit ekonomik.

#### **Më gjerësisht jemi shprehur në pikën IV. 6 të Raportit**

##### **Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar, duke përfshirë edhe auditimin e detyrimeve të prapambetura dhe menaxhimin e aktiveve**

-Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura për vitin 2024 dhe 10 mujori 2025, u konstatua se drejtorja e financës nuk ka kryer në kohën e duhur pagesat për mbulimin e detyrimit ndaj EPO-S (Zyra europiane të patentave) shuma 39,892,000 lekë dhe Fastech shpk shuma 1,879,400 lekë, si dhe penalitete për mos përmbushje të marrëveshjes mes palëve (DPPI dhe EPO) shuma 463,731 lekë, në total **42, 235,131 lekë**, rezultuan të pa kontabilizuara për detyrime ndaj të tretëve.

Detyrimi për tre faturat e palikujduara me fondet e vitit 2024, ngarkon fondet buxhetore të vitit 2025. Situata është krijuar si rezultat i moskoordinimit të veprimeve mes Titullarit dhe Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve në DPPI, ka dhënë efekt financiar: Dëm ekonomik në vlerën 463,731 lekë, për pagesë penaltitësh për shkak likuidimi me vonesë të tre faturave të vitit 2024, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, duke çuar në akumulim të detyrimeve të faturave të dërguara nga EPO në vlerën totale 39,892,000 lekë, kjo e konstatuar sipas Urdhër Transfertës datë 22.07.2025 në BKT, likujduar fatura Invoice nr. 2000050, datë 15.05.2025 vlera 463,731 lekë, e paguar si penaltitet të vonuar, si rezultat të moszbatimit të marrëveshjes të lidhur mes DPPI dhe EPO, të faturave datë 30.04.2024, datë 31.07.2024, datë 31.10.2024 (153,173 lekë, 210,891 lekë dhe 9,668 lekë). Gjithashtu sipas kontratës nr. 26, datë 01.09.2022 “Për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të informacionit dhe implementimin e tij”, nuk është likujduar fatura e shërbimit datë 01.07.2025 për shërbimet e mirëmbajtjes së sistemit, në shumën 1,879,400 lekë, si dhe nuk është raportuar si detyrim të prapambetur për 9 mujorin 2025.

Veprimtaria financiare e DPPI-së, nuk është në përputhje të plotë me kërkesat ligjore për regjistrimin, raportimin dhe pagesën në kohë të detyrimeve. Kjo situatë tregon mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm financiar të institucionit, duke rezultuar në humbje financiare të shmangshme. Audituesi vlerëson se kontrolli i brendshëm është joefektiv në këtë aspekt, me nivel rreziku deri të lartë, duke kërkuar përmirësime të menjëhershme për të shmangur përsëritje, të dëmit ekonomik të shkaktuar buxhetit të DPPI-së për periudhën e audituar, në vlerën 463,731 lekë.

- Nga auditimi për vitin 2024 dhe 10 mujori 2025, u konstatua se fletë-udhëtimet nuk janë mbajtur nga shoferi, lëvizjet janë të nënshkruar nga nëpunësi udhëtues në një libër pa protokoll dhe pa të dhenat e kilometrave dhe normën e konsumit. Për të gjitha lëvizjet e kryera brenda dhe jashtë rrethit (nën dhe mbi 100/km), nuk ka fletë udhëtime të plotësuar për datë nisje dhe datë kthimi, as kolona nëpunësi urdhërues ku të nënshkruajë për lëvizjen e punonjësve, gjithashtu të dhënat në fund të çdo muaj mbi konsumin e karburantit nuk janë plotësuar (gjendja, furnizimi, norma e mjetit, diferenca në fund të muajit). Për nevoja pune lëvizjet jashtë rrethit nuk janë shoqëruar me autorizim të titullarit. Furnizimi i mjetit me karburant nuk është i dokumentuar me pamjet filmike për datat e furnizimit të printuar nga personi që administron paketën elektronike të kompanisë furnizuese dhe nga shoferi nuk është terhequr kuponi tatimor sipas furnizimit për çdo rast në pikat e karburantit të OE “Gega Oil” shpk për të rakorduar me datat sipas historikut të furnizimeve që printohet nga paketa elektronike e kompanisë. Nga drejtorja e financës dhe shërbimeve, nuk është bërë përcaktimi i normës së konsumit të karburantit, prandaj duhet të rishikohet dhe të ngrihet komision për të bërë përcaktimin e ri të normës së konsumit të automjetit.

- Për periudhën e audituar rezultoi se fletëhyrjet dhe fletëdaljet e aktiveve dhe materialeve janë hartuar sipas rendit kronologjik dhe pa korrigjime. Aktivitetet dhe materialet në magazinë janë dokumentuar bazuar në faturën e subjekteve dhe proces verbalin e pritjes së mallrave dhe në çdo rast me fletëhyrjen sipas gjendjes fizike të tyre. Ato janë plotësuar nga magazinieri, pasi është bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit, në përputhje me përcaktimet e paragrafit 37, kreu III, të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar. Të gjitha fletë-daljet mujore të kryera për periudhën e audituar, nuk shoqërohen me urdhër dorëzimi, proces verbal se ku janë përdorur artikujt dhe listë-shpërndarjen mujore, *por rezultoi se të gjitha fletë-daljet mujore të kryera për periudhën e audituar, për materialet e marra nga magazina shoqërohen vetëm me një kërkesë nga strukturat*

të nënshkruar nga palët (dorëzuesi-marrësi), pa dhënë arsye për përdorimin e artikujve higjieno sanitarë, elektrike etj. Dokumentacioni i magazinës përpilohet nga magazinieri dhe përgjegjësi i shërbimeve, ndërsa kontabilizimi i veprimeve kryhet nga një specialiste e sektorit të shërbimeve mbështetëse.

**Më gjerësisht jemi shprehur në pikën IV. 7 të Raportit**

**Vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, etj**

-Për periudhën e audituar Drejtori i Përgjithshëm e Pronësisë Industriale, nuk është të miratuar rregulloren për parandalimin e konfliktit të interesit, në ushtrimin e funksioneve publike.

Institucioni në mbështetje të parimit të proporcionalitetit dhe të natyrës së veçantë të funksioneve të institucioneve publike dhe/ose të çdo zyrtari, nxjerr një rregullore të brendshme për parandalimin e interesave konkrete, prandaj titullari i institucionit dhe strukturat përgjegjëse duhet të miratojnë Rregulloren për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Gjatë auditimit u konstatua se mbledhjet thirren nga kryetari, me kërkesë të anëtarëve dhe drejtorit të përgjithshëm të paktën katër herë në vit, por këshilli mbikqyrës i organizonte mbledhjet sipas rasteve me kërkesë, pa u orientuar sipas një rregullore të brendshme për funksionimin dhe organizimin e këshillit mbikqyrës, ku nese do kishin rregullore, Drejtori i përgjithshëm i dpri-së ia paraqet këtë rregullore për miratim ministrit përgjegjës për ekonominë.

- Gjatë auditimit u konstatua mungesa e gjurmës specifike të auditimit në institucion, edhe mungesa e një praktike të mirë të ndjekur më parë, nuk ka garantuar transparencë gjatë aktivitetit vjetor të vitit 2024 dhe 10 mujorit 2025. Strukturat e DPPI-së, nuk kanë një gjurmë auditimi të ndjekur apo miratuar nga drejtoritë dhe sektorë të tjerë të saj, nuk ka dokumente apo dosje për gjurmë faktike të ndjekur për aktivitetet ushtrimore, nuk është vendosur në dispozicion të audituesit shkresë apo dokumenta që kanë të bëjnë me detyrimin për përgatitjen e gjurmës së auditimit për procedura që lidhen me veprimtarit kryesore duke filluar nga planifikimi, miratimi, realizimi, monitorimi, etj, lidhur me veprimtarinë e drejtorive të dhe sektorëve, e të tjerë të DPPI-së. Mos kryerja e vetëkontrollit (kontrolli i brendshëm) etj, ka bërë që mundësia e ndodhjes së anomaliteteve, për pasojë edhe ndikimi të jetë i tillë, pra duke ruajtur nivelin e riskut të lartë në vazhdimësi, prandaj në zbatim të aktiviteteve të kontrollit të brendshëm, është i domosdoshëm miratimi i gjurmës specifike të auditimit për çdo drejtori nga Titullari.

**Më gjerësisht jemi shprehur në pikën IV. 8 të Raportit**

**Rekomandimet kryesore**

Bazuar në gjetjet e përmendura në çështjen nr. IV të këtij Projekt Raporti, rekomandimet kryesore janë:

1- Strukturat përgjegjëse të DPPI-së, duhet të ndjekin objektivat e marra të dy projektligjeve, kthimin dhe miratimin e tyre në dy ligje të veçanta dhe shoqërimin me rregulloret përkatëse, për Treguesit gjeografik dhe emërtimet e origjinës si dhe për Disenjot, në përputhje me aktet e Bashkimit Evropian.

Të merren masa për sigurimin e aplikimeve jo vetëm elektronikisht në sistemin unik qeveritar e-albania, por edhe fizikisht të printuar të protokolluara dhe të ruajtura në arkivën e institucionit, si dhe krijimin e ambjentëve për këtë qëllim.

2- DPPI me strukturat e saj, duhet të synojnë nivele të larta të realizimit të fondeve në dispozicion sipas artikujve ekonomik buxhetor, programeve të detajuara për shpenzime korrente dhe të

projekteve për shpenzime kapitale të cilat transferohen prej disa vitesh duke krijuar gjendje të lartë të mjeteve monetare.

DPPI në bashkëpunim me strukturat e ministrisë përgjegjëse, duhet të kenë në vëmendje raportimet mbi zbatimin e buxhetit, të marrin masa për menaxhimin e fondeve të papërdorura, brenda vitit ushtrimor.

3- Të përgatitet informacion shtesë në lidhje me parashikimin e realizimit të pritshëm të buxhetit të miratuar me shpenzimet e realizuara, në vëmendje të strukturës së financës dhe buxhetit, gjatë raportimit 8 mujor të vitit buxhetor 2026 dhe vijues.

4- Të bëhet shpallja e gjithë vendeve vakante në Buletin e Njoftimeve Publike dhe faqen zyrtare të institucionit, si dhe të rishikohen nenet e rregullores së brendshme dhe të përcaktohen kriteret e punësimit, i cili duhet të përcaktojë saktë procedurat e rekrutimit nëpërmjet procedurave të konkurimit publik.

Të bëhet marrja e punonjësve në punë me kontratë të përkohshme në përpjestim të drejtë me numrin total të organikës së re.

5- Drejtoria e financës dhe shërbimeve, personi përgjegjës për personelin të marrin masa dhe të përditësojnë dosjet e personelit në përputhje me të gjitha kërkesat e akteve në fuqi.

6- Strukturat përgjegjëse të marrin masa për hapjen e regjistri themeltar i punonjësve, i protokolluar dhe me numër rendor dhe total të faqeve, i cili jep siguri dhe nuk lejon ndërhyrje në regjister, ndryshime apo falsifikime të akteve të prodhuara të regjistruara për punonjësit në vite.

Dorëzimi i dokumentacionit të kandidatëve të interesuar për vendet vakante të shpallura nga institucioni, të administrohet edhe nga zyra e protokollit në çdo rast nëpërmjet dokumentimit me numrin përkatës të protokollit.

7- Të rishikohen listëpagesat e ardhshme për të përjashtuar kategoritë e përkohshme, duke u mbështetur vetëm në kriteret e miratuara në VKMB, dhe të identifikohen shkaqet (llogaritje gabim, shtesa jo të arsyetuara) dhe të merren masa për arkëtimin e shumës 91,878 lekë përfituar në kundërshtim me aktet ligjore.

Të kërkohet menjëherë dokumentacioni që mungon për punonjësit dhe nëse nuk plotësohet, të kthehen pagesat e përfituara. Gjithashtu të rishikohet kontrata për këshilltarë të jashtëm sipas VKM-së dhe të argumentohet marrja e tyre në punë, si dhe pagesa mujore të përcaktohet në masën 110,000 lekë/muaj.

8- Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nën dhe mbi 100,000 lekë, duhet të kryejë testimin e tregut në teren, dhe të dokumentojë treguesit e çmimeve në një procesverbal, si dhe të bëjë përcaktimin e saktë të fondit limit për blerjet me vlera të vogla.

9- Të merren masa për çdo procedurë prokurimi të mbahet raporti përmbledhës dhe miratimi nga titullari i autoritetit kontraktor.

**10-** Marrja në dorëzim e mallrave dhe shërbimeve nga operatorët ekonomik fitues, të bëhet sipas përcaktimeve të specifikimeve teknike në ftesën për ofertë dhe kushteve të kontratës, nga komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave.

Nëpunësi zbatues, përgjegjësi i financës dhe komisioni i pritjes së mallit, duhet të përditësohen me përcaktimet e akteve ligjore/nënligjore në fuqi; veçanërisht me aktet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollin, si dhe në fushën e menaxhimit të aktiveve në njësitë e sektorit publik.

**11-** Të dorëzohet nga çdo operator ekonomik në zyrën e protokollit dokumentacioni i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor me procesverbal, në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë.

**12-** Të krijohet një praktikë e mirë e protokollimit të gjithë dokumenteve të çdo procedure prokurimi, dorëzimin dhe protokollimin e dokumentave të kërkuara OE-së, si dhe inventarizimi për arkivën i dosjeve të prokurimeve.

Të administrohen në një dosje të veçantë dokumentet e procedurës së prokurimit, dosje të cilat duhet të arkivohen për llogari të çdo viti ushtrimor, si dhe trajnimi i punonjësit të ngarkuar me detyrën e personit përgjegjës dhe sekretari-arkivit.

**13-** Strukturat përgjegjëse të marrin masa të menjëhershme që në DST dhe në kushtet e kontratës të përcaktohen datat e takimeve, ndersa marrja në dorëzim dhe afatet e monitorimit të kontratave si dhe likuidimi, duhet të jenë në përputhje me dokumentet dhe aktet përkatëse.

Të merren masat nga institucioni për arkëtimin e vlerës 153,626 lekë nga OE “Optima Communication” shpk Tiranë, i cili ka shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

**14-** Të bëhet hyrje në magazinë sipas zërave të stendës vlera e munguar prej 1,782,000 lekë, të evitohen pagesat e parakohshme nga financa, komisioni i monitorimit të mos nënshkruaj në mënyrë fiktive pa marrë pjesë në panair dhe pa dokumente justifikuese.

Në të gjitha panairët e organizuara, AK për çdo kontratë të krijoj komision të marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve, të bëhen hyrje artikujt e kthyer dhe të pa përdorur, veprime që kanë krijuar efekt financiar negativ në buxhet në vlerën 6,331,980 lekë, vlerë e cila institucioni e përdorte për pritje përcjellje dhe evente të tjera vijuese.

**15-** Të administrohen në një dosje të veçantë dokumentet e procedurës së prokurimit për prokurimet elektronike, dosje të cilat duhet të arkivohen për llogari të çdo viti ushtrimor, si dhe të mundësohet trajnimi i punonjësve të komisionit të blerjeve të vogla dhe punonjësit të ngarkuar me detyrën e sekretari-arkivit.

**16-** Të gjitha urdhër transfertat e plotësuar për kalimet në bankë (BKT), përveç datës së veprimit të plotësohet edhe me numër rendor, të regjistrohen në ditaret financiare në mënyrë kronologjike sipas numërit rendor të shpenzimit të kryer, dhe faturat e subjektit të regjistrohen me datën e faturimit dhe jo me datën e likuidimit në bankë, gjithë aktivitetit ushtrimor të vitit kalendarik.

17- Nëpunësi Zbatues dhe përgjegjësit i financës, të marrin masa, lidhur me paraqitjen për likuidim në kohë në BKT Tiranë, me Urdhër-transfertë për rastet e pagesave ndaj OE, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore dhe shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

18- Të respektohet disiplina buxhetore, të shmangët risku për krijimin e detyrimeve të prapambetura, të kryhet analizë të shkaqeve dhe vonesave, të merren masa administrative/organizative/financiare ndaj përgjegjësve për dëmin ekonomik të shkaktuar në vlerën 463,731 lekë, vlerë e cila çdëmtohet, pas vlerësimit nga grupi punës të ngritur nga titullari. Të kryhet menjëherë regjistrimi dhe raportimi i plotë i detyrimeve të prapambetura, të hartohet plan veprimi për likuidimin e detyrimeve brenda 30 ditëve nga faturimet në vijim të EPO-së, për të shmangur penalitete në të ardhmen, të forcohet monitorimi dhe të integrohet në sistemet e brendshme për të parandaluar përsëritjen.

19- Të plotësohen lëvizjet e automjetit me fletë-udhëtime të nënshkruar nga nëpunësi urdhërues dhe udhëtues, me datë nisje- kthimi dhe terheqje kuponi tatimor, si dhe të përcaktohet norma e konsumit të karburantit për mjetin e institucionit.

20- Në asnjë rast magazinieri të mos lëshojë fletë-dalje, pa siguruar dokumentacionin e urdhërdorëzimit, list shperndarjes per nevojat ditore, planin e shperndarjes dhe procesverbalin e konsumimit apo përdorimit të artikujve, strukturat përgjegjëse duhet të përditësohen me përcaktimet e akteve ligjore/nënligjore, në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollin dhe menaxhimit të aktiveve në njësitë e sektorit publik.

21- Të hartohet dhe miratohet Rregullore për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe Rregullore të brendshme të këshillit mbikqyrës, për të përmirësuar funksionimin dhe organizimin e brendshëm dhe respektuar vlerat e për të penguar interesat personale të administratës së Dppi-së.

22- Të ngrihet grupi i punës për hartimin e gjurmës së auditimit për çdo drejtori, dhe çdo strukturë përgjegjëse në DPPI, si dhe të miratohet nga Titullari Gjurma e Auditimit.

**Më gjerësisht jemi shprehur në Aneksin nr. 1, bashkëlidhur Raportit**

## II. Hyrje

Drejtorja e Përgjithshme e Pronësisë Industriale është organizuar dhe funksionon sipas Ligjit nr. 9947, datë 07.7.2008 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij; Ligjit nr. 8488, datë 13.5.1999 “Për Mbrojtjen e Topografisë së Qarqeve të Integruara”, i ndryshuar; Ligjit nr. 52/2005 “Për Markat Tregtare”; Ligjit nr. 53/2005 “Për Patentat, Modelet e Përdorimit dhe Certifikatat e Mbrojtjes Shtesë”; si dhe Marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e pronësisë industriale në të cilat RSH ka aderuar/ratifikuar; Rregullores së Brendshme të miratuar nga Këshilli Mbikqyrës, etj. DPPI-ja është person juridik publik, jobuxhetor, i cili funksionon si

agjenci autonome nën mbikëqyrjen e Ministrit përgjegjës për Ekonominë dhe Inovacionin në Republikën e Shqipërisë.

Në zbatim të planit vjetor 2025, referuar procedurave të përcaktuara në kapitullin IV, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, u hartua programi i auditimit, i cili u miratua me shkresën 1838/2 prot., datë 04.12.2025.

<b>Periudha e auditimit:</b>	17.01.2024 - 31.10.2025
<b>Afati i auditimit:</b>	9.12.2025 - 23.1.2026, shtyerje afati deri datë 30.01.2026
<b>Grupi i auditimit:</b>	Festim Ibrahim, përgjegjës i grupit të auditimit Aida Gegaj, anëtare e grupit të auditimit
<b>Qëllimi i auditimit:</b>	Të ndihmojë institucionin (DPPI) në regjistrimin, trajtimin, analizën, ekzaminimin dhe promovimin objekteve të pronësisë industriale, funksionimin si agjenci autonome dhe mbrojtjen e objekteve të pronësisë industriale të palët e interesuara, nën mbikëqyrjen e Ministrit përgjegjës për Ekonominë dhe Inovacionin, si dhe realizimin e objektivave të veprimtarisë duke përmirësuar sistemet e kontrollit, kryerjen e veprimeve dhe procedurave në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, etj.
<b>Takimi prezantues:</b>	I kryer në datën 04.12.2025 me nr. 4691/1 prot, i konfirmuar nga Drejtori i Përgjithshëm (i komanduar) i Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale.

Në përfundim të misionit të auditimit, mbështetur në konkluzionet e nxjerra nga auditimi, hartohet ky Raport Auditimi, i cili i vihet në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale Tiranë.

Në zbatim të Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapitulli IV, pika 4.1.12, pas dërgimit të Projekt Raportit të Auditimit, me shkresë nr. 1838/4 prot., datë 04.03.2026, hartohet Raporti Përfundimtar i Auditimit, me gjetjet dhe rekomandimet sipas drejtimeve të auditimit, pasi grupi i auditimit ka shqyrtuar observacionet e dërguara nga Drejtori i Përgjithshëm dhe ish Drejtori të Përgjithshëm të DPPI Tiranë, (stafi dhe ish stafi), sipas shkresës nr. 541/5 prot datë 19.30.2026 “Përcillen observimet në kuadër të projekt raportit të auditimit” (prot në MEI nr. 2414, datë 19.03.2026); shkresës nr. 1838/4 prot datë 04.03.2026 “Dërgohet projekt raporti i auditimit” (protokolluar me tyren nr. 541/1 prot, date 4.3.2026; si dhe e-maillet stafit dhe ish/DP/Dppi, etj, të cilat kanë observuar mbi gjetjet sipas sistemeve.

Grupi i auditimit ka vlerësuar observimet dhe reagimet sqaruese të strukturave të institucionit, dhe nëpërmjet Aneksit nr. 2 “Observacionet” ka shprehur qëndrimin e tij.

Raporti Përfundimtar vihet në dispozicion subjektit të audituar “Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, për njohje dhe miratimin e Planit të Veprimit.

### III. Metoda e Auditimit

Grupi i auditimit ka përdorur metoda dhe teknika auditimi në varësi të fushës së audituar duke aplikuar: Metoda e rishikimit analitik; Metoda e intervistimit; Metoda e leximit dhe studimi i raporteve të mëparëshme; Metoda e krahasimit dhe modelimit statistikor, etj.

Nëse gjatë punës në terren do të përdoret ndonjë metodë tjetër auditimi, përveç sa më sipër, do të pasqyrohet gjatë raportimit të auditimit (metoda e ekzaminimit kryq).

#### IV. Gjetjet dhe konkluzionet

Në përfundim të auditimit të të gjithë sistemeve të përcaktuara në programin e auditimit, grupi i auditimit jep vlerësimet e mëposhtme:

**IV. 1. Funksonimi dhe Vlerësimi i Drejtorive të DPPI-së me përzgjedhje** (Drejtoria e Kordinimit, Trajtitimit, Promovimit dhe Analizës; Drejtoria e Ekzaminimit; Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse; Sektori Juridik), si vijon:

- Për Regjistrimin e objekteve të PI-së, Markat tregëtare, Patentat, Modelet dhe Çertifikatat e mbrojtjes shtesë, Shpikjet dhe Modelet e përdorimit, Treguesit gjeografikë, Mbrojtja e topografisë në qarqet e integruara, Rregulloret, etj.

Gjatë auditimit rezultoi se organizimi dhe funksionimi i DPPI-së është i përcaktuar në Ligji nr. 9947, datë 07/07/2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar, ku si objekt të tij kishte rregullimin e sistemit të dhënies dhe mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale, si dhe rregullimi i sistemit të mbrojtjes së sekretit tregtar kundrejt përvetësimit, përdorimit dhe bërjes publike në mënyrë të paligjshme.

Objektivat e Pronësisë industriale janë: a) disenjot industriale; b) emërtimet e origjinës; c) markat tregëtare; d) modelet e përdorimit; e) patentat për shpikje; dh) treguesit gjeografikë.

Ligji nr. 9947, ka pësuar ndryshime të vazhdueshme për përmirësimin e funksionimit të regjistrimit të objekteve të PI, si dhe në kuadër të përafrimit me direktivat dhe rregulloret e BE-së.

Një rëndësi të veçantë merr dhe Sistemi i Administrimit të Pronësisë Industriale (baza e të dhënave elektronike) SAPI, i cili sipas nenit 183/a të ligjit të mësipërm i jep të drejtë DPPI-së për krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënave shtetërore për SAPI-n i cili përfaqëson regjistrin unik që mbledh e përpunon të dhënat e objekteve të pronësisë industriale që përfshin kërkesat e lidhura me to të depozituara nga individë/subjekte vendase dhe të huaja në R.SH.

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale është subjekti përgjegjës për administrimin e bazës së të dhënave të SAPI-t dhe autoriteti i vetëm i cili përcakton të drejtat dhe kufizimet e operimit në të, nëpërmjet aplikimit të aksesit me nivele të shkallëzuara dhe hierarkike të administrimit të informacionit.

Gjithashtu shërbimet online DPPI që nga qershor i vitit 2022 i ofron nëpërmjet Portalit qeveritar e-Albania (rreth 40 shërbime aplikimi). Për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të informacionit dhe implementimin e tij është lidhur Kontratë me nr. 26 datë 01.09.2022 për implementimin dhe mirëmbajtjen e këtij sistemi. Aktualisht kjo kontratë ka përfunduar në qershor 2025 dhe institucioni rezulton pa përmirësime (për shkak të ndryshimeve ligjore moduli markave kombëtare dhe shfaqja e vendimeve të dhomave kundërshtim/shfuqizim/pavlefshmëri) dhe shërbim mirëmbajtje të këtyre sistemeve të operimit.

Institucioni ka dëgjuar shkresë me nr.1434 datë 03.04.2025 ku vë në dijeni AKSHi-n për vijimin e procedurës së mirëmbajtjes të SAPI-t, për shkak të përfundimit të kontratës.

Në vitin 2025 janë miratuar dy ligje të rëndësishme si Ligji Nr.52/2025 “Për markat tregtare” që ka për qëllim rregullimin në mënyrë të plotë të marrëdhënieve juridike që lidhen me markat tregtare në territorin e RSH, si dhe Ligji nr.53/2025 “Për Patentat, modelet e përdorimit dhe çertifikatat e mbrojtjes shtesë që ka për qëllim t’u sigurojë mbrojtjen e duhur shpikjeve të bëra nga persona fisikë ose juridikë, vendas ose të huaj, brenda ose jashtë RSH.

Më poshtë paraqitet auditimi i funksionimit të strukturave të drejtimit dhe administrimit të institucionit, ku në përbërje janë:

-Drejtori i Përgjithshëm; -Struktura organike me drejtoritë e saj, Drejtoria e Kordinimit, Trajtim, Promovimit dhe Analizës; Drejtoria e Ekzaminimit; Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse; Sektori Juridik; -Këshilli Mbykqyrës; -Bordi i Apelimit; -Dhoma për Shfuqizim/zhvlerësim; Dhoma e Kundërshtimeve; Komisioni i Vlerësimit; Politika e Cilësisë dhe Njësia e Prokurimit.

-**Këshilli Mbykqyrës**; është organ kolegjal, në përbërje me 1 kryetar dhe 4 anëtarë, dhe emërohen nga ministri përgjegjës për ekonominë, funksionimi i tij është bazuar në nenet 189/b deri në 189/e të ligjit për PI, i ndryshuar.

-**Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve**; krijuar me Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm nr.70 datë 12.09.2023 shfuqizuar me Urdhërin nr.103 datë 26.09.2025; Urdher i DP nr.118 datë 29.10.2025 “Për një ndryshim në Urdherin nr.103 datë 26.09.2025”,

-**Dhoma për Shfuqizim/zhvlerësim**; krijuar me Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm nr.13 datë 20.01.2022 shfuqizuar dhe krijuar me Urdhërin nr.120 datë 30.10.2025;

-**Bordi i Apelimit**; krijuar Bordi i apelit nga Këshilli i ri Mbikqyrës me nr. 8 datë 12.02.2026, por rezultoi se nuk ka funksionuar prej dy vitesh(2024-2025), në kundërshtim me Nenin 193/b, të ligjit nr.9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar me ligjin nr.96, datë 7.7.2021.

-**Komisioni i Vlerësimit**; strukturë e ngritur brenda DPPI-së për liçensimin e Përfaqësuesve të Autorizuar dhe ekspertëve të PI-së, me urdherin e DP nr.46 datë 25.03.2025 për vitin 2025 dhe me urdherin nr.11 datë 09.01.2026 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit, për përfaqësuesit e autorizuar në DPPI dhe për ekspertët e objekteve të pronësisë industriale për vitin 2026, sipas nenit 193/ç, nenit 5, pika 3 eVKM-së nr.317 datë 31.05.2018, i ndryshuar dhe nenit 3, pika 3, VKM-së nr. 501 datë 29.08.2018 si dhe nenit 67 të rregullores së brendshme.

-**Regjistri i Përfaqësuesve të Autorizuar**; publikohet në format elektronik në faqen zyrtare të DPPI-së, nga verifikimi i regjistrimit të përfaqësuesve të autorizuar të Markave dhe Patentave u konstatua se *regjistri ka mungesa në përditësimin e ndryshimeve verifikim dhe përditësim në regjistrimin e përfaqësuesve* (Për markat me nr.liçence 154, 253, 153, 16, 20, dhe për patentat me nr.18, 24, 25,46, 22, 15, 26), pavarësisht urdhërit të brendshëm nr.34 datë 08.04.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për verifikim dhe përditësimin Përfaqësuesve të Autorizuar”.

Regjistri i Përfaqësuesve të Autorizuar mbahej në përputhje me nenin 9 të VKM-së nr. 317, datë 31.5.2018 “Për miratimin e rregullores për përfaqësuesit e autorizuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale”. Regjistrimi në regjistër është subjekt i ripërtëritjes në bazë vjetore, sipas pikës 7, të nenit 197, të ligjit nr. 9947 “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar dhe nëse përfaqësuesi i autorizuar nuk kryen pagesën e ripërtëritjes brenda afatit, atij i humbet e drejta e përfshirjes në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar. Çertifikata nënshkruhet nga drejtori i përgjithshëm i DPPI-së në zbatim të nenit 6 të VKM-së nr. 317 datë 31.05.2018, *por duhet të miratohet një format tip të çertifikatës për përfaqësues të autorizuar nga DPPI-ja, nga titullari i institucionit.*

**Këshillojmë** se në urdhërat e përgatitur, përveç bazës ligjore të nenit 191, pika 4 të cituar, duhet të shtohen dhe nenet respektive si neni 193/a, neni 193/ç, të ligjit nr.9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar dhe nenet e Rregullores së Brendshme të miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikqyrës nr.14 datë 19.12.2024.

**-Marrëveshjet ndërkombëtare dhe kombëtare;** ndër më kryesoret janë Marrëveshja e Madridit dhe e Hagës, WIPO të cilat kanë të bëjnë me aktivitete në kuadër të Strategjise në fushën e PI, suport dhe trajnime të ndryshme. Janë nënshkruar 21 marrëveshje mirëkuptimi ndërkombëtare ndërmjet DPPI-së dhe zyrave homologe si dhe janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi kombëtare me partnerët në nivel kombëtar kryesisht me bashkitë, universitete, institucione dhe shoqata ku rezulton se 30% e tyre janë pa aktivitet.

-Politika e Cilësisë dhe **Njësia e Prokurimit**, me urdhërin nr18 datë 23.01.2025 të DP është autorizuar administratori i sistemit **prokurimit** publik dhe me urdherin nr 14 datë 09.01.2025 është caktuar personi përgjegjës për prokurimet për vitin 2025.

### **U konstatua se DPPI ka kryer reformën ligjore në fushën e Pronësisë Industriale**

Reforma është ushtruar në rregullimin dhe përmirësimin e akteve në fuqi, kryesisht në Ligjin nr. 9947, datë 07/07/2008 “Për pronësinë industriale” i cili ka pësuar ndryshime të vazhdueshme për përmirësimin e funksionimit të regjistrimit të objekteve të PI, si dhe në kuadër të përafrimit me direktivat dhe rregulloret e BE-së. Ky ligj që nga vitit 2008 ka ndryshuar 4 herë, si më poshtë:

- Me ligjin nr. 10/2013, datë 14.02.2013; nr. 55/2014, datë 29.05.2014; nr. 17/2017, datë 16.02.2017; nr. 96/2021, datë 7.7.2021, ndryshimi është kryer për shkak se duke qenë para faktit se ligji 9947/2008 “Për pronësinë industriale” ka patur të parashikuar të gjitha objektet e PI-së, strukturat sipas drejtorive kanë hasur vështërsi të karakterit teknik dhe logjistik në punën e përditshme, gjithashtu ligji nuk ka mundur të parashikojë të gjitha detajet aq të domosdoshme për trajtimin dhe rregullimin e të gjithë pikave që lidhen me objektet industriale; mbi këtë bazë ka lindur ideja e ndryshimeve të mëtejshme dhe përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE, duke kryer një reformë të thellë ligjore në këtë fushë me ndarjen e gjitha objekteve të Pronësisë Industriale në ligje të veçanta, të bazuar në disa modele dhe studime ligjore të vendeve të BE-së (si p.sh atë kroat, greke, etj).

- Reforma ligjore ishte e parashikuar në dokumentin e Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022-2025, e miratuar me vendimin nr. 350, datë 26/05/2022 të këshillit Ministrave si dhe në Planin Kombëtar të Integritimit European 2022-2025. Kjo është arsyeja pse të gjitha vendet e Europës i trajtojnë dhe i rregullojnë objektet e pronësisë industriale të përmendura me ligje të veçanta, mbi këtë bazë janë miratuar akte ligjore si vijon:

#### **I. Ligji Nr. 52/2025 “Për Markat Tregtare”**

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale me këtë ligj përmbushi një sërë objektivash të rëndësishme si:

- 1- Rregullimin e plotë të marrëdhënieve juridike që lidhen me markat tregtare, marrëdhënie këto që aktualisht rregullohen nga ligji ekzistues nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar;
- 2- Sigurimi i një mbrojtjeje më të gjerë dhe më të fortë të markës tregtare për shkak të rolit të madh që luan ky objekt i pronësisë industriale në aktivitetet tregtare të subjekteve vendas dhe të huaj në tregun e brendshëm;
- 3- Përafrimi i dispozitave ligjore për markat me dispozitat e akteve përkatëse të Bashkimit Evropian.
4. Plotësimi dhe mbushja e mangësive ligjore të vërejtura në praktikë si gjatë ndjekjes së procedurave administrative në DPPI, ashtu dhe në gjykimet civile në këtë fushë;

5. Rregullimi i sistemit të regjistrimit dhe mbrojtjes së markave ndërkombëtare që regjistrohen në Zyrën Botërore të Pronësisë Intelektuale me efekt në territorin e Republikës së Shqipërisë;
6. Përbushja e objektivave të strategjisë kombëtare të pronësisë intelektuale 2022-2025 për reformën ligjore dhe miratimin e ligjeve të veçanta për çdo objekt të pronësisë industriale.

Aktualisht, tregu në Shqipëri po ndeshet çdo ditë e më shumë me konflikte midis markave të regjistruara më parë dhe që kanë një reputacion dhe emër të mirë në treg dhe përpjekjeve të personave të ndryshëm për të përdorur marka identike ose të ngjashme me markat e regjistruara më parë. Këto përpjekje negative përveçse dëmtojnë interesat ekonomike të pronarëve të markave me reputacion në treg, ato dëmtojnë dhe deformatojnë gjithashtu tregun dhe interesat e konsumatorëve. Në këtë aspekt, ky ligj garanton gjithashtu edhe mbrojtjen e konsumatorëve nga pasojat që mund të vijnë në treg nga shkelja e të drejtave të markave dhe qarkullimi i mallrave çënuese.

Ligji i ri i markave me nr. 52/2025, i kushton një rëndësi të veçantë masave për mbrojtjen e markave dhe të drejtave të pronarëve të markave nga çënimet që u bëhen atyre nga spekulatorë dhe manipulatorë të tregut. Në këtë aspekt, parashikon të drejtën e pronarëve të markave që çënohen nga veprime shkelëse të ngrenë padi, të paraqesin prova dhe t'i sigurojnë këto, të kërkojnë marrjen e masave të përkohshme për parandalimin e një shkeljeje, nxjerrjen jashtë qarkullimit, konfiskimin dhe vënien nën kontroll të mallrave që dyshohet se shkelin të drejtat e markave të regjistruara më parë dhe kështu me radhë.

## **II. Ligji Nr. 53/2025 “Për Patentat, Modelet e Përdorimit dhe Certifikatat e Mbrojtjes Shtesë”**

Me miratimin e ligjit të ri të patentave fillimisht është bërë përafrimi i plotë acquis komunitare të BE me legjislacion shqiptar në fushën e Patentave si dhe janë realizuar një sërë objektivash:

- 1- Rregullimi i plotë i marrëdhënieve juridike që lidhen me patentat e shpikjeve dhe modelet e përdorimit, marrëdhënie këto që aktualisht rregullohen nga ligji ekzistues nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar (në vijim Ligji 9947).
- 2- Sigurimi i një mbrojtjeje më të gjerë dhe më të fortë të patentave, modeleve të përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë për shkak të rolit të madh që luajnë këto objekte të pronësisë industriale në aktivitetet e subjekteve vendas dhe të huaj.
- 3- Përafrimi i plotë i dispozitave ligjore për patentat me dispozitat e akteve përkatëse të Bashkimit Evropian.
- 4- Plotësimi dhe mbushja e mangësive ligjore të vërejtura në praktikë gjatë ndjekjes së procedurave administrative në DPPI.
- 5- Përbushja e objektivave të Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022-2025 për reformën ligjore dhe miratimin e ligjeve të veçanta për çdo objekt të pronësisë industriale.
- 6- Rregullimi i saktë dhe i detajuar i procedurave që lidhen me liçensat sekrete dhe liçensat detyruese apo vullnetare.
- 7- Rregullimi i plotë i marrëdhënieve juridike që lidhen me patentat e shpikjeve bioteknologjike.

8- Rregullimi i çështjeve dhe procedurave që lidhen me certifikatat e mbrojtjes shtesë për përdorim pediatrik.

Ligji i ri i Patentave 53/2025 në bazë analize të bërë krahasuar kjo dhe me vendet e BE krijon për subjektet e patentave dhe modeleve të përdorimit, më shumë siguri ligjore për mbrojtjen e këtij objekti industrial, rrisin nivelin e investimeve në fushën në të cilën ata operojnë. Ndikimet e drejtpërdrejta në shtimin e vendeve të punës, mbrojtje ligjore, përdorimi i patentave janë thelbësore për pronarët e patentave dhe japin ndikim në konkurime, investime dhe rritje fitimi, si dhe përafrim me vendet e BE-së.

1- Gjatë auditimit u konstatua se, dy objektiva të tjera ligjore nuk janë miratuar janë bërë rregullime të hollësishme dhe përafrim i plotë me *acquis communautaire* të BE me atë Shqiptar, ato janë në proces përgatitje nga strukturat përgjegjëse të Dppi-së, por u konstatua dy projektligjet e tjera ende nuk janë finalizuar në ligje, Konkretisht:

-Projektligji i ri Treguesve Gjeografikë dhe Emërtimeve të Origjinës, rezulton se nuk është miratuar me ligj të veçantë, i cili do kryejë trajtimin e treguesve gjeografik dhe emërtimeve të origjinës të objekteve të pronësisë industriale me aktet dhe rregulloret e BE-së, pasi aktualisht kërkon një sërë elemente dhe detaje të tjera juridike, që deri më sot janë rregulluar pjesërisht ose fare.

-Projektligji i ri “Për Disenjt” trajton disenjon në një ligj të veçantë, i cili bëhet i nevojshëm për arsye se deri më sot përafrimi me organizatat e BE-së, ka qënë i pjesshëm, përafrimi i plotë kërkon të parashikohen edhe një sërë institutesh ose momentesh të tjera juridike që deri më sot ose rregulloheshin pjesërisht, ose nuk rregulloheshin fare.

**Titulli i gjetjes:** Mungesa e miratimit të projektligjit për Treguesit Gjeografikë dhe Emërtimet e Origjinës dhe për Disenjt, në dy akte ligjore; Mangësi në protokollimin dhe ruajtjen e kopjes fizike të aplikumeve nga sistemi SAPI.

<b>Gjetje Nr. 1</b>	
<b>Subjekti i audituar</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Intelektuale
<b>Subjektet e interesuara nga gjetja</b>	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit Drejtori i Përgjithshëm e Pronësisë Industriale Drejtoria e Kordinimit, Trajtimit, Promovimit dhe Analizës; Drejtoria e Ekzaminimit; Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Sektori Juridik; Këshilli mbikqyrës i DPPI-së.
<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	-Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 78 dhe 83, pika 1; -Ligji nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar; -Rregullorja (BE) 2017/1001 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 14 Qershor 2017 “Për markat tregtare të Bashkimit Evropian”, Celex nr. 32017R1001; Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 154, datë 16.06.2017. (OJ L 154, 16.6.2017, p. 1–99) i plotë; - Direktiva (BE) 2015/2436 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16.12. 2015 “Për përafrimin e legjislacionit të Shteteve Anëtare në lidhje me

	<p>markat tregtare”, Celex nr. 32015L2436; Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 336, datë 23.12.2015. (OJ L 336, 23.12.2015, p. 1–26) i plotë;</p> <p>- Direktiva 2004/48/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 29.04.2004, për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, Celex nr. 32004L0048R(01); Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 195, datë 02.06.2004. (OJ L 195, 2.6.2004, p. 16–25) e pjeshsme.</p> <p>- Rregullorja (BE) 2024/1143 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 11.04.2024 “Për treguesit gjeografik për verën, pijet alkoolike dhe produktet bujqësore, si dhe për specialitetet tradicionale të garantuara dhe kushtet opcionale të cilësisë për produktet bujqësore”;</p> <p>- Rregullorja (BE) 2023/2411 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 18.10.2023 “Mbi mbrojtjen e treguesve gjeografik për produktet e zejtarisë dhe të industrisë”.</p> <p>-Urdhër nr. 1798 prot (37), datë 08.05.2024 “Për protokollimin dhe ruajtjen e kopjes fizike të aplikumeve që vijnë nëpërmjet sistemit SAPI”</p>
<p><b>Përshkrimi i gjetjes</b></p>	<p><b>Situata:</b> Nga auditimi rezultoi se dy projektligjet e përgatitura nga DPPI, nuk janë miratuar në dy ligje sipas Kushtetutës dhe Rregulloreve e akteve të BE-së, në fushën e treguesve gjeografik dhe emërtimeve të origjinës si dhe disenjos, si dhe përgatitja dhe miratimi i rregulloreve sipas përkatësisë ligjore në fushën e PI-së. Lidhur me reformën ligjore në fushën e Pi-së janë ngritur dy grupe pune për ndjekjen e procesit, urdhër nr.4820 prot (nr. 105), datë 11.12.2024 “Për përgatitjen e projektligjit për disenjot industriale” dhe urdhër nr.4173 prot (nr. 107), datë 08.10.2025 “Për përgatitjen e projektligjit për treguesit gjeografik dhe emërtimet e origjinës”. Ligji ekzistues për treguesit gjeografik dhe emërtimeve të origjinës ka një rregullim të përgjithshëm dhe sipërfaqësor, dhe është rregulluar me një numër i kufizuar dispozitash, ndërsa projektligji i ri sjell një varg përmirësimesh të rëndësishme në përmbajtjet e dispozitave duke bërë një rregullim më të gjerë dhe më të saktë të treguesve gjeografik dhe të emërtimeve të origjinës, si dhe siguron një interpretim dhe zbatim më të mirë dhe përmirësime në disa aspekte nga Ligji ekzistues nr. 9947, rregullime si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <u>Së pari</u>, nuk ka një strukturë të mirëfilltë, gjë që është e kuptueshme pasi Ligji nr. 9947 përfshinte dhe rregullonte jo një, por 6 objekte të pronësisë industriale, duke filluar nga patenta dhe duke përfunduar me treguesin gjeografik, duke trajtuar me kujdes Objektin, Qëllimin, Fushën e Veprimit dhe Përkufizimet, një hap përpara me nenin 176 të Ligjit nr. 9947, ku gjenden të përziera elementë të objektit me ato për përkufizimet, duke e bërë konfuze përmbajtjen e këtij neni.</li> <li>• <u>Së dyti</u>, Elementë të tillë si mbrojtja e treguesve gjeografikë, klasifikimi i produkteve të përcaktuara nga treguesit gjeografikë në përputhje me Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave, qëndrueshmëria në prodhimin</li> </ul>

	<p>e produkteve, etj, gjejnë për herë të parë rregullim në kuadrin juridik të treguesve gjeografik dhe të emërtimeve të origjinës.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <u>Së treti</u>, Në dallim nga Ligji ekzistues projektligji i kushton një vend dhe një rëndësi të veçantë grupit të prodhuesve dhe rregullon në detaje statusin e grupit, duke plotësuar kështu kuadrin ligjor në këtë aspekt, si dhe ka përmirësime në ndjekjen e procedurave dhe dokumenteve që kërkohen të paraqiten për regjistrimin e një treguesi gjeografik, apo shfuqizimin e një treguesi gjeografik.</li> <li>• <u>Së katërti</u>, në procedurat për kundërshtimin e aplikimit për regjistrimin e një treguesi gjeografik, parashikohet dhe rregullohet edhe procedura e konsultimit ndërmjet aplikuesit dhe kundërshtuesit, që është një shtysë për zgjidhjen me pajtim të konflikteve ndërpjet palëve, veçanërisht kur ka baza dhe efikasitet ekonomike si pasojë e një zgjidhjeje të tillë, si dhe kryerjen e një procesi regjistrimi sa më të drejtë dhe të rregullt dhe pa devijime dhe vonesa.</li> <li>• <u>Së pesti</u>, Pas regjistrimit treguesi gjeografik fiton mbrojtje dhe evidenton të drejtat e mbajtësit, nga ana tjetër parashtron ndalimet e personave dhe prodhuesve të tjera për përdorimin e treguesit gjeografik të mbrojtur nga spekulatorë dhe manipulorë të tregut, si dhe parashikon të drejtat e pronarëve të treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës që çënohen nga veprime që dyshohet se shkelin të drejtat e kështu me radhë.</li> <li>• <u>Së gjashti</u>, projektligji ka të detajuar masat në rast të shkeljeve të të drejtave që rrjedhin nga treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës, ndalimin e produkteve që shkelin të drejtat e treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës, heqjen ose bllokimin nga qarkullimi civil të produkteve çënuese, shpërblimin e dëmeve që u vjen pronarëve nga shkeljet dhe abuzimet pa autorizim të treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës të pronarëve, të drejtat e pronarëve për t'u drejtuar autoriteteve doganore, autoritetit të ngarkuar për inspektimin dhe kontrollin e tregut të brendshëm.</li> <li>• <u>Së shtati</u>, projektligji ka rregulluar regjistrimet ndërkombëtare të treguesve gjeografikë dhe emërtimeve dhe ka përafuar të ligjin kombëtar me aktet respektive të BE-së.</li> <li>• <u>Së teti</u>, projektligji krahas rregullimeve me disenjot, ka përmirësuar interpretimit të dispozitave ligjore të fushës, si dhe ka plotësuar dhe rregulluar procedurat përkatëse për refuzimin e regjistrimit të disenjove, si dhe disenjot që çënojnë të drejtat e mbajtësve të të drejtave të disenjos të regjistruara më parë, duke u siguruar këtyre të fundit një mbrojtje më të madhe të të drejtave të tyre mbi këtë objekt të pronësisë.</li> <li>• <u>Së nënti</u>, projektligji i kushton një vend të veçantë procedurës për regjistrimin e disenjos ku ka një ndryshim të thellë krahasimisht me ligjin</li> </ul>
--	---

ekzistues, transferimit dhe licensimit të tij, si dhe parashikon dispozita të vecanta në lidhje me paraqitjen e disenjës, klasifikimin dhe treguesit e produktit, trajton në mënyrë të detajuar institutin e të drejtës për prioritet, duke përfshirë prioritetin që buron nga shfaqja e produkteve fillimisht në një ekspozitë ndërkombëtare dhe duke vazhduar me regjistrimet e mëparshme në vende të tjera sipas konventave ndërkombëtare përkatëse ku Shqipëria bën pjesë si anëtare.

- Së dhjeti, projektligji i kushton një rëndësi të veçantë masave për mbrojtjen e disenjave dhe të drejtave të mbajtësve të të drejtave të disenjave nga cënimet që u bëhen atyre nga spekulatorë dhe manipulatorë të tregut. Ai parashikon të drejtën e mbajtësve të të drejtave të disenjave që cënohen nga veprime shkelëse të ngrenë padi, marrjen e masave të përkohshme për parandalimin e një shkeljeje, nxjerrjen jashtë qarkullimit, konfiskimin dhe vënien nën kontroll të produkteve që dyshohet se shkelin të drejtat e disenjave të regjistruara më parë dhe kështu me radhë.
- Së njëmbëdhjeti, projektligji përpunon në mënyrë më të detajuar masat që merren në rast të shkeljeve të të drejtave që rrjedhin nga disenjt, si ndalimin e produkteve që shkelin të drejtat e disenjës, heqjen ose bllokimin nga qarkullimi civil të produkteve cënuese, deri tek materialet, pajisjet dhe mjeteve e përdorura për krijimin ose prodhimin e këtyre produkteve cënuese. Gjithashtu trajton shpërblim të dëmeve nga shkeljet dhe abuzimet nga subjekte që përdorin pa autorizim disenjo të mbrojtura, ku mbajtësit të të drejtave të disenjës të regjistruar në emër të tyre, mund t'u drejtohen autoriteteve doganore dhe autoritetit të ngarkuar për inspektimin dhe kontrollin e tregut të brendshëm për të marrë masa që i kundërvihen abuzimeve të ndryshme.
- Së dymbëdhjeti, projektligji trajton edhe regjistrimet ndërkombëtare të disenjave sipas marrëveshjes së Hagës<sup>1</sup> dhe rregullon procedurat e regjistrimit dhe mbrojtjes së disenjave ndërkombëtare që regjistrohen në EİPO me efekt në territorin e Republikës së Shqipërisë. Krahas saktësisimit të termave dhe efekteve juridike ai rregullon në përputhje me aktet ligjore të BE-së, procedurat për deklarimin e pavlefshmërisë së disenjës nga gjykata pasi ajo është regjistruar në shkelje të shkaqeve absolute apo relative, pra përmbushet një objektiv i marrë nga qeveria shqiptare në fushën e pronësisë intelektuale që gjendet i pasqyruar edhe në strategjinë për pronësinë intelektuale 2022-2025, i cili kërkon përafrimin e plotë edhe të këtij Projektligji me aktet e Bashkimit European.

Për sa më lart, vlen të theksohet se grupet e punës dhe stafi i institucionit kanë bërë një interpretim dhe një punë të mirë të dy projektligjeve, në bashkëpunim me ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë si dhe është konsultuar me organizata ndërkombëtare ku Shqipëria është anëtare në këtë fushë dhe përfaqësohet nga DPPI. Duke qenë se këto dy projektligje, presin të miratohen në ligje dhe bëjnë pjesë dhe në piketat përmbyllëse të kapitullit VII “Pronësia Intelektuale” me BE dhe ku nga ana e DPPI për pjesën që i përket Pronësisë Industriale është drejt përfundit dhe pritët që kapitulli VII me realizimin e këtyre angazhimeve të jetë nja nga kapitujt e parë që mbyllet dhe realizon me sukses për objektivat e marra nga Qeveria Shqiptare për përfundimin e këtij procesi, prandaj stafi duhet të ndjeki dhe të përmbylli punën me miratimin e dy ligjeve dhe rregulloreve përkatëse për të realizuar zbatimin e objektivave të institucionit.

U konstatua nga grupi i auditimit se, nuk janë të ruajtur në protokoll në formatin Hardkopi në institucion, por janë ruajtur vetëm në sistemin elektronik e-albania, por institucioni nuk dispononte ambjente dhe burime njerëzore të mjaftueshme për protokollim dhe arshivim të një numri të lartë aplikimesh për vitin 2024 prej 5019 dhe viti 2025 prej 5473.

**Kriteri:** - Neni 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës të RSH-së;

- Ligji nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar

- Rregullorja (BE) 2017/1001 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 14 Qershor 2017, për markat tregtare të Bashkimit Evropian, Celex nr. 32017R1001; Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 154, datë 16.06.2017. (OJ L 154, 16.6.2017, p. 1–99) i plotë;

- Direktiva (BE) 2015/2436 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 16 Dhjetor 2015, për përafrimin e legjislacionit të Shteteve Anëtare në lidhje me markat tregtare, Celex nr. 32015L2436; Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 336, datë 23.12.2015. (OJ L 336, 23.12.2015, p. 1–26) i plotë;

- Direktiva 2004/48/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 29 Prill 2004, për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, Celex nr. 32004L0048R(01); Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 195, datë 02.06.2004. (OJ L 195, 2.6.2004, p. 16–25) e pjeshme;

- Rregullorja (BE) 2024/1143 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 11 Prillit 2024 për treguesit gjeografik për verën, pijet alkolike dhe produktet bujqësore, si dhe për specialitetet tradicionale të garantuara dhe kushtet opcionale të cilësisë për produktet bujqësore, që ndryshon Rregulloret (BE) Nr. 1308/2013, (BE) 2019/787 dhe (BE) 2019/1753 dhe që shfuqizon Rregulloren (BE) Nr. 1151/2012;

- Rregullorja (BE) 2023/2411 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 18 Tetorit 2023 mbi mbrojtjen e treguesve gjeografik për produktet e zejtarisë

	<p>dhe të industrisë dhe që ndryshon Rregulloret (BE) 2017/1001 dhe (BE) 2019/1753.</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Mungesa e miratimit të dy ligjeve të veçanta nga ligji aktual për pronësinë intelektuale, jep ndikim negativ në mbrojtjen ligjore të subjekteve në treg, në konkurrencën e lirë, si dhe në përfrimin e vëndit tonë në BE.</p> <p><b>Shkaku:</b> Mungesa e Përafërimit të plotë të dispozitave ligjore për Treguesit gjeografik dhe emërtimet e origjinës si dhe për Disenjt, me dispozitat përkatëse të Bashkimit Evropian.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut</b>	I Mesëm
<b>Konkluzioni</b>	<p>Mungesa e informacionit shtesë për kthimin e dy projektligjeve të përgatitura nga stafi i DPPI-së, në dy ligje të veçanta sipas kushtetutës dhe miratimin me vendim të rregulloreve të përshtatur si të BE-së në fushën e treguesve gjeografik dhe emërtimeve të origjinës si dhe disenjos, ligje të cilët japin ndikim pozitiv në përmbushjen e objektivave dhe rritjen e të ardhurave të institucionit dhe marrëdhënieve me pronarët dhe mbrojtjen ligjore të tyre, lidhur me pronësinë industriale.</p> <p>Ligji ekzistues për treguesit gjeografik dhe emërtimeve të origjinës si dhe disenjos ka një rregullim të përgjithshëm dhe sipërfaqësor me një numër i kufizuar dispozitash, ndersa projektligji i ri i përgatitur nga stafi i DPPI-së në bashkëpunim me ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë si dhe me organizata ndërkombëtare, do të sjelli një varg përmirësimesh të rëndësishme në përmbajtjet e dispozitave dhe një rregullim më të gjerë dhe më të saktë të treguesve gjeografik, emërtimeve të origjinës dhe disenjon, si dhe siguron një interpretim dhe zbatim më të mirë të këtyre dispozitave, për të cilët duhet të kthehet në ligj dhe shoqërimin me rregullore përkatëse për Dppi-në, për arsye të përmirësimeve në disa aspekte nga ligji ekzistues.</p> <p>Vlen të theksohet se stafi i institucionit ka bërë një interpretim dhe një punë të mirë të dy projektligjeve, në bashkëpunim me ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë si dhe është konsultuar me organizata ndërkombëtare ku Shqipëria është anëtare në këtë fushë dhe përfaqësohet nga DPPI, si dhe është bazuar kryesisht edhe në paketën e re për disenjt (<i>EU Design Legislative Reform Package</i>) e cila daton në Nëntor 2024. Duke qenë se këto dy projektligje, presin të miratohen në ligje dhe bëjnë pjesë dhe në piketat përmbyllëse të kapitullit VII “Pronësia Intelektuale” me BE dhe ku nga ana e DPPI për pjesën që i përket Pronësisë Industriale është drejt përfundit dhe pritet që kapitulli VII me realizimin e këtyre angazhimeve të jetë nja nga kapitujt e parë që mbyllet dhe realizon me sukses për objektivat e marra nga Qeveria Shqiptare për përfundimin e këtij procesi, prandaj stafi duhet të</p>

	<p>ndjeki dhe të përmbylli punën me miratimin e dy ligjeve të shoqëruar me rregullore përkatëse, për të realizuar funksionimin më të mirë dhe zbatimin e objektivave të institucionit.</p> <p>U konstatua nga grupi i auditimit se jo të gjitha aplikimet që vijnë nëpërmjet sistemit unik qeveritar e-albania nga shërbimet on-line që ofron Dppi, në përfundim të trajtimit të dosjes, nuk janë të fizikisht në protokoll në formatin Hardkopi, por janë vetëm në sistemin elektronik, por institucioni nuk dispononte ambjente dhe burime njerëzore të mjaftueshme për protokollim dhe arshivim të një numri të lartë aplikimesh për vitin 2024 prej 5019 dhe viti 2025 prej 5473.</p> <p><i>Grupi i auditimit vlerëson strukturat lidhur në përpjekjet e përmirësimit të kuadrit ligjor si dhe të funksionimit të sistemit unik qeveritar e-albania nga shërbimet on-line që ofron Dppi, gjatë dhe pas përfundimit të angazhimit të auditimit.</i></p>
<b>Rekomandimi</b>	<p>-Strukturat përgjegjëse të DPPI-së, duhet të ndjekin objektivat e marra të dy projektligjeve, kthimin dhe miratimin e tyre në dy ligje të veçanta dhe shoqërimin me rregulloret përkatëse, për Treguesit gjeografik dhe emërtimet e origjinës si dhe për Disenjot, në përputhje me aktet e Bashkimit Evropian.</p> <p>-Të merren masa për sigurimin e aplikimeve jo vetëm elektronikisht në sistemin unik qeveritar e-albania, por edhe fizikisht të printuar të protokolluara dhe të ruajtura në arkivën e institucionit, si dhe krijimin e ambjenteve për këtë qëllim.</p>
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	<p>-Të ndiqen sipas rekomandimit brenda vitit 2026.</p> <p>-Sqarimet në përgjigje të obsevacioniti gjeni në Aneksin 2</p>
<b>Statusi i rekomandimit</b>	<p><i>Statusi i gjetjes dhe rekomandimi nuk ndryshon, nuk ndryshon niveli i riskut</i></p>

## Auditimi i Përputhshmërisë në DPPI

### - *Spektori i Patentave dhe Modeleve të Përdorimit*

Gjatë periudhës së audituar 2024 dhe 10 mujori 2025 mbi aplikimet për patenta, modele përdorimi dhe certifikata të mbrojtjes shtesë rezultoi si më poshtë:

<b>Aplikime</b>	<b>2024</b>	<b>Janar – Tetor 2025</b>
Aplikime për Patentë kombëtare	12	8
Patenta nga Zyra Evropiane e Patentave	730	535
Aplikime nga Traktati i Bashkëpunimit për Patentat (TBP)	0	0
Aplikime për Model Përdorimi	4	1
Aplikime për Certifikatë të mbrojtjes shtesë	11	3

Regjistrime për patentat, modelet e përdorimit dhe certifikatat e mbrojtjes shtesë të regjistruara në vitin 2024 dhe periudhën per periudhën e audituar:

Regjistruar	Janar-dhjetor 2024	Janar - Tetor 2025
Patenta kombëtare	12	7
Patenta nga Zyra Evropiane e Patentave	808	574
Patenta nga Traktati i Bashkëpunimit për Patentat (TBP)	1	0
Modele Përdorimi	1	3
Certifikata të mbrojtjes shtesë	7	6

Nga auditimi u konstatua se kërkesat (aplikimet) janë ndjekur dhe shqyrtuar nga strukturat për regjistrimin e patentave, modeleve të përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë në përputhje me Ligjin Nr. 9947 dt. 07.07.2008 “ Për Pronësinë Industriale” i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij si:

-VKM Nr. 1707 datë 29.12.2008 "Për lëshimin e patentave për shpikjet dhe modelet e përdorimit" i ndryshuar;

-VKM Nr. 883, datë 13.5.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”, i ndryshuar;

Aplikimet e depozituara pas datës 03.07.2025, janë shqyrtuar, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 53/2025 datë 03.07.2025 “Për Patentat, Modelet e Përdorimit dhe Certifikatat e Mbrojtjes Shtesë”.

- *DPPI në vitin 2024 ka regjistruar këto të dhëna mbi patentat, modelet e përdorimit dhe certifikatat e mbrojtjes shtesë sipas Objektivit të verifikuar më poshtë:*

Objekti	Të dhënat	
<b>PATENTË KOMBËTARE</b>	Numri kombëtar i aplikimit	AL/P/2023/50
	Data e depozitimit	31/01/2023
	Titulli i patentës	KOKE SHTUPE PER PASTRIM DYSHEMEJE E RI-PERDORSHEM
	Pronari i patentës	VIOLETA BOJAXHI/BLV. BAJRAM CURRI; ND.142; H.1; NJESIA ADMINISTRATIVE NR.2 TIRANË AL
	Data e regjistrimit	26/12/2024
	Numri i regjistrimit	12573
<b>PATENTË NGA ZYRA EVROPIANE E PATENTAVE</b>	Numri kombëtar i aplikimit	AL/P/2024/276
	Data ndërkombëtare e depozitimit	15/03/2019
	Titulli i patentës	POLIMORFE TË REJA TË KRIPËS SË KALCIUMIT SI AGJENTË ANTI-INFLAMATORË, IMUNOMODULUES DHE ANTI-PROLIFERUES
	Pronari i patentës	Immunic AG / Lochhamer Schlag 21, 82166 Gräfelfing, DE

	Data e regjistrimit të vlefshmërisë	13/08/2024
	Numri i regjistrimit	12250
<b>PATENTË SIPAS TBP-së</b>	Numri kombëtar i aplikimit	AL/P/2023/155
	Data ndërkombëtare e depozitimit	21/12/2021
	Titulli i patentës	PROCESI I DEPOLIMERIZIMIT TË MBETJEVE TË MATERIALEVE PLASTIKE
	Pronari i patentës	Basell Poliolefine Italia S.r.l / Via Pontaccio 10, 20121 Milano, Itali, IT
	Data e regjistrimit	09/01/2024
	Numri i regjistrimit	11771
<b>MODEL PËRDORIMI</b>	Numri kombëtar i aplikimit	AL/U/2022/2
	Data e depozitimit	16/09/2022
	Titulli i modelit të përdorimit	CUT CLO
	Pronari i modelit të përdorimit	Klodiana Mëngri / DURRESI; ND.102;H.9;AP;67;NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.9; AL
	Data e regjistrimit	13/02/2024
	Numri i regjistrimit	16
<b>ÇERTIFIKATË E MBROJTJES SHITESË</b>	Patenta bazë	AL/P/2015/145
	Pronari i patentës bazë	Merck Canada Inc. / 16711 Trans-Canada Highway, Kirkland QC H9H 3L1, CA
	Numri/data e autorizimit për hedhjen e produktit në treg	10523 / 04/11/2022
	Produkti	Doravirinë 100mg
	Kohëzgjatja e ÇMSH	5 (pesë) vjet

Të dhëna mbi patentat, modelet e përdorimit dhe certifikatat e mbrojtjes shtesë të regjistruara në DPPI në periudhën Janar – Tetor 2025:

Objekti	Të dhënat	
<b>PATENTË KOMBËTARE</b>	Numri kombëtar i aplikimit	AL/P/2023/372
	Data e depozitimit	17/08/2023
	Titulli i patentës	Paisje per irigimin (shperlarjen/lavazhin) e syrit
	Pronari i patentës	Aleksandër Baci/KOLE HEQIMI 03310225; Nd. 10; H. 10; Ap. 7; SHKODËR; 4001; SHKODËR, AL
	Data e regjistrimit	25/06/2025

	Numri i regjistrimit	12969
<b>PATENTË NGA ZYRA EVROPIANE E PATENTAVE</b>	Numri kombëtar i aplikimit	AL/P/2025/487
	Data ndërkombëtare e depozitimit	25/02/2022
	Titulli i patentës	PISTOLETË GJYSMË AUTOMATIKE ME MODALITET TË DYFISHTË QITJEJE
	Pronari i patentës	Gestamen Kutatás Fejlesztés Zrt. / Csongrád 6640, Jókai u. 14. / HU
	Data e regjistrimit të vlefshmërisë	13/11/2025
	Numri i regjistrimit	13175
<b>MODEL PËRDORIMI</b>	Numri kombëtar i aplikimit	AL/U/2024/2
	Data e depozitimit	12/07/2024
	Titulli i modelit të përdorimit	PAKETIM PËR TRANSPORTIMIN E VEZËVE
	Pronari i modelit të përdorimit	DENTAŞ KAĞIT SANAYİ A.Ş./ Organize Sanayi Bölgesi 1. Kısım Nevzat Kuru Caddesi, No:15 TR-20330 Honaz/DENİZLİ/TÜRKİYE
	Data e regjistrimit	25/06/2025
	Numri i regjistrimit	19
<b>ÇERTIFIKATË E MBROJTJES SHITESË</b>	Patenta bazë	AL/P/2017/408
	Pronari i patentës bazë	Corteva Agriscience LLC / 9330 Zionsville Road Indianapolis, IN 46268, US
	Numri/data e autorizimit për hedhjen e produktit në treg	489 / 13.2.2024;
	Produkti	Oxathiapiprolin 3% (p/v) (30 g/L) + Mandipropamid 25% (p/v) (250 g/L)
	Kohëzgjatja e ÇMSH	5 (pesë) vjet

### Drejtoria e Ekzaminimit, Sektori i Markave, Disenjove dhe Treguesve Gjeografik

Aplikimi kryhet nga subjektet në portalin e-albania sipas procedurave të mirëpërcaktuara në rregulloret përkatëse dhe implementimi në sistem nëpërmjet një work flow në përputhje me afatet që përcakton ligji pasqyron në kohë reale fazat dhe kohë që duhet të ndjek çdo hap i aplikimit , më poshtë janë audituar disa raste aplikimi si:

**Modele aplikimesh në përputhje me aktet:**

1. Aplikim kombëtar me numër reference AL1-2024-00028072, numër aplikimi **AL/T/2024/933**

Paraqitja e aplikimit: 31/07/2024

Depozitimi i aplikimit: 31/07/2024

Ekzaminim formal përfundoi me sukses: 17/09/2024

Aplikime (marka tregtare)	Viti 2024 Aplikime totale	Viti 2024 (marka të regjistruara)	Deri ne 31.10.2025 Aplikime totale	Viti 2025 të regjistruara
Aplikime Kombëtare	1575	1020	1680	490
Aplikime Ndërkombëtare	2677	-	2379	-

Njoftim për shkaqe absolute: 13/11/2024

Ekzaminim për shkaqe absolute përfundoi me sukses: 18/11/2024

Publikim në buletin zyrtar (3 muaj): 10/01/2025

Ftese për pagesën e regjistrimit: 15/04/2025

Regjistrimi i markës: 22/04/2025

2. Aplikim kombëtar me numër reference AL1-2024-00020260, numër aplikimi **AL/T/2024/24**

Paraqitja e aplikimit: 05/01/2024

Depozitimi i aplikimit: 05/01/2024

Ekzaminim formal përfundoi me sukses: 15/02/2024

Ekzaminim për shkaqe absolute përfundoi me sukses: 12/03/2024

Publikim në buletin zyrtar (3 muaj): 27/03/2024

Ftese për pagesën e regjistrimit: 25/07/2024

Regjistrimi i markës: 23/09/2024

3. Aplikim kombëtar me numër reference AL1-2024-00023540, numër aplikimi **AL/T/2024/483**

Paraqitja e aplikimit: 15/04/2024

Depozitimi i aplikimit: 15/04/2024

Ekzaminim formal përfundoi me sukses: 28/05/2024

Ekzaminim për shkaqe absolute përfundoi me sukses: 10/06/2024

Publikim në buletin zyrtar (3 muaj): 21/06/2024

Ftese për pagesën e regjistrimit: 08/10/2024

Regjistrimi i markës: 28/10/2024

4. Aplikim kombëtar me numër reference AL1-2024-00034921, numër aplikimi **AL/T/2024/1550**

Paraqitja e aplikimit: 26/12/2024

Depozitimi i aplikimit: 26/12/2024

Njoftim për plotësim të kërkesave formale: 03/02/2025

Ekzaminim formal përfundoi me sukses: 12/02/2025

Ekzaminim për shkaqe absolute përfundoi me sukses: 13/02/2025

Publikim në buletin zyrtar (3 muaj): 28/02/2025

Ftese për pagesën e regjistrimit: 09/06/2025

Regjistrimi i markës: 27/06/2025

5. Aplikim kombëtar me numër reference AL1-2025-00035553, numër aplikimi **AL/T/2025/48**

Paraqitja e aplikimit: 20/01/2025

Depozitimi i aplikimit: 20/01/2025

Ekzaminim formal përfundoi me sukses: 13/02/2025

Ekzaminim për shkaqe absolute përfundoi me sukses: 20/02/2025

Publikim në buletin zyrtar(3 muaj): 28/02/2025

Ftese për pagesën e regjistrimit: 09/06/2025

Regjistrimi i markës: 16/06/2025

**6.** Aplikim kombëtar me numër reference AL1-2025-00042882, numër aplikimi **AL/T/2025/411**

Paraqitja e aplikimit: 28/03/2025

Depozitimi i aplikimit: 28/03/2025

Ekzaminim formal përfundoi me sukses: 28/04/2025

Ekzaminim për shkaqe absolute përfundoi me sukses: 27/05/2025

Publikim në buletin zyrtar(3 muaj): 13/06/2025

Ftese për pagesën e regjistrimit: 01/10/2025

Regjistrimi i markës: 20/10/2025

**7.** Aplikim kombëtar me numër reference AL1-2025-00047366, numër aplikimi **AL/T/2025/802**

Paraqitja e aplikimit: 21/05/2025

Depozitimi i aplikimit: 21/05/2025

Ekzaminim formal përfundoi me sukses: 23/06/2025

Ekzaminim për shkaqe absolute përfundoi me sukses: 25/07/2025

Publikim në buletin zyrtar (3 muaj): 19/08/2025

Ftese për pagesën e regjistrimit: 03/12/2025

Në pritje të pagesës së regjistrimit nga aplikanti.

**8.** Aplikim kombëtar me numër reference AL1-2025-00054206, numër aplikimi **AL/T/2025/1285**

Paraqitja e aplikimit: 18/08/2025

Depozitimi i aplikimit: 18/08/2025

Ekzaminim formal përfundoi me sukses: 24/09/2025

Ekzaminim për shkaqe absolute përfundoi me sukses: 14/10/2025

Publikim në buletin zyrtar (3 muaj): 22/10/2025.

## **Promovimi i Trajnimeve në Fushën e Pronësisë Industriale**

### **Qendra e Trajnimeve**

Qendra e Trajnimeve është pjesë e strukturës organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI) dhe zhvillon aktivitete trajnuese në këtë fushë detyrim që buron nga ligji 9947 datë 07.07.2008 “Për pronësinë Industriale”, i ndryshuar, VKM nr. 457, datë 3.7.2019 “Për miratimin e procedurave për pjesëmarrje në qendrën e trajnimeve në fushën e pronësisë industriale”, vkm e cila tregon dhe fillimin e veprimtarisë së qendrës.

Me VKM Nr. 327, datë 18.5.2022 u përcaktuan tarifat e lektorëve të cilët do të orfrojnë leksione të caktuara në fushën e pronësisë industriale.

Kjo Qendër është struktura përgjegjëse për forcimin e rolit të DPPI-së, si një institucion që regjistron dhe njeh të drejtat mbi objektet e pronësisë industriale, promovon rëndësinë e regjistrimit si dhe luan rol aktiv në formimin e koncepteve bazë në fushën e pronësisë industriale.

Qëllimi i ngritjes së Qendrës së Trajnimeve është rritja e ndërgjegjësimit mbi të drejtat që burojnë nga regjistrimi i objekteve të pronësisë industriale, nëpërmjet ofrimit të trajnimeve specifike dhe të dedikuara në këtë fushë.

### **Krijimi i Qendrave të Informacionit Tekniko-Shkencor (5 universitete)**

Me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të studentëve, stafit akademik dhe profesionistëve të përfshirë në punën kërkimore dhe shkencore, si dhe krijimin e një sistemi efektiv të informacionit për shpikjet në fushat e ndryshme të shkencës, DPPI ka nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi me disa universitete për ngritjen e Qendrave të Informacionit Tekniko-Shkencor. Këto universitete me të cilët janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi janë si vijon:

1. Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet DPPM-së dhe Universitetit Politeknik të Tiranës më datë 08.03.2013. Për realizimin e objektit të kësaj marrëveshje u ngrit pranë këtij Universiteti, Qendra e Informacionit Teknik dhe Shkencor.
2. Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet DPPI dhe Universitetit 'Ismail Qemali' Vlorë, e vitit 2017, për ngritjen e Qendrës së Informacionit Tekniko Shkencor për pronësinë industriale.
3. Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet DPPI dhe Universitetit "Fan S. Noli" të Korçës, e vitit 2018, për ngritjen e Qendrës së Informacionit Teknik Shkencor për pronësinë industriale. Funkzioni i kësaj qendre në këtë universitet, inkurajon dhe plotëson një hallkë të rëndësishme për kërkimin shkencor.
4. Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe Universitetit "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës, e vitit 2020 për ngritjen e Qendrës së Informacionit Teknik Shkencor për pronësinë industriale.
5. Nënshkruhet Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe Universitetit "Eqerem Cabej Gjirokastrë", e datës 28.03.2024 si dhe ngrihet Qendra e Informacionit Tekniko-Shkencor.

#### Aplikimet e ardhura në Sistemin SAPI

Qendra e Trajnimeve si strukturë përgjegjëse për zhvillimin e trajnimeve kryen me grupe të ndryshme interesi trajnime mbi fushën e Pronësisë Industriale. Nëpërmjet aplikimit online në portalin e-Albania, sipas shërbimit të dedikuar "Kërkesë për trajnim pranë Qendrës Trajnimeve".

Aplikanti ngarkon dokumentacionin e kërkuar:

Formulari standard i aplikimit i nënshkruar elektronikisht;

Mandat–pagesa për tarifën e pjesëmarrjes;

Pas dërgimit të aplikimit, sistemi gjeneron numër reference, ku aplikanti njoftohet automatikisht për ecurinë e procesit.

-Specialistja e autorizuar e Qendrës kryen verifikimet sipas procedurës;

-Shqyrtimi administrativ i dokumentacionit;

-Kontrolli i vlefshmërisë së mandat–pagesës, plotësimi i formularit dhe dokumenteve shoqëruese.

-Komunikimi me aplikantin në rast mangësish ose kërkesë për sqarim.

Në përputhje me dispozitat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 457, datë 03.07.2019 "Për miratimin e procedurave për pjesëmarrje në Qendrën e Trajnimeve në fushën e pronësisë industriale", si dhe përcaktimin e tarifave përkatëse", i ndryshuar dhe VKM-së nr. 327, datë 18.5.2022, pika 9 i këtij vendimi përcaktohen kriteret dhe kushtet për trajnim ku ***"numri i pjesëmarrësve, për çdo trajnim të organizuar nga Qendra, nuk duhet të jetë jo më i vogël se 10"***. Trajnimi ofrohet vetëm kur plotësohet numri minimal i pjesëmarrësve të përcaktuar për zhvillimin e programit. Me plotësimin e këtij numri Qendra e Trajnimeve në DPPI njofton të gjithë aplikantët për datën, orën dhe vendin e zhvillimit të trajnimit.

Pas përfundimit të trajnimit Çertifikata e përgatitur në sistem, firmoset elektronikisht dhe ngarkohet në llogarinë e aplikantit në e-Albania, i cili njoftohet automatikisht për shkarkimin e Çertifikatës.

## Kalendari i trajnimeve brenda vendit 2024-2025

Promovimi i objekteve të Pronësisë Industriale si dhe ndërgjegjesimi mbi rëndësinë e regjistrimit të tyre, të drejtat që burojnë nga ky proces, ka qenë një nga komponentët kryesorë të nismës së takimeve informuese të zhvilluara në disa qarqe të vendit i cili është edhe në objektivat e Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Industriale për vitet 2025-2027.

Në kuadër të planit të punës dhe angazhimit institucional për forcimin e njohurive mbi Pronësinë Industriale, gjatë vitit 2024-2025 janë zhvilluar një seri takimesh në qytete të ndryshme të vendit.

Takimet janë zhvilluar sipas një kalendari të paracaktuar në bashkëpunim me bizneset lokale dhe strukturat vendore, ku janë përfshirë qarqet me potencial për regjistrim të objekteve të pronësisë industriale. Ky Kalendar është dërguar për miratim në fillim të çdo viti pranë Ministrisë Përgjegjëse.

Qëllimi kryesor i këtyre takimeve është informimi dhe ndërgjegjësimi i bizneseve mbi regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale, nxitja e bizneseve lokale, krijimi e urave të bashkëpunimit midis institucioneve publike dhe komunitetit të biznesit si dhe identifikimin e produkteve potenciale për t'u regjistruar si tregues gjeografikë.

-Workshopet për Hartimin e Strategjisë së Qendrës së Trajnimeve: Bashkëpunimi me Projektin ALSIP dhe Partnerët e IP-së – 6 – 9 mars 2025:

-Misioni i Ekspertit Andreas Kurt për Hartimin e Strategjisë së Qendrës së Trajnimeve në Kuadër të Projektit ALSIP;

-Trajnim me Çertifikatë mbi Objektet e Pronësisë Industriale në DPPI;

-Trajnim mbi Rolin e ISHMT-së në Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Industriale;

-Trajnim i për Studentët e Universitetit Luarasi në Fushën e Pronësisë Industriale.

Pas përfundimit të çdo takimi, është përgatitur një memo përmbledhëse e cila përfshinte:

-Qëllimin e takimit dhe temat e trajtuara.

-Rekomandimet e dhëna nga bizneset, përfshirë nevojat për mbështetje institucionale, orientimin në proceset e aplikimit dhe kërkesat për trajnime shtesë.

-Një listë prezence, e bashkëngjitur memos, me pjesëmarrësit dhe përfaqësuesit e institucioneve.

-Promovimi ka shërbyer si nxitës kryesor për rritjen e interesit dhe aplikimeve për regjistrim e objekteve të pronësisë së këtyre bizneseve në DPPI.

Përfitimet e sjella nga mbrojtja ligjore, rritja e vlerës së produktit, diferencimi në treg – kanë motivuar operatorët të marrin hapa konkretë drejt regjistrimit.

## IV. 2. Programi i Zhvillimit Ekonomik dhe efektiviteti i menaxhimit financiar

Objektivi i auditimit: Vlerësimi nëse projekt programi i zhvillimit ekonomik është programuar, në përputhje me kriterin në fuqi dhe nëse programi i zhvillimit ekonomik është zbatuar sipas miratimit.

*Fushat të cilat do të merren në konsideratë gjatë auditimit:*

- Zbatimi i procedurave standarte në hartimin, miratimin e planit të buxhetit për periudhën objekt auditimi;
- Zbatimi vjetor i programit të miratuar të zhvillimit ekonomik, referuar periudhës së Auditimit;
- Kryerja e shpenzimeve në përputhje me planin buxhetor të miratuar sipas programeve buxhetore të programuar nga strukturat dhe këshilli mbikëqirës;
- Analiza e dokumentacionit financiar dhe efektiviteti i menaxhimit financiar.

Referuar periudhës së audituar, për auditimin e këtij sistemi u përzgjodh viti ushtrimor 17 Janar 2024 - 31 Tetor 2025.

1. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se hartimi i programit vjetor të zhvillimit ekonomik për vitin 2024 është kryer nga drejtori i finances A.RR, përgjegjësi i sektorit të financës I.S dhe specialiste buxheti N.R , sipas përcaktimit të paragrafit nr.4, të çështjes I. Proçesi i hartimit të programeve të zhvillimit ekonomik, të udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.15, datë 02.05.2018.

Me shkresën nr 2076 datë 05.12.2023 i është përcjellë Këshillit Mbikqyrës Projekt buxheti 2024 i DPPI-së për miratim pasi është sigluar nga Drejtori i Përgjithshëm R.B.

Aktiviteti i DPPI-së përcaktohet dhe rregullohet nga Ligji nr.9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Intelektuale”, i ndryshuar, rregulloret në zbatim të tij dhe ligjet e dispozitat në fuqi. Ky projekt buxhet është përgatitur në zbatim të Nenit 191/b të ligjit sipas të cilit:

1. Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbyllet me 31 dhjetor.
2. Veprimtaria e DPPI-së financohet nga të ardhurat e krijuara nga kryerja e veprimtarisë së saj në zbatim të këtij ligji dhe nga burime të tjera të ligjshme. Të ardhurat e realizuara por të paspërndara në fund të vitit derdhen në buxhetin e shtetit me përjashtim të:
  - a) Fondeve të parashikuara për investime;
  - b) Pagesave të menjëhershme për llogari të institucioneve ndërkombëtare të fushës për të cilat RSH ka detyrime financiare.

Treguesit kryesorë të buxhetit për vitin 2024 në bazë të pikës 1 të nenit 191/a dhe pikës 2/a dhe 2/b të nenit 191/b, të ligjit nr.9947, datë 07.07.2008, i ndryshuar, paraqiten si më poshtë:

000/lekë

Nr.	TE ARDHURAT	Plani 2024	Nr.	SHPENZIMET	Plani 2024
1	Aktivitet kryesor, regjistrim, administrim, promovim i objekteve PI	185,000	1	Shpenzime personeli	74,600
2	Të trashëguara, detyrime për organizata ndërkombetare, investime dhe projekte në vazhdim.	14,810	2	Te tjera detyrime (rimbursime)	2,183
3	Marrëveshja e Madridit	68,000	3	Shpenzime operative	16,287
4	Marreveshja e Hagës	1,400	4	Transferata korrente për organiz.nderkombetare	120,000
5	Të ardhura nga marreveshja e shtrirjes e patentave evropiane me ZEP (EPO)	160	5	Investime e Projekte	56,300
	<b>TOTALI I TE ARDHURAVE</b>	<b>269,370</b>		<b>TOTALI SHPENZIME</b>	<b>269,370</b>

Shpenzimet janë parashikuara duke patur parasysh prioritetet e përcaktuara nga DPPI në objektivat e vitit 2024. Shpenzimet kapitale ( shuma e transferuar nga viti 2023 plus projekte të tjera). Fondet me vlerë 14,810 lekë janë teprica të cilat alokohen së bashku me projektet e reja të vitit 2024.

Pas mbledhjes së datës 19.12.2023 për diskutimin dhe miratimin e projekt programit 2024, merret Me Vendimin e Keshillit Mbikqyres nr.4 datë 19.12.2023, me nr 2245 prot, datë 19.12.2023 “Për miratimin e Programit Financiar të DPPI-së dhe projektbuxhetet 01.01.2024-31.12.2024” është miratuar projektbuxheti i propozuar dhe materiali i përcillet ministrisë për miratim përfundimtar nga Këshillit i Ministrave së bashku me dokumentacionin e kërkuar.

Me Vendim të Këshillit Mbikqyrës nr.1 datë 06.02.2024 “Mbi miratimin e detajimit të zërave të buxhetit për vitin 2024 të DPPI-së”, miratuar me VKM nr.23 datë 17.01.2024 “Për miratimin e buxhetit për DPPI , viti 2024”.

***Detajimi i zërave të buxhetit paraqitur Këshillit Mbikqyrës rezulton i pafirmosur nga personat përgjegjës.***

Në Projekt buxhetin e v.2024 janë parashikuar gjithashtu shpenzime për personelin 74.6 milion lekë sipas zërave 000/ lekë të mëposhtëm:

- Pagat e administratës	47,000 lekë
- Pagat e punonjësve me kontratë për kohë te kufizuar	6,500 lekë
- Sigurime shoqerore e shendetsore	21,100 lekë

Ne zbatim të Vendimit të Këshillit Mbikqyrës nr.3 datë 10.07.2018”***Për miratimin e strukturës dhe organikës së DPPI-së” , numri i punonjesve është 39.***

Llogaritjet e pagave janë kryer duke u bazuar në VKM-në nr.325 datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”.

Në zbatim të Pikës 6/b te Kreut IV, të VKM-së nr.325 date 31.05.2023, ku citohet që institucionet duhet të bëjnë ndryshimet në strukturat dhe organikat ekzistuese për përshtatjen e tyre sipas klasave të përcaktuara në këtë vendim, DPPI me shkresat nr.572 date 17.07.2023 dhe dhe nr572/1 date 19.07.2023 “Mbi ndryshimet strukturore të DPPI-së”kanë dërguar DAP-it strukturën e përditësuar të organigramës së DPPI-së me 37 punonjës.

Për specialistët e ekzaminimit ka një shtesë për punë të veçantë në vlerën 10,000 lek/muaj.

Për stafin mbështetës llogaritjet janë bërë bazuar në vendimin nr. 326, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave, “Për Pagat e Punonjësve Mbështetës dhe Punonjësve të tjerë të Specialiteteve të ndryshme në disa Institucione të Administratës Publike”, dhe konkretisht sekretar titullari sipas Kateg,VII, Arkiv protokoll kateg.VI, Shofer Kateg.III.

Për vitin 2024 eshte parashikuar kontraktimi i punonjesve me kontratë të përkohshme pune, për vendet vakante në strukturë deri në plotësimin e tyre nga DAP dhe për funksionet mbështetëse që nuk janë në strukturë gjithsej 8 punonjes. Detyrimet e kesaj kategorie jane parashikuar ne shumën 21.1 milion lekë.

Shpenzimet për investime për vitin 2024 janë parashikuar si më poshtë:

Investim rrjeti elektrik	1.2 milion lekë;
Blerje orendi zyre	1.2 milion lekë;
Blerje pajisje kompjuterike	1.2 milion lekë;
Projekt “Permiresimi i sistemit te programit financiar Financa 5	400 mijë lekë;
Krijim dhe ridizenjim i faqes zyrtare të DPPI-së	1.2 milion lekë;
Projekt mbi rritjen e ndergjegjesimit te brezat e rinj	5.2 milion lekë;
Projekt mbi identifikimin dhe promovimin e treguesve gjeografik	4.8 milion lekë;
Projekt i AKSHI-t faza e dyte, mirembajtje mujore	23.2 milion lekë;
Projekt mbi dizenjot industriale “Industrial Design”	5.6 milion lekë;
Projekti “Mbro identitetin e PI të biznesit tënd mbi bizneset”	5.6 milion lekë;
Digitalizimi i Arkives se DPPI-së	5.5 milion lekë.

Hartimi i programit vjetor të zhvillimit ekonomik për vitin 2025 është kryer nga drejtori i finances A.RR, përgjegjësi i sektorit të financës I.S dhe specialiste buxheti N.R , sipas përcaktimit të paragrafit nr.4, të çështjes I. Proçesi i hartimit të programeve të zhvillimit ekonomik, të udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.15, datë 02.05.2018.

Me shkresën nr 4319/1 datë 12.11.2024 i është përcjellë Këshillit Mbikqyrës Projekt buxheti 2025 i DPPI-së Shoqërisë për miratim pasi është sigluar nga Drejtori i Përgjithshëm M.S.

Pas miratimit nga Këshilli Mbikqyrës ky projekt buxhet i është përcjellë ministrisë për tu miratuar nga Këshilli Ministrave i cili me Vendim nr.49 datë 221.01.2025 “Për miratimin e buxhetit për DPPI-në për vitin 2025”, ka miratuar buxhetin (plani i të ardhura-shpenzime për vitin 2025) në vlerën 375,358 mijë lekë.

Aktiviteti i DPPI-së përcaktohet dhe rregullohet nga Ligji nr.9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Intelektuale”, i ndryshuar, rregulloret në zbatim të tij dhe ligjet e dispozitat në fuqi.

Treguesit kryesorë të buxhetit për vitin 2025 në bazë të pikës 1 te nenit 191/a dhe pikes 2/a dhe 2/b të nenit 191/b, të ligjit nr.9947, datë 07.07.2008, i ndryshuar, paraqiten si më poshtë:

*000/lekë*

<b>Nr.</b>	<b>TE ARDHURAT</b>	<b>Plani 2025</b>	<b>Nr.</b>	<b>SHPENZIMET</b>	<b>Plani 2025</b>
1	Aktivitet kryesor, regjistrim, administrim, promovim i objekteve PI	196,000	1	Shpenzime paga dhe shtesa te tjera	55,600
2	Marrëveshja e Madridit	65,000	2	Pension vullnetar	3,500
3	Marreveshja e Hagës	1,400	3	Shpenzime per sigurime shoqerore e shendetsore	22,000
4	Të ardhura nga marreveshja e shtrirjes e patentave evropiane me ZEP (EPO)	100	4	Shpenzime operative	54,145
5	Të trashëguara investime e projekte vazhdim	28,800	5	Transferta korrente për organiz.nderkombetare	151,201
6	Të trashëguara detyrime për organiz.nderkombetare	84,058	6	Shpenzime per investime	88,912
	<b>TOTALI I TE ARDHURAVE</b>	<b>375,358</b>		<b>TOTALI SHPENZIME</b>	<b>375,358</b>

Fondet e parashikuara për investime per vitin 2025 në shumën 88,912 mijë lekë kanë ardhur si rezultat i tepricave për investime nga vitet paraardhëse 2023, 2024 nga mosrealizimi në kohë i tyre të cilat sipas ligjit të tyre do të trashëgohen tek investimet e ardhshme të paraqitura në buxhetin e vitit 2025 dhe të detajuara si vijon:

Blerje orendi zyre	1,2 milion lekë;
Blerje pajisje për sistemin e sigurisë	2 milion lekë;
Blerje pajisje kompjuterike	1,2 milion lekë;
Panairi Side Event	17 milion lekë;
Projekt “Rritja e kapaciteteve dhe forcimi i Qendres Trajnimeve “	6 milion lekë;
Projekt mbi rritjen e ndergjegjesimit te brezat e rinj	5.2 milion lekë;

Projekt mbi studimin, identifikimin dhe nxitjen e regjistr.të Treg/Gjeografik	5 milion lekë;
Digitalizimi i Arkives se DPPI-se	20.1 milion lekë;
Projekt mbi dizenjot industriale “Industrial Design”	5.6 milion lekë;
Projekti “Mbro identitetin e PI të biznesit tënd mbi bizneset”	5.6 milion lekë;
Projekt “Sistemim perpunim arkive të DPPI-së	20 milion lekë.

Grupi i Menaxhimit Strategjik pavarësisht urdhërit të brendshëm të Drejtorit i Pergjithshëm Urdher nr. 41, datë 06.03.2025 “Për ngritjen e GMS ”, duhet të ngrihet për çdo vit. Grupi i auditimit konstaton se komisioni nuk ka funksionuar dhe përveç Proçes Verbalit te dt.06.03.2025 nuk është dokumentuar asnjë PV takimi dhe diskutimi mbi objektiva strategjike konkrete dhe mbi hartimin e projekt buxhetit te institucionit per vitin 2025, pasi nuk disponohet asnjë Proçes Verbal takimi i firmosur nga GMS, ku të përcaktohen prioritetet dhe diskutimi i projekteve të parashikuara, arsyet e caktimit të këtyre projekteve si dhe analiza të tjera që duhet të behen në fazën e hartimit të projekt buxhetit të institucionit.

Kjo bie në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit Nr. 7 datë 28.2.2018 “Për proçedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, Pika 2.5, ku përcaktohen përgjegjësitë e Drejtuesit të Ekipit të Menaxhimit të Programit, ku në mënyrë më specifike, janë përgjegjës për:

-Shperndarjen e materialeve te nevojshme dhe organizimin e takimeve të ekipit të menaxhimit të programit në etapa të ndryshme të procesit të përgatitjes së kërkesave buxhetore, dhe përfshirjen e këtyre takimeve në kalendarin e përgatitur;

-Raportimin tek koordinatori i Grupit per Menaxhimin Strategjik i të gjitha mosmarrëveshjeve të lindura brenda ekipit të menaxhimit të programit, në lidhje me përgatitjen e kërkesave buxhetore.

-Koordinimin e punës së ekipit të menaxhimit të programit me nëpunësin zbatues.

Nga auditimi na rezulton se nuk është hartuar urdhër i brendshem per caktimin e Koordinatorit të Njesise per vitin 2024 , ndërsa per vitin 2025 me urdher të brendshëm nr.44 datë 12.03.2025 caktohet I.S kordinatore risku i cili ka një rol te rendesishem në mbarëvajtjen e punës të GMS.

Nga verifikimi i zbatimit të proçedurave për hartimin dhe planifikimin e buxhetit rezulton se:

DPPI është institucion publik jobuxhetor që regjistron, administron dhe promovon objektet e PI-së dhe funksionon si agjenci autonome nën mbikqyrjen e ministrit përgjegjës të ekonomisë.

*Në kuadrin ligjor të drejtorisë nuk janë përcaktuar proçedura të detajuara në mënyrë e planifikimit të buxhetit vjetor dhe afatet për strukturat përgjegjëse të miratimit të buxhetit apo raste për rialokime të mundshme.*

**Për disa zera të investimeve që kanë të bëjnë me digitalizimin e arkivës n vitin 2025, ka rritje te fondit të parashikuar nga 5.5 milion në 20 milion (rritje me 3.6 herë) duke mos argumentuar në mënyrë bindëse arsyet e rritjes së këij zëri.**

Në lidhje me realizimin e buxhetit te vitit 2024 dhe parashikim 2025 treguesit janë si më poshtë:

000/lekë

Nr.	TE ARDHURAT	Plan 2024	Fakt 2024	Realizim ne %	Difere nca
1	Aktivitet kryesor, aplikime kombetare	185,000	189,679	103%	4,679
2	Marrëveshja e Madridit	68,000	63,302	93%	-4,698
3	Marreveshja e Hagës	1,400	1,434	102%	34
4	Të ardhura nga ZEP (EPO)	160	24	15%	-136

TOTALI		254,560	254,439	100%	-121
Nr.	SHPENZIMET	Plan 2024	Fakt 2024	Realizimi ne %	diferenca
1	Shpenzime per paga dhe shtesa te tjera	74,600	61,576	83%	13,024
2	Shpenzime operative dhe korrente	18,470	14,742	80%	3,728
3	Transferta korrente per organiz.nderkombetare	120,000	35,942	30%	84,058
4	Shpenzime per investime	56,300	25,830	46%	30,470
TOTALI		269,370	138,368	51%	131,002

Realizimi për periudhën Janar – Tetor 2025 janë si më poshtë:

000/lekë

Nr.	TE ARDHURAT Janar – Tetor 2025	Plan 2025	Fakt 2025 J-T	Realizimi ne %	Fonde të disponueshme
1	Aktivitet kryesor, aplikime kombetare	196,000	168,794	86%	27,206
2	Të trashëguara investime proj ne vazhdim	28,800	4,524	16%	24,276
	Të trashëguara detyrime per organiz.nderkombetare	84,058	84,058	100%	0
3	Marrëveshja e Madridit	65,000	64,407	99%	593
4	Marreveshja e Hagës	1,400	2,104	150%	-704
5	Të ardhura nga ZEP (EPO)	100	524	524%	-424
TOTALI		375,358	324,411	86%	50,947
Nr.	SHPENZIMET Janar-Tetor 2025	Plan 2025	Fakt 2025 J-T	Realizimi ne %	Fonde të disponueshme
1	Shpenzime per paga dhe shtesa te tjera	81,100	49,730	61%	31,370
2	Shpenzime operative dhe korrente	52,045	27,987	54%	24,058
3	Transferta korrente per organiz.nderkombetare	151,201	87,728	58%	63,473
4	Te tjera detyrime (rimbursim P.A)	2,100	1,602	76%	498
5	Shpenzime për investime	88,912	19,814	22%	69,098
TOTALI		375,358	186,862	50%	188,496

Siç shihet edhe nga realizimi si 10 mujor i vitit 2025, shpenzimet për investime vazhdojnë të jenë në përqindje të ulët (22%) duke krijuar një gjendje të lartë monetare dhe mosrealizim të buxheteve të miratuara.

**Titulli i gjetjes:** Mungesa e realizimit të buxhetit të miratuar për tu shpenzuar për vitin 2024-2025, mungese e argumentimit të disa shpenzimeve për investime, gjendje e lartë e mjeteve monetare.

Gjetje Nr. 1	
<b>Subjekti i audituar</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale;
<b>Subjektet e interesuara nga gjetja</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale ; Drejtori i Përgjithshëm ;

	Drejtori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse; Përgjegjës Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse;
<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	Ligji për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH; Udhëzimet në zbatim të Ligjit për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor; Rregullore e Brendshme e DPPI-së;
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<p><b>Situata:</b> Nga auditimi i buxhetit të vitit 2024, konstatohet se art. 602 “Shpenzime operative” janë realizuar (80% realizim).</p> <p>Në vitin 2024 rezulton që shuma prej 67.304 mijë lekë është derdhur në buxhetin e shtetit me vonesë, në Bankën Kombëtare Tregtare me datë 06.08.2024 me përshkrimin “Degës së Thesarit, tepricë derdhje në buxhetin e shtetit nga DPPI”, tepricë e cila përfaqëson diferencën e shpenzimeve operative dhe personelit të planifikuara në buxhet me shpenzimet faktike të ketyre zërave për vitin 2023 pavarësisht se pasqyrat financiare janë certifikuar para kësaj date.</p> <p>Në vitin 2025 rezulton që shuma prej 16.752 mijë lekë është derdhur në buxhetin e shtetit me vonesë, në Bankën Kombëtare Tregtare me datë 18.08.2025 me përshkrimin “Degës së Thesarit, tepricë derdhje në buxhetin e shtetit nga DPPI”, tepricë e cila përfaqëson diferencën e shpenzimeve operative dhe personelit të planifikuara në buxhet me shpenzimet faktike të ketyre zërave për vitin 2024, me vonesë, pavarësisht se pasqyrat financiare janë certifikuar në maj 2025.</p> <p>Realizim të ulët kemi në Artikullin 605 “Transferta korrente ne organizmat ndërkombëtarë” i cili paraqitet i realizuar në masën 30% e cila përfaqëson pjesën e patransferuar të fondit pranë Zyrës Evropiane të Patentave(EPO) e cila është trashëguar dhe pagesa do të kryhet gjatë vitit 2025, Artikulli 230-231 “Shpenzime kapitale”, paraqitet i realizuar në masën 46% ku pjesa e porealizuar e fondit trashëgohet dhe pritet te realizohet gjate vitit 2025.</p> <p>Gjithashtu rezulton se nuk është përdorur gjithë fondi i miratuar sipas llogarive analitike të buxhetit në shpenzimet korente dhe të investimeve, pavarësisht planit vjetor të miratuar për kryerjen e shpenzimeve të tyre. Për këtë arsye do të derdhet në buxhetin e shtetit teprica e të ardhurave dhe mosrealizimit të shpenzimeve. Gjatë vitit 2026 pas miratimit dhe certifikimit të Pasqyrave financiare deri më 31 mars 2026, duhet të derdhet në buxhetin e shtetit si tepricë derdhje në buxhetin e shtetit nga DPPI, tepricë e cila përfaqëson diferencën e shpenzimeve operative dhe personelit të planifikuara në buxhet me shpenzimet faktike të ketyre zërave për vitin 2025.</p>

	<p>Si përfundim, në lidhje me përdorimin efektiv të fondeve të miratuara gjatë vitit ushtrimor dhe realizimin e tyre është përgjegjësi e sektoreve të financës të cilat ju adresohen fondet për përdorim gjatë vitit, ndaj duhet një bashkëpunim më efektiv dhe në kohë të këtij sektori dhe sektorëve të tjerë të cilat ju adresohen fondet, për nivelin e realizimit të tyre me qëllim për të bërë rishpërndarjen në kohë të fondeve të përdorura. Sektori i Financës dhe strukturat e tjera, janë përgjegjëse për menaxhimin dhe klasifikimin buxhetor; kryerjen e analizave për shpenzimet operative dhe kapitale të buxhetit në kohën e duhur për tu përdorur, për të dhënë ndikim pozitiv në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të përdorimit të buxheteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave gjatë vitit 2024 dhe 2025.</p> <p><i>Trajtimi i gjetjes nga audituesi, për çështjen Sistemi i menaxhimit buxhetor nuk ndryshon, sepse subjekti i audituar nuk ka kundërshtuar çështjen e realizimit dhe raportimit të buxhetit me fakte apo dokumente justifikuese, mbi këtë bazë, nuk ndryshon qendrimi lidhur me gjetjen dhe rekomandimet e lëna.</i></p> <p><b>Kriteri:</b> -Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;</p> <p>-Ligji Nr.10296, datë 08/07/2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar;</p> <p>-Udhëzimi nr.22, datë 17.11.2016 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit";</p> <p>-Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar.</p> <p>Neni 10, Pika i, e Rregullores së Brendshme të DPPI-së;</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Mosrealizimi i buxhetit sipas artikujve përkatës, të paraqitur gjatë trajtimit të situatës, ka ndikim në mos realizimin e objektivave kryesore, për përmbushjen e të cilave është akorduar ky buxhet.</p> <p><b>Shkaku:</b> Mungesa e menaxhimit të buxhetit dhe bashkëpunimi më efektiv dhe në kohë të drejtorive respektive të cilat ju adresohen fondet, si dhe transferimi i fondeve korrente dhe për investime ka sjellë apati në strukturat e institucionit për realizimin në kohë të investimeve.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut</b>	I mesëm

<b>Konkluzioni</b>	Gjatë periudhës së audituar konstatohet mosrealizim dhe realizim mjaft i ulët në shpenzimet korrente, të akorduara për kryerjen e shpenzimeve të projekteve; si dhe mosrealizim në fondin e shpenzimeve kapitale të perealizuara dhe të transferuara gjatë muajit dhjetor 2024. Mungesa e realizimit të fondeve të akorduara për kryerjen e shërbimeve dhe projekteve në art. 602/5 e art. 231/1, dhe realizimi i ulët në art. 605 dhe 602/1, nuk ka siguruar përmbushjen e objektivit institucional, për realizimin e fondeve buxhetore, të miratuara nga Këshilli i Ministrave.
<b>Rekomandimi</b>	- DPPI me strukturat e saj, duhet të synojnë nivele të larta të realizimit të fondeve në dispozicion sipas artikujve ekonomik buxhetor, programeve të detajuara për shpenzime korrente dhe të projekteve për shpenzime kapitale të cilat transferohen prej disa vitesh duke krijuar gjendje të lartë të mjeteve monetare. -DPPI në bashkëpunim me strukturat e ministrisë përgjegjëse, duhet të kenë në vëmendje raportimet mbi zbatimin e buxhetit, të marrin masa për menaxhimin e fondeve të papërdorura, brenda vitit ushtrimor.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	<i>Të ndiqen realizimi i fondeve dhe raportimet për çdo vit ushtrimor</i>
<b>Statusi i rekomandimit</b>	<i>Statusi i gjetjes dhe rekomandimi dhe niveli i riskut për gjetjen nuk ndryshon</i>

### *Raportimi i shpenzimeve dhe monitorimi i zbatimit të buxhetit për vitin 2024 dhe 2025*

Raportimi i monitorimit të 8- mujorit 2024 dhe 2025 nuk është kryer sipas udhëzimit të Ministrisë së Financës nr. 22, datë 17.11.2016 dhe udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023, e konkretisht deri më 30 shtator.

2. Gjatë auditimit u konstatua se, nuk është përgatitur “informacion shtesë” për parashikimin e realizimit të pritshëm deri në fund të vitit si për produktet edhe për shpenzimet, duke dhënë argumenta që realizimi mundet të jetë i njëjtë me planin fillestar, ose më i madh ose më i vogël se sa plani aktual, sipas kreut të III-të, pika 42 të udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për informacionin e treguesve ekonomiko- financiar “, e përcaktuar në urdhërin e MFE nr.125, datë 08.04.2019 “Për raportimin e Këshillave Mbikëqyrës” i dërgohet informacion Këshillit Mbikëqyrës dhe ministrisë përgjegjëse . Pra nuk është raportuar për periudhën progresive 1 Janar – 31 dhjetor 2024 dhe 1 Janar – 31 Tetor 2025.

**Titulli i gjetjes:** Mungesa e një “Informacioni shtesë” për parashikimin e realizimit të shpenzimeve të projekt programit ekonomik për vitin 2024 dhe 2025.

<b>Gjetje Nr. 2</b>	
<b>Subjekti i audituar</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale Tiranë

<b>Subjektet e interesuara nga gjetja</b>	Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit Drejtori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse; Përgjegjësi i financës Këshilli mbikqyrës
<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; i ndryshuar; -Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 22, datë 17.11.2016 “Për Procedurat Standarte të Monitorimit të Buxhetit për njesitë e Qeverisjes Qendrore”; -Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 14, datë 30051.2023 “Për Procedurat Standarte të Monitorimit të Buxhetit për njesitë e Qeverisjes Qendrore”; -Urdhëri i MFE nr.125, datë 08.04.2019 “Për raportimin e Këshillave Mbikëqyrës”.
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<p><b>Situata:</b> Nga auditimi rezultoi se nuk është përgatitur informacion shtesë që ka të bëjë me një parashikim të realizimit të pritshëm deri në fund të vitit 2024 dhe 2025, si për produktet edhe për shpenzimet, duke dhënë argumenta që realizimi mundet të jetë i njëjtë me planin fillestar, ose më i madh ose më i vogël se sa plani aktual, nga raportimi i monitorimit të 8-mujorit 2024, të buxhetit në tërësi dhe projekteve me financim nga buxheti.</p> <p><b>Kriteri:</b> -Kreu i III-të, pika 42 “Një informacion shtesë për parashikimin e realizimit të pritshëm deri në fund të vitit”, të udhëzimit nr.22, datë 17.11.2016 të M.Financave “Për Procedurat Standarte të Monitorimit të Buxhetit për njesitë e Qeverisjes Qendrore.</p> <p>-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 14, datë 30051.2023 “Për Procedurat Standarte të Monitorimit të Buxhetit për njesitë e Qeverisjes Qendrore”;</p> <p>Urdhëri i MFE nr.125, datë 08.04.2019 “Për raportimin e Këshillave Mbikëqyrës”.</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Mos përgatitja e informacionit shtesë, ndikon në vlerësimin e realizimit të performancës të planifikuar dhe objektivave të qëllimit të programit të shpenzimeve dhe të produkteve për vitin 2024 dhe 2025.</p> <p><b>Shkaku:</b> Mungesa e bashkëpunimit të Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues, me Këshillin mbikqyrës dhe mungesë raportimi në ministrinë përgjegjëse për ekonominë.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut</b>	I Mesëm
<b>Konkluzioni</b>	Mungesa e informacionit shtesë për parashikimin e realizimit të pritshëm deri në fund të vitit për produktet dhe për shpenzimet, krijon mosrealizim të objektivave dhe qëllimit të programit ekonomik të shoqërisë për vitin 2024. Nuk kanë të argumentuar që realizimi mundet të jetë i njëjtë me planin fillestar, ose më i madh ose më i vogël se sa plani aktual, nga mungesa e raportimit të monitorimit të 8-mujorit 2024 dhe 2025, të buxhetit të siguruar nga të ardhurat e krijuara nga shërbimet e ofruara.
<b>Rekomandimi</b>	Të përgatitet informacion shtesë në lidhje me parashikimin e realizimit të pritshëm të buxhetit të miratuar me shpenzimet e realizuara, në vëmendje të

	struktues së financës dhe buxhetit, gjatë raportimit 8 mujor të vitit buxhetor 2026 dhe vijues.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	<i>Sipas rekomandimit gjatë çdo viti ushtrimor</i>
<b>Statusi i rekomandimit</b>	<i>Opservacini është vetë sqarues, nuk ndryshon rekomandimi dhe niveli e riskut</i>

#### IV. 3. Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave të DPPI

Objektivi i auditimit: Vlerësimi nëse tarifat për regjistrimin e objekteve të Pronësisë Industriale, janë aplikuar sipas përcaktimeve të akteve nënligjore në fuqi, Ligji nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar; Vlerësimi nëse në procedurat e kryera janë zbatuar tarifat sipas VKM-së Nr.883 datë 13.05.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të Pronësisë Industriale”, e ndryshuar sipas lidhjeve 1-8 që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij si më poshtë:

- Krijimi dhe evidentimi i të ardhurave nga regjistrimi i objekteve të Pronësisë Industriale, sipas tarifave të miratuara në VKM-në “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të Pronësisë Industriale” dhe përdorimi i të ardhurave të arkëtuara.

Të ardhurat që realizon DPPI-ja, janë:

- Të ardhurat që krijohen nga aktiviteti i saj;
- Të ardhurat që krijohen nga tarifat e Sistemit të Madridit për regjistrimin e markave ndërkombëtare, Marreveshja e Hagës për aplikimet ndërkombëtare për disenjo industriale si dhe të gjitha marrëveshjet e tjera në fushën e pronësisë industriale;
- Të ardhura të tjera që mund të krijohen sipas legjislacionit në fuqi;

Të ardhurat përdoren nga DPPI-ja për pagat, sigurime, shpërblime, shpenzime operative dhe investime kapitale, aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit të nevojshme për ushtrimin dhe realizimin e funksioneve të DPPI-së si dhe kontributeve që rrjedhin nga antarësimi i RSH në organizmat ndërkombëtarë të PI-së.

Veprimtaria e DPPI-se financohet nga të ardhurat e krijuara nga kryerja e veprimtarisë së saj dhe nga burime të tjera të ligjshme.

Të ardhurat e e paspërndara në fund të vitit derdhen në buxhetin e shtetit me përjashtim:

- Fonde të parashikuara për investime;
- Pagesa të menjëhershme për llogari të institucioneve ndërkombëtare sipas të cilave RSH ka detyrime financiare.

Për periudhën e përzgjedhur Janar-Dhjetor 2024 dhe Janar-Tetor 2025, të ardhurat e realizuara nga regjistrimi i objekteve të Pronësisë Industriale të cilët janë:

Viti 2024	269,249 mijë lekë	100% realizim
Viti 2025 (Janar-Tetor 2025)	324,411 mijë lekë	86% realizim

Rritja e numrit të lartë të aplikimeve dhe rritja e cilësisë së shërbimeve në këtë fushë, gjatë viteve të fundit, për objektet e pronësisë industriale është shoqëruar me rritje të të ardhurave të DPPI-së,

Realizimi i të ardhurave neto sipas viteve ka një trend rritje si më poshtë:

Viti 2022	239,348
Viti 2023	250,562
Viti 2024	256,920
Viti 2025(J-T)	324,411

Nga pikëpamja e regjistrimit të tyre në kontabilitet u vërejtën mangësi në regjistrimin e tyre në kohë reale duke sjell vështirësi në raportime periodike të tyre dhe në ndjekjen e arkëtimit nga subjektet aplikues.

**Këshillojmë**, regjistrimi i të ardhurave të krijuara nga tarifata në kontabilitet të bëhet sipas subjekteve aplikues dhe të rritet bashkëveprimi midis sektorëve të financës dhe buxhetit me sektorët e ekzaminimit për të bërë të mundur verifikimin e pagesave të kryera nga aplikantët në kohë reale me qëllim shmangien e deklaramit të pagesave jo të rregullta nga aplikuesit në e-albania.

-Në vijimësi institucioni të komunikoj me administratën tatimore për mënyrën e deklaramit të të ardhurave të krijuara nga ana e tyre dhe raportimin nëpërmjet faturimit elektronik në platformën e fiskalizimit.

### ***Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera përmes bankës***

Sqarojmë se DPPI-ja si institucion publik dhe jo buxhetor ndryshe nga institucionet buxhetore nuk i kryejnë veprimet nëpërmjet Degës së Thesarit por nëpërmjet Bankave të nivelit të dytë dhe konkretisht me BKT-në. Në pagesat e kryera me transfertat e plotësuara u konstatuan mangësi në hartimin dhe mbajtjen e dokumentacionit justifikues për lëvrimin e tyre, Nuk është bërë regjistrimi dhe kontabilizimi i rregullt në fund të çdo muaji në programin Financa 5, por ato regjistrohen me vonesë dhe veprimet me bankën shikohen në statementin e bankës, kjo për sa i përket veprimeve të kryera gjatë vitit 2024 dhe gjatë vitit 2025. Nga verifikimi i regjistrimit të veprimeve, edhe shpenzimet sipas urdhër-transfertave nuk janë të regjistruara në kohë e duhur. Në përgjithësi urdhër transfertat kishin të bashkëlidhur dokumentin justifikues si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, por në shumë raste mungojnë proces verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, ndersa për pagat e punonjësve për vitin 2024 dhe 2025 ishin të bashkëlidhur listëpagesat (borderotë e punonjësve), por pa numrin rendor të punonjësve, listëprezencat, urdhrat e emërimeve dhe largimeve, raportet mjeksore, fletëlejet e pushimeve të punonjësve, edhe për dietat dhe pagesa të tjera kishte dokumente justifikuese, etj.

Nga auditimi rezultoi se shpenzimet janë kryer në përputhje me planin buxhetor të miratuar, sipas programeve të institucionit dhe janë regjistruar sipas klasifikimit buxhetor ekonomik në ditarin e shpenzimeve.

Nga verifikimi i urdhër transfertave dhe dokumentacionit shoqërues bashkëlidhur, nuk rezultoi se kontraktuesi e ka realizuar objektin e kontratës jashtë afatit kontraktual me përjashtim të disa rasteve si projekti për treguesit gjeografikë. Nga ana e nëpunësit zbatues dhe komisioneve, nuk është ndjekur në çdo rast furnizimi e mallit/shërbimit brenda afatit kontraktual dhe është likuiduar vlera e plotë e kontratës pa dokumentet justifikues si PV i marrjes së mallit/shërbimit.

Gjatë verifikimit të shpenzimeve udhetim dhe dieta të punonjësve për shërbimet e kryera brenda dhe jashtë vendit, për vitin 2024 dhe 10 mujorin 2025, u konstatua se Dppi ka hartuar Kalendarin e aktiviteteve jashtë vendit dhe e ka miratuar në ministrinë përgjegjëse për ekonominë për vitin 2024 me shkresën nr.519 datë 07.02.2024 dhe për vitin 2025 me shkresën nr.4858 datë 13.12.2025, nga auditimi i pagesave për shpenzime dietash rezultoi se, dokumentat origjinale të paraqitura rakordojnë

me shumën e dietës së paguar. U konstatua se nuk kishte mungesë të dokumenteve justifikues si autorizime, urdhër-shërbime, fatura elektronike dhe miratimi nga MEKI/Punonjësit të autorizuar prej tij, për stafin shoqëruar, por në disa raste mungonte Bording pass, urdher shërbimet plotësohen me vlerën e akomodimit në lekë dhe jo në euro konvertuar me kursin zyrtar të ditës, rezervimi i hotelit bëhet nga një subjekt dhe faturat e fiskalizuara nuk përmbajnë artikujt akomodim dhe komision rezervimi si dhe vlerën e monedhës së huaj si dhe nuk kanë bashkëngjitur faturat e hoteleve të rezervuara me qëllim përcaktimin e yjeve sipas udhëzimit dhe emrat e punonjesve të dërguar me shërbim jashtë shtetit.

Llogaritja e dietave për shërbimet në vendet që operojnë me monedhë CHF (frange zviceriane), llogariten për punonjësit pjesëmarrës në këtë monedhë dhe jo në euro/usd sipas Vendimit nr. 870 datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, Lidhja 1: Masa e dietës në valutë të huaj sipas kategorive.

Me Autorizimin nr.3786/3 date 30.09.2025 janë autorizuar 2 punonjes A.S dhe J.B për të marrë pjesë në konferencën “Takimi i 10-të të rrjetit kundër Takimi i 10-të të rrjetit kundër mashtrimeve(Anti-Scam Network). Me shkresën nr.11600/1 date 18.09.2025 MEKI miraton kërkesën për kryerjen e shërbimit jashtë vendit për 2 persona. Nga grupi i auditimit konstatohet se ka marrë dieta vetëm një punonjës J.B, kur ftesa citon se EUIPO do të mbulojë shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit dhe si rrjedhojë duhet të marrë dietë edhe punonjësi A.S.

Këshillojmë se edhe punonjësi tjetër duhet të plotësojë urdhër shërbimi për dietat që i takojnë, pasi nuk e ka ndjekur on line takimin por ka qenë pjesëmarrës në konferencë.

#### **IV. 4. Sistemi i pagave dhe menaxhimi i burimeve njerëzore**

Objektivi i auditimit: Vlerësimi nëse burimet njerëzore menaxhohen në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe me strukturën organizative të miratuar. Fushat që do të merren në konsideratë gjatë auditimit:

- Respektimi i numrit të punonjësve në total dhe sipas emërtimeve për çdo drejtori/sector e shërbim me strukturën organizative të miratuar.
- Procedurat ligjore të emërimeve të personelit në punë duke filluar nga kërkesa për vend të lirë, shpallja e deri tek lidhja e kontratës së punës; si dhe ndjekja e procedurave ligjore për largimet e personelit nga puna.
- Përshtatje e diplomës me vendin e punës, përshkrimet e punës dhe vlerësimi vjetor i performancës në punë dhe administrimi i kontratave të punës dhe dosjeve të personelit.
- Përlllogaritja e pagës bruto dhe neto në përputhje me emërtesën në strukturë dhe me vendimin përkatës të Këshillit Mbikqyrës.

-Nga auditimi i ushtruar rezultoi se për periudhën e audituar është respektuar numri i punonjësve, sipas strukturës dhe organikës së DPPI-së, të miratuar nga këshilli mbikqyrës për çdo vit kalendarik “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së DPPI-së, ku aktualisht është 37 veta.

Numri i punonjësve gjithsej është 37, sipas organikës si vijon: I. Drejtor i Përgjithshëm 1; II. Drejtoria e Ekzaminimit (15), drejtor 1 dhe 14 punonjës; III. Drejtoria e Koordinimit Promovimit, Trajnimeve dhe Analizës (9), drejtor 1 dhe 8 punonjës; IV. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse (7), drejtor 1 dhe 6 punonjës; V. Sektori Juridik (3), përgjegjës sektori 1 dhe 2 punonjës; Rezultoi se gjatë periudhës së audituar janë marrë deri në 10 punonjës të përkohshëm, sipas

përcaktimeve në vendimet përkatëse të këshillit mbikqyrës për çdo vit kalendarik. Në gjykimin tonë institucioni për plotësimin e vendeve vakant të shtojë përpjekjet për plotësimin e tyre me shpalljen e vendeve vakante duke ndjekur procedurat sipas ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar duke kufizuar numrin e marrjes në punë të specialistëve me kontrata të përkohshme pune në drejtoritë e përmbajtjes për shkak të ruajtjes së cilësisë së ekzaminimit dhe të një shërbimi cilësor pasi janë shërbim të me subjektet tregtare dhe të huaja.

-Konstatohet se ka pasur disa veprime te paarsyetuara nga titullari i institucionit në lidhje me urdhërat dhe vendimet e nxjerra për punonjësit E.R, A.Rr, R.B të cilat janë konsideruar të pavlefshme pas procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, në lidhje me veprime administrative të kryera gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e paligjshmerisë së konstatuar nga KMSHC (Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil).

Me vendimet e KMSHC nr. 38 datë 19.06.2024; nr. 36 datë 19.09.2025; nr. 41 datë 13.10.2025 “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të vendimeve të komisionerit nr. 30, nr. 31 dhe nr. 37, institucioni ka reflektuar duke zbatuar detyrat e lëna sipas vendimeve respektive.

Nga verifikimi me përzgjedhje i listëpagesës për muajin Mars, Maj dhe Tetor 2024 si dhe Shkurt, Prill, Korrik dhe Tetor 2025, rezultoi se është respektuar numri i punonjësve në total sipas emërtimeve, për çdo Drejtori drejtorie dhe Sektor me vete dhe brenda drejtorive, në strukturën organizative të miratuar, si dhe kishte përputhje të listëpagesave të dërguara në bank me urdhër shpenzimet e pagave të kaluara në BKT Tiranë.

1. Nga auditimi i procedurave të ndjekura lidhur me emërimet e personelit për periudhën e audituar rezultoi se mungojnë procedurat e rekrutimit të punonjësve. U konstatua se marrja në punë e punonjësve është kryer sipas një procesi të mbyllur, pa transparencë e konkurrencë. Njoftimi i vendit të lirë të punës në asnjë rast nuk është kryer në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare të institucionit, *por ka mjaftuar vetëm marrja në punë e 10 punonjësve me kontratë të përkohshme për periudhën e audituar dhe me dokumentacion jo të plotë.*

**Titulli i gjetjes:** Marrja e punonjësve në punë me kontratë të përkohshme, pa ju nënshtruar procedurave të konkurimit.

<b>Gjetje Nr. 1</b>	
<b>Subjekti i audituar</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Intelektuale
<b>Subjektet e interesuara nga gjetja</b>	Drejtori i Përgjithshëm Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse Sektori Juridik Specialisti i ngarkuar me personelin
<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	-Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; -VKM nr. 176, datë 29.03.2006 “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”; -Vendimet të këshillit mbikqyrës për periudhën 2024-2025.
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<b>Situata:</b> Për periudhën e audituar rezultoi se në të gjitha rastet marrja në punë e punonjësve është kryer pa procedurë konkurimi; shpallja e vendit të lirë të punës nuk është njoftuar në buletin e njoftimeve

	<p>publike dhe faqen zyrtare të institucionit. Punonjësit janë rekrutuar vetëm me kontratë të përkohshme pune, pa nënshkruar kontratën individuale të punonjësit. Rezultuan punonjësit të marrë në punë pa procedurë konkurimi (G.V; A.B; F.L; D.M; F.XH; E.R; N.N; R.G; M.T, etj). Struktura organike, e miraturar prej 37 punonjës me vendim të këshillit mbikqyrës në vitin 2023, nuk është përshtatur me nevojat dhe ndryshimet, në përshtatje me vendet e punës, për siguruar mos marrjen me kontratë të përkohshme të punonjësve me arsim të lartë, për të cilat vëndet e punës të plotësohen nepermjet procedurave të rekrutimit të nëpunësve civil me DAP.</p> <p><i>Meqenëse struktura e re e Dppi-së është miratuar në gjatë periudhës së raportimit në mars 2026, gjetja është pranuar për pjesën e rishikimit të strukturës.</i></p> <p><b>Kriteri:</b> Në nenin 5 “Parimi i transparencës”, të ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, përcaktohet: “<i>Organet publike ushtrojnë veprimtarinë administrative në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në të</i>”.</p> <p>Referuar pikës 1 dhe 2 të VKM nr. 176, datë 29.03.2006 “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”, institucionet shtetërore duhet t’i publikojnë njoftimet për vendet vakante të punës në Buletinin e Njoftimeve Publike.</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Moszbatimi i akteve ligjore e nënligjore, nuk ka siguruar transparencë dhe konkurrencë në procedurat e rekrutimit të punonjësve, si dhe trajtimin e barabartë të punëmarrësve.</p> <p><b>Shkaku:</b> Mungesa e përditësimit me aktet ligjore/nënligjore në fuqi.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut</b>	I Mesëm
<b>Konkluzioni</b>	<p>Rekrutimi i punonjësve është kryer pa shpallje të vendit të lirë të punës në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe faqen zyrtare të institucionit; punonjësit janë marrë në punë me kontratë të përkohshme, duke shmangur procesin e konkurimit dhe sjellë si pasojë mos sigurimin e transparencës dhe konkurrencës gjatë punësimit të punonjësve në DPPI. Regullorja e brendshme nuk ka përcaktuar saktë procedurën e punësimit për punonjësit me arsim të lartë, dhe punonjësit mbështetës me arsim të mesëm, në lidhje me zhvillimin e procedurës së konkurimit dhe emërimit të punonjësve.</p>
<b>Rekomandimi</b>	<p>-Të bëhet shpallja e gjithë vendeve vakante në Buletin e Njoftimeve Publike dhe faqen zyrtare të institucionit,si dhe të rishikohen nenet e regullores së brendshme dhe të përcaktohen kriteret e punësimit, i cili duhet të përcaktojë saktë procedurat e rekrutimit nëpërmjet procedurave të konkurimit publik.</p>

	-Të bëhet marrja e punonjësve në punë me kontratë të përkohshme në përpjestim të drejtë me numrin total të organikës së re.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	<i>Të veprohet menjëherë dhe në vijim.</i>
<b>Statusi i rekomandimit</b>	<i>Observacioni për strukturën e re u pranua pjesërisht, por do ndiqet rekomandimi i lënë, niveli i riskut dhe statusi nuk ndryshon</i>

2. Nga auditimi i dosjeve të personelit, u kostatua se Dppi ka administruar dosjet e personelit në përputhje me kërkesat e VKM nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” dhe me kërkesat e VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, megjithatë u vërejtën edhe disa mangësi të cilët po i trajtojmë në vijim.

**Titulli i gjetjes:** Mangësi në administrimin e dosjeve të personelit, përkatësisht tek punonjësit me kontratë të përkohshme.

<b>Gjetje Nr. 2</b>	
<b>Subjekti i audituar</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Intelektuale
<b>Subjektet e interesuara nga gjetja</b>	Drejtori i Përgjithshëm e Pronësisë Industriale Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse Sektori Juridik Specialisti i ngarkuar me personelin
<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	VKM nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”; Sipas VKM nr.833, datë 28.10.2020, “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<b>Situata.</b> Nga auditimi i dosjeve të personelit, u kostatua se Dppi ka administruar dosjet e personelit në përputhje me kërkesat e VKM nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” dhe me kërkesat e VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, megjithatë u vërejtën edhe disa mangësi të cilët po i trajtojmë në vijim:  1- Mungesë të kontratës individuale të punës. 2- Librezat e punës administrohen në dosje të veçantë, por duhet të mbahen në dosjen e çdo nëpunësi me status civil dhe çdo punonjësi me kontratë të përkohshme. 3- Mungesë të raportit mjeko ligjor dhe rifreskim të tij për çdo vit kalendarik. 4- Mungesë të kërkesës për punë të protokolluar dhe dëshmisë së penalitetit në të gjitha dosjet e punonjësve.

- 5- Dosjet e dy këshilltarëve me kontratë përkohshme me dokumenta të pa sistemuar dhe pa fletë inventari në dosje.
- 6- Në disa raste të dosjeve ka mungesë të çertifikatës personale dhe familjare.
- 7- Vlerësimi vjetor i punonjësve dhe akti i emerimit në pozicionin e punës mbahej në një dosje të veçantë, por ato duhet të përfshihen në dosjet e secilit punonjës dhe në inventarin e dosjes.

Në vijim, për të gjitha dosjet e punonjësve të kërkohet rifreskimi i dokumentave si dhe ri inventarizimi i tyre.

**Kriteri:** Në lidhjen 1, të VKM nr.833, datë 28.10.2020, “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të rregjistrit qëndror të personelit”, përcaktohet:

“Në dosjen e të punësuarit duhet të përfshihen:

1. Fletë inventari i dosjes së të punësuarit, që përmban listën e dokumentave pjesë të dosjes, sipas lidhjes nr.2,
2. Dokumentat që duhet të përmbajë dosja e personelit e që vërtetojnë pohimin e bërë në fletën prezantuese janë:

- a) fotokopje e dokumentit të identifikimit (letërnjoftim ose pasaportë);
- b) çertifikatë personale dhe çertifikatë të gjëndjes familjare;
- c) dokument që vërteton përfundimin e nivelit arsimor që kërkon pozicionin e punës (diploma apo dokument tjetër i njohur ligjërisht).

Diplomat e përfunduara jashtë vendit duhet të shoqërohen edhe me dokumentin e njohjes nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;

ç) listë e notave, është kriter për punësimin në atë pozicion pune. Në rastin kur arsimimi është kryer jashtë vendit, duhet të depozitohet edhe dokumenti i njohjes së tyre nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;

d) dokument i diplomimit me gradë shkencore apo tituj shkencorë. Në rastin kur gradat apo titujt shkencorë janë përfituar jashtë vendit, duhet të depozitohet edhe dokumenti i njohjes së tyre nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;

dh) çertifikata, kualifikime apo specializime, të lidhura me pozicionin e punës;

e) dëshmi e mbrojtjes së gjuhëve të huaja;

ë) akti i emerimit në pozicionin e punës;

f) akt i dhënies së masës disiplinore;

g) librezë e punës;

gj) raporti i lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor, si dhe konfirmimi për kryerjen e kontrollit mjekësor bazë;

3. Dokumentet duhet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara me noteri.

**Ndikimi/Efekti:** Moszbatimi i një detyrimi ligjor, që mund të shkaktojë administrimin joefektiv të dosjeve të personelit.

	<b>Shkaku:</b> Mungesa përditësimit me aktet nënligjore në fuqi.
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut</b>	I mesëm.
<b>Konkluzioni</b>	Struktura përgjegjëse e dppi-së, nuk i është përmbajtur rregullave të hollësishme të procedurave dhe të administrimit të dosjeve të personelit e të regjistrimit të tyre në regjistrin qendror të personelit, nga auditimi u vërejtën disa mangësi të dokumentacionit, dosjet e personelit janë jo në përputhje, me të gjitha kërkesat e e legjislacionit në fuqi (dosjet e punonjësve me kontratë përkohshme). Mbi këtë bazë të bëhet rifreskimi i dokumentacionit dhe inventarizimi i saktë me përfshirjen e dokumenteve të tjera.
<b>Rekomandimi</b>	Drejtoria e financës dhe shërbimeve, personi përgjegjës për personelin të marrin masa dhe të përditësojnë dosjet e personelit në përputhje me të gjitha kërkesat e akteve në fuqi.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	<i>Të përditësohen dosjet ekzistuese të personelit, deri në Gusht 2026</i>
<b>Statusi i rekomandimit</b>	<i>Nuk ndryshon rekomandimi, niveli i riskut, statusi, etj</i>

3- Nga auditimi i regjistrimit të akteve të dosjeve (emërime, urdhra, largime, etj) në regjistrin themeltar të personelit (libri themeltar), u konstatua se ato janë regjistruar nga punonjësi i ngarkuar për personelin, *por mungon regjistri qendror i personelit i protokolluar në protokollin e institucionit*, për numrin rendor dhe total të faqeve që ka regjistri themeltar i punonjësve.

Gjatë verifikimit të dosjeve të përzgjedhura, rezulton se kandidatët e interesuar për pjesëmarrje në konkurse të vendeve vakante kanë dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në Sekretarinë e DPPI, pa bërë njoftim në faqen zyrtare të institucionit dhe në buletinin e njoftimeve, ky dokumentacion ndodhet në dosjet personale të punonjësve, por nuk është protokolluar dhe dokumentuar në arkivën e institucionit.

**Titulli i gjetjes:** Mungesa e protokollimit të Regjistrimit themeltar të personelit; Mungesa e dokumentimit në protokoll të dosjes së kandidateve të interesuar për vendet vakante.

<b>Gjetje Nr. 3</b>	
<b>Subjekti i audituar</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Intelektuale
<b>Subjektet e interesuara nga gjetja</b>	Drejtori i Përgjithshëm Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse Specialisti i ngarkuar me personelin Sektori i Shërbimeve Punonjësi i ngarkuar me mbajtjen e protokollit
<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	-Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në RSH; -VKM-së nr. 833, datë 28.10.2020 “Për Rregullat e Hollësishme për Përmbajtjen, Procedurën dhe Administrimin e Dosjeve të Personelit të regjistrimit Qendror të Personelit”; -Rregullore e Brendshme e institucionit.

<p><b>Përshkrimi i gjetjes</b></p>	<p><b>Situata:</b> - Nga auditimi i regjistrimit akteve të dosjeve (emërime, urdhra, largime, etj) në regjistrin themeltar të personelit (libri themeltar), u konstatua ato janë regjistruar nga punonjësi i ngarkuar për personelin, por regjistri qendror i personelit, nuk është i protokolluar në protokollin e institucionit, për numrin rendor dhe total të faqeve që ka regjistri themeltar i punonjësve. Protokollimi sipas numrit rendor dhe total të faqeve të regjistrit, jep siguri dhe nuk lejon ndërhyrje në regjistër, ndryshime apo falsifikime të akteve të prodhuara të regjistruara për punonjësit në vite. Regjistrimet në platformën e bashkëpunimit të RQP-së nën adminstimin e DAP-it, funksiononte për raportimin e zhvillimin/menaxhimin e proceseve të burimeve njerëzore, i cili ndiqet nga punonjësi i personelit të institucionit.</p> <p>- Gjithashtu nga auditimi i dosjeve të përzgjedhura rezulton se, dosjet me dokumente të kandidatëve të interesuar për pjesëmarrje në konkurse (nuk ka procedura konkurimi), sipas vendeve vakante, nuk janë në arkivë të dokumentuar me protokoll. Ndërkohë që në njoftimet e shpallura në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni, duhet të citohet: “Gjithë ata kandidatë të interesuar për pjesëmarrje, për këtë vend vakant duhet të dorëzojnë pranë zyrës së protokollit të Institucionit dokumentet e tyre”.</p> <p>Për sa më sipër, për periudhën e audituar mban përgjegjësi ish Drejtori i financës dhe shërbimeve, i cili nuk ka bërë ndarjen e detyrave sektoriale, duke ngarkuar me urdhër punonjësin të ndjekin detyrat e burimeve njerëzore dhe arkivore.</p> <p><b>Kriteri:</b> Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në RSH, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, konkretisht:</p> <p><u>Neni 3-</u> Pranë çdo subjekti shtetëror e joshtetëror funksionon sekretaria dhe arkivi apo sekretari-arkivi, pjesë strukturore që përgjigjet për administrimin e dokumenteve të krijuara, apo të ardhura në adresë të tij.</p> <p><u>Neni 8-</u> Në sekretari kryhen veprimet për pranimin, evidencimin, shpërndarjen dhe nisjen e korrespondencës. Në sekretari kontrollohet zbatimi i kërkesave që duhet të përmbushë dokumenti; hapen dosjet sipas pasqyrës emërtuese të çeljes së tyre dhe vendosen e sistemohen në to, në mënyrë të vazhdueshme, dokumentet që krijohen e vijnë gjatë vitit; sigurohet dorëzimi i plotë dhe në kohë i dokumenteve që krijohen apo hyjnë në subjektin shtetëror apo joshtetëror gjatë vitit.</p> <p>Në nenin 44 “Specialisti i burimeve njerëzore” dhe neni 47 “Specialisti i Arkiv/Protokoll” germa c), d) e), të Rregullores së Brendshme të dpqi-së, përcaktohet delegimi i veprimtariarisë së tyre.</p>
------------------------------------	--

	<p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Përveç regjistrimit të akteve, të dosjeve (emërime, urdhra, largime, etj) në regjistrin themeltar të personelit (libri themeltar), rezultoi edhe mungesa e protokollimit, pra respektimit të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor, mungesa e këtij dokumentimi e bën të pamundur verifikimin e afatit të dorëzimit të të dokumentave. Pra mungesa e protokollimit të dokumentacionit të kandidatëve të interesuar, ka ndikim edhe në pamundësinë e vlerësimit të transparencës së çdo procedure të ndjekur, sepse nuk jep siguri që të gjithë kandidatët i kanë dorëzuar dokumentet brenda afatit të përcaktuar në njoftimin e publikuar (njoftime nuk ka).</p> <p><b>Shkaku:</b> Mungesa e vullnetit për respektimin e rregullave të konkurimit për vendet e punës dhe për administrimin e dokumenteve në protokoll si dhe respektimin e afateve të dorëzimit, sipas njoftimeve përkatëse.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut</b>	I mesëm
<b>Konkluzioni</b>	<p>Nga auditimi i regjistrimit aktev të dosjeve (emërime, urdhra, largime, etj) në regjistrin themeltar të personelit (libri themeltar), u konstatua ato janë regjistruar nga punonjësi i ngarkuar për personelin, por regjistri qendror i personelit, nuk është i protokolluar në protokollin e institucionit, për numrin rendor dhe total të faqeve që ka regjistri themeltar i punonjësve. Protokollimi sipas numrit rendor dhe total të faqeve të regjistrit, jep siguri dhe nuk lejon ndërhyrje në regjistër, ndryshime apo falsifikime të akteve të prodhuara të regjistruara për punonjësit në vite. Regjistrimet në platformën e bashkëpunimit të RQP-së nën adminstimin e DAP-it, funksiononte për raportimin e zhvillimin/menaxhimin e proceseve të burimeve njerëzore, i cili ndiqet nga punonjësi i personelit të institucionit.</p> <p>Dokumentacioni i dorëzuar nga kandidatët e interesuar për pozicionet vakante nuk është protokolluar nga punonjësi i ngarkuar me mbajtjen e protokollit në këtë institucion, <i>për asrye se dokumentat kanë kaluar menjëherë tek personeli</i>. Në këtë mënyrë jo vetëm që nuk respektohen normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në RSH, por nuk mund të verifikohet edhe përmbushja e afatit të dorëzimit të dokumentacionit, sipas përcaktimeve përkatëse. Në këtë mënyrë nga ana institucionale nuk jepet siguri që të gjithë kandidatet i kanë dorëzuar dokumentet dhe janë marrë në punë pa konkurim nga strukturat përgjegjëse, duke shmangur konkurrencën dhe transparencën.</p> <p>Në rekrutimin e punonjësve me kontratë të përkohshme (G.V; A.B; F.L; D.M; F.XH; E.R; N.N; R.G; M.T, etj), janë marrë pa procedurë konkurimi, ku duhej bërë njoftimi në institucion dhe në buletin e</p>

	njoftimeve për pozicione pune, për të shprehur interesë dhe kandidatë të tjerë të interesuar për pjesëmarrje në rekrutim, për një vend vakant duhet të dorëzojnë pranë zyrës së protokollit të Institucionit dokumentat e kërkuara.
<b>Rekomandimi</b>	-Strukturat përgjegjëse të marrin masa për hapjen e regjistri themeltar i punonjësve, i protokolluar dhe me numër rendor dhe total të faqeve, i cili jep siguri dhe nuk lejon ndërhyrje në regjistër, ndryshime apo falsifikime të akteve të prodhuara të regjistruara për punonjësit në vite. -Dorëzimi i dokumentacionit të kandidatëve të interesuar për vendet vakante të shpallura nga institucioni, të administrohet edhe nga zyra e protokollit në çdo rast nëpërmjet dokumentimit me numrin përkatës të protokollit.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	<i>Në vijim brenda vitit 2026</i>
<b>Statusi i rekomandimit</b>	<i>Pranuar rekomandimi dhe risku</i>

***Këshillojmë në vijim nëpunësin e ngarkuar për personelin të përmirësojë:***

1. Plotësimin e dokumenteve sipas rastit të munguar në dosjet personale të punonjësve.
2. Rishikimin dhe përmirësimin e platformave elektronike për menaxhimin e burimeve njerëzore menjëherë sapo të bëhen aktive nga DAP.
3. Rishikimin e procedurave të ndarjes së detyrave dhe përgjegjësive sipas drejtorive e sektorëve për të siguruar një administrim më efikas.
4. Trajnimin e stafit për mbajtjen e dokumentacionit në përputhje me standardet e kërkuara ligjore.
5. Struktura organike duhet të jetë e gatshme për t'u përshtatur me ndryshimet që ndodhin në institucion, si ristrukturime, krijimi i pozicioneve të reja, ndryshimi i funksioneve të caktuara ose emërimet e reja. Përditësimi i strukturës dhe organikës siguron që ndryshimet e tilla të pasqyrohen në dokumentacionin përkatës dhe të merren masa për plotësimin e vendeve vakante (sidomos pozicionet drejtuese), si dhe të jenë në përputhje me politikën dhe qëllimet e institucionit.

Konkluzioni në përfundim të auditimit, Drejtoria e Financës dhe shërbimeve e cila mbulon burimet njerëzore të marrë masa për zbatimin e këshillimeve të mësipërme dhe të sigurojë përmirësimin e platformave elektronike, ndarje të detyrave dhe përgjegjësive të drejtorive dhe sektorëve, përmirësimin e vazhdueshëm të procedurave të mbajtjes së dokumenteve dosjeve të punonjësve dhe regjistrave të trajtuara më lartë, si dhe trajnimin e stafit, si dhe të merren masa për plotësimin e vendeve vakante.

*-Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve (pagësa bruto dhe neto në përputhje me emërtesën në strukturë të muajit tetor 2024.*

Nga auditimi rezultoi se paga bruto e punonjësve me arsim të lartë është kryer konform emërtesës në strukturë; Sipas VKM nr. 325, datë 31.05.2023 “Për Miratimin e Strukturës së Pagave, Niveleve të Pagave dhe Shtesave të Tjera mbi Pagë të Zëvendësministrit, Funkionarëve të Kabineteve,

Prefektit, Nënprefektit, Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve në disa Institucione të Administratës Publike”, Lidhja 10, Sipas VKM nr. 421, datë 26.06.2024 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 325, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave, “Për Miratimin e Strukturës së Pagave, Niveleve të Pagave dhe Shtesave të Tjera mbi Pagë të Zëvendësministrit, Funkionarëve të Kabineteve, Prefektit, Nënprefektit, Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve në disa Institucione të Administratës Publike”, të ndryshuar, shtohet pika 27.

Nga krahasimi i pagës së grupit për punonjësit me arsim të lartë me nivelin e diplomës që ata zotërojnë, nuk rezultoi mospërputhje mes tyre; punonjësit janë paguar sipas diplomës që zotëronin në dosjen personale. Për periudhën e audituar, u verifikuan librezat e punës së punonjësve, nga të cilat u konstatua se vjetërsia e punës të nëpunësve kishte përputhje me pagesat e kryera në listëpagesat e punonjësve. Pra nga krahasimi i viteve të punës në librezë me pagesat e kryera në listëpagesat e punonjësve, kishte përputhje të pagesës së vjetërsisë në punë.

Gjatë likuidimit të pagave të punonjësve në Dppi nëpërmjet urdhër-transferimeve mujore, u konstatua se në çdo likuidim ka bashkëlidhur edhe listë prezencën e punonjësve të administratës dhe punonjësve mbështetës sipas sektorëve për periudhën e audituar, *por këshillojmë s, e duhet përgatitur listëprezenca përmbledhëse e cila nënshkruhet nga drejtorët e drejtorive dhe miratohet nga Drejtori i përgjithshëm.*

Përsa i përket pagës së punonjësve mbështetës dhe shtesave mbi pagë për punë të vështirë e të dëmshme për shëndetin, rezultoi se janë përllogaritur konform VKM nr. 326, datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa Institucione të Administratës Publike”, dhe Sipas VKM nr. 422, datë 26.06.2024 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 326, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave, “Për Pagat e Punonjësve Mbështetës dhe Punonjësve të tjerë të Specialiteteve të ndryshme në disa Institucione të Administratës Publike”, të Ndryshuar. Nga auditimi i pagave për muajit e përzgjedhur prill-korrik- tetor 2024 dhe Mars-Qershor-tetor 2025 rezultoi se, janë kryer pagesat e punonjësve me urdhër transferta në BKT sipas llogarive personale të nëpunësve. Nga krahasimi i listëpagesës përmbledhëse me listëpagesat e kaluara banka, përputhej shuma totale neto, edhe shtesat për pagesën e shëndetit për punonjësit mbështetës, specialistët e arkivës dhe protokollit, operatorët dhe teknikët e mesëm, paguheshin me aktet ligjore të rishikuara për shtesat e këtyre pozicioneve.

Gjatë përllogaritjes së pagës së punonjësve janë ushtruar kontrole efektive parandaluese e zbuluese në lidhje me administrimin e listëprezencave në punë të punonjësve, të cilat përbëjnë dokument vërtetues për përmbushjen e detyrimeve në lidhje me kohën e punës; përcaktimin e pagës së grupit sipas nivelit të diplomës që zotërojnë punonjësit; përllogaritjet e pagave sipas gjithë shtesave mbi pagë.

4- Nga auditimi i dhënies së shpërblimeve u konstatua se shpërblimi i punonjësve është miratuar me VKMB nr. 4 date 29.05.2025, por gjate kryerjes së pagesës në llogaritjet e kryera në listepagesen e muajit maj 2024 janë përfshirë dhe punonjësit me kontratë të perkoshme në punë me vlerën 182,749 lekë për vitin 2024 dhe 723,278 lekë për vitin 2025.

Grupi i auditimit e konsideron një pagesë të pajustificuar ndaj punonjësve të përkohshëm, kodi i punës (ligji nr. 7961, datë 12.07.1995), neni 140 nuk parashikon detyrimisht të njejtat benefite si kontratat e pacaktuara pasi ato përfundojnë automatikisht në fund të afatit (pa njoftim paraprak). Në kontratat e perkoshme të punës të lidhura me punonjësit si Kontrata me nr.24 date 03.01.2024 me

punonjës in F.Gj, nr.892 datë 06.03.2024 per punonjës in R.G, kontratë nr.34 datë 03.01.2024 per punonjës in E.K, nr.879 datë 27.02.2025 per punonjës in F.L etj me afate të shkruartra kohore, nuk parashikohet në asnjë nen dhënia e një shpërblimi vjetor.Si pasojë është shkaktuar efekt negativ financiar në buxhet 906,027 lekë. Gjithashtu u konstatua se në bazë të urdher-transfertave rezulton se në pagesat e kryera është rerspektuar nr.i punonjësve (37), por ka tejkalim të shumës së aprovuar ne piken 1 te vendimit prej nga 3,430,339 lekë në 3,522,217 leke me një dëm ekonomik në buxhet prej 91,878 lekë.

-Për shpërblimin e punonjësve sipas VKM-së nr 795 datë 28.12.2023 në kuadër të procesit të negociatave me BE , u konstatua se janë paguar 9 (nëntë) punonjës me urdher transfertë të datës 14.01.2024 nga sektori i Financës, pa asnjë dokumentacion justifikues si: shkresë mbi caktimin e punonjësve në grupin e punës në kuadër të procesit të negociatave me BE, urdher i brendshëm i titullarit të institucionit për shpërblimin e tyre bazuar në konfirmimin nga negociatori në detyrë të listës së punonjësve që përfitojnë shpërblimin.

-Me relacionin nr.402 prot date 20.01.2025 dhe nr.2630 date 17.06.2025 i është propozuar KMB nevoja për rekrutimin dhe rinovimin e 2 këshilltarëve të jashtëm me kontratë kohe të pjesshme, ku me vendimin nr.1 date 31.01.2025 të Keshillit Mbikqyrës “Për miratimin e angazhimit të këshilltarëve të jashtëm me afat 6 mujor” si dhe me VKB nr. 5 datë 20.06.2025 janë lidhur kontratat e tyre me kohëzgjatje javore 20 ore në javë.

Bazuar në VKM-në nr. 325 datë 31.05.2023, i ndryshuar, Kreu III, pika 2/ç *Titullarët e institucioneve në varësi të Kryeministrit apo ministrave, për këshilltarët e jashtëm, të emëruar prej tyre, në masën deri në 110 000 (njëqind e dhjetë mijë) lekë në muaj.*

Kontratat e lidhura nr.534 prot, datë 07.02.2025 për D.M dhe nr.535 date 07.02.2025 per D.XH, neni 7 dhe 8 janë hartuar jo në përputhje me VKM nr. 325 e cila sqaron se pagesa e tyre behet nga llogaria ekonomike sipas udhezimit te ministrit pergjegjës për financat (llog.602) dhe si rrjedhim nuk derdhen kontribute të sigurime shoqerore. Gjithashtu këto kontrata kanë të përcaktuar një masë fikse shpërblimi dhe nuk mund të paguhen me pagë orare sipas nenit 4 të cituar.

**Titulli i gjetjes:** Rritje të paargumentuar të shpenzimeve për pagat, nga pagesat për shpërblimin e punonjësve me kontratë dhe të dy këshilltarëve me kontratë të përkohshme të punës.

<b>Gjetje Nr. 4</b>	
<b>Subjekti audituar</b>	i Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale
<b>Subjektet interesuara nga gjetja</b>	e nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit Drejtori i Përgjithshëm Këshilli Mbikqyrës Nëpunësi Autorizues dhe zbatues Përgjegjësi sektorit financës Specialist i Burimeve Njerëzore
<b>Përmbledhja bazës ligjore</b>	e Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në RSH”, i ndryshuar; Ligji nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar; VKM nr. 325, datë 31.05.2023 “Për Miratimin e Strukturës së Pagave, Niveleve të Pagave dhe Shtesave të Tjera mbi Pagë të Zëvendësministrit,

	<p>Funksionarëve të Kabineteve, Prefektit, Nënprefektit, Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve në disa Institucione të Administratës Publike”.</p> <p>Vendim i Këshillit Mbikqyrës nr.4 datë 29.05.2024 dhe nr.12 date 12.11.2025 “Për miratimin e kritereve dhe masat për shpërblimet stimuluese të personelit për efektivitetin e shërbimit të kryer në DPPI”</p> <p>Rregullore e Brendshme e DPPI-së;</p>
<p><b>Përshkrimi i gjetjes</b></p>	<p><b>Situata:</b> Nga auditimi i dhënies së shpërblimeve u konstatua se shpërblimi i punonjësve është miratuar me VKMB nr.4 date 29.05.2025, por gjate kryerjes së pagesës ne llogaritjet e kryera në listepagesen e muajit maj 2024 janë përfshirë dhe punonjësit me kontratë të perkoshme në punë me vlerën 182,749 lekë për vitin 2024 dhe 723,278 lekë për vitin 2025.</p> <p>Grupi i auditimit e konsideron një pagesë të pajustificuar ndaj punonjësve të perkoshëm, kodi i punës (ligji nr. 7961, datë 12.07.1995), neni 140 nuk parashikon detyrimisht të njejtat benefite si kontratat e pacaktuara pasi ato përfundojnë automatikisht në fund të afatit (pa njoftim paraprak). Në kontratat e perkoshme të punës të lidhura me punonjësit si Kontrata me nr.24 date 03.01.2024 me punonjës in F.Gj, nr.892 datë 06.03.2024 per punonjesin R.G, kontratë nr.34 datë 03.01.2024 per punonjës in E.K, nr.879 datë 27.02.2025 per punonjës in F.L etj me afate të shkruetra kohore, nuk parashikohet në asnjë nen dhënia e një shpërblimi vjetor.Si pasojë është shkaktuar efekt negativ financiar në buxhet 906,027 lekë.</p> <p>Gjithashtu u konstatua se në bazë të urdher-transfertave rezulton se në pagesat e kryera është rerspektuar nr.i punonjësve (37), por ka tejkalim të shumë së aprovuar ne piken 1 te vendimit prej nga 3,430,339 lekë në 3,522,217 leke me një dëm ekonomik në buxhet prej 91,878 lekë.</p> <p>-Për shpërblimin e punonjësve sipas VKM-së nr 795 datë 28.12.2023 në kuadër të procesit të negociatave me BE , u konstatua se janë paguar 9 (nëntë) punonjës me urdher transfertë të datës 14.01.2024 nga sektori i Financës, pa asnjë dokumentacion justifikues si: shkresë mbi caktimin e punonjësve në grupin e punës në kuadër të procesit të negociatave me BE, urdher i brendshëm i titullarit të institucionit për shpërblimin e tyre bazuar në konfirmimin nga negociatori në detyrë të listës së punonjësve që përfitojnë shpërblimin.</p> <p>-Me relacionin nr.402 prot date 20.01.2025 dhe nr.2630 date 17.06.2025 i është propozuar KMB nevoja për rekrutimin dhe rinovimin e 2 këshilltarëve të jashtëm me kontratë kohe të pjesshme, ku me vendimin nr.1 date 31.01.2025 të Keshillit Mbikqyrës “Për miratimin e angazhimit të këshilltarëve të jashtëm me afat 6 mujor” si dhe me VKB nr.5 datë 20.06.2025 janë lidhur kontratat e tyre me kohëzgjatje javore 20 ore në javë.</p> <p>Bazuar në VKM-në nr.325 datë 31.05.2023, i ndryshuar, Kreu III, pika 2/ç <i>Titullarët e institucioneve në varësi të Kryeministrit apo ministrave, për këshilltarët e jashtëm, të emëruar prej tyre, në masën deri në 110 000 (njëqind e dhjetë mijë) lekë në muaj.</i></p> <p>Kontratat e lidhura nr. 534 prot, datë 07.02.2025 për D.M dhe nr. 535 date 07.02.2025 per D.XH, neni 7 dhe 8 janë hartuar jo në përputhje me VKM nr.325 e cila sqaron se pagesa e tyre behet nga llogaria ekonomike sipas</p>

	<p>udhezimit te ministrit pergjegjës për financat (llog.602) dhe si rrjedhim nuk derdhen kontribute të sigurime shoqerore.</p> <p>Gjithashtu këto kontrata kanë të përcaktuar një masë fikse shpërblimi dhe nuk mund të paguhen me pagë orare sipas nenit 4 te cituar.</p> <p><b>Kriteri:</b></p> <p>-VKM nr. 325, datë 31.05.2023 “Për Miratimin e Strukturës së Pagave, Niveleve të Pagave dhe Shtesave të Tjera mbi Pagë të Zëvendësministrit, Funkionarëve të Kabineteve, Prefektit, Nënprefektit, Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve në disa Institucione të Administratës Publike”,</p> <p>- Neni 1 dhe neni 2 ,Vendimit të Këshillit Mbikqyrës nr. 4 datë 29.05.2024 dhe nr. 12 datë 12.11.2025 “Për miratimin e kriterëve dhe masat për shpërblimet stimuluese të personelit për efektivitetin e shërbimit të kryer në DPPI”</p> <p>Neni 190, Neni 189/c, pika 88, të Ligji nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar;</p> <p>Neni 140, i Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në RSH”, i ndryshuar;</p> <p>Pika 2, 3 dhe 6, e VKM nr. 795 datë 28.12.2023”Për shpërblimin e punonjësve të qeverisje qendrore.....të procesit të negociatave me BE”</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Mungesa e zbatimit të legjislacionit në fuqi, ka sjellë si pasojë përfshirja e kontratave të përkohshme mund të jetë jashtë kornizës së akteve ligjore nëse kontrata e tyre përfundon para ose nuk plotëson kriteret e performancës. Dëm ekonomik direkt në buxhet prej 91,878 lekë.</p> <p><b>Shkaku:</b> Mungesa e përditësimit me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut</b>	I Lartë
<b>Konkluzioni</b>	<p>Pagesa për punonjësit me kontratë të përkohshme është e pajustificuar dhe e parregullt, pasi nuk plotëson kriteret ligjore të Kodit të Punës dhe nuk mbështetet në kontratat e lidhura, pasi në listepagesen e muajit maj 2024 janë përfshirë dhe punonjësit me kontratë të përkohshme në punë për vitin 2024 dhe për 10 mujorin 2025. Pra rezulton se ka shkelje të vendimit të keshillit Mbikqyrës të pikës 1 të vendimit, duke krijuar pagesë mbi limitin e miratuar.</p> <p>U konstatua, shkelje e kushteve të VKM nr.795/2023 për shpërblimin në procesin e shqyrtimit të Acquis (integrimin në BE), duke krijuar pagesë pa u bazuar në dokumentet e duhura. Gjithashtu kontratat për këshilltarë të jashtëm , nuk kanë respektuar dispozitat e VKM nr. 325/2023, të ndryshuar. Kontratat e lidhura nr. 534 prot, datë 07.02.2025 për D.M dhe nr. 535 date 07.02.2025 per D.XH, neni 7 dhe neni 8 janë hartuar jo në përputhje me VKM nr.325 e cila sqaron se pagesa e tyre behet nga llogaria ekonomike sipas udhezimit te ministrit pergjegjës për financat (llog.602) dhe si rrjedhim nuk derdhen kontribute të sigurime shoqerore.</p>
<b>Rekomandimi</b>	-Të rishikohen listëpagesat e ardhshme për të përjashtuar kategoritë e përkohshme, duke u mbështetur vetëm në kriteret e miratuara në VKMB, dhe të identifikohen shkaqet (llogaritje gabim, shtesa jo të arsyetuara) dhe të

	merren masa për arkëtimin e shumës 91,878 lekë përfituar në kundërshtim me aktet ligjore. -Të kërkohet menjëherë dokumentacioni që mungon për punonjësit dhe nëse nuk plotësohet, të kthehen pagesat e përfituara. Gjithashtu të rishikohet kontrata për këshilltarë të jashtëm sipas VKM-së dhe të argumetohet marrja e tyre në punë, si dhe pagesa mujore të përcaktohet në masën 110,000 lekë/muaj.
<b>Afati i fundit për zbatimin rekomandimit</b>	<i>Observacioni nuk merret parasysh nga grupi i auditimit, nuk janë paraqitur dokumente justifikues.</i>  <i>Të ndiqet rekomandimi i lënë</i>
<b>Statusi rekomandimit</b>	<i>Audituesi nuk ndryshon qëndrimin ndaj gjetjes dhe konkluzionit</i>

Pagesat e punonjësve me transfertat perkatëse në Bankën Kombëtare Tregtare sipas llogarive personale të nëpunësve, nga krahasimi i listëpagesës përmbledhëse me listëpagesat e kaluara banka, përputhej shumta e paguar në lekë. Por u konstatua se shtesat për pagesën e shëndetit për punonjësit mbështetës, specialistët e arkivës dhe protokollit, operatorët dhe teknikët e mesëm dhe nëpunësit e informacionit, paguheshin me aktet ligjore të mëparshme, mbi këtë bazë duhen të rishikohet shtesa e këtyre pozicioneve dhe ngarkohen strukturat përgjegjëse për miratimin e rishikimit të tyre në ministrit perkatëse.

Për periudhën e audituar, u verifikuan librezat e punës së punonjësve ato janë të nënshkruara për fillimin e punës, ndersa për vjetërsinë e punës në listëpagesë, *u lihet detyrë strukturave të shikojnë pagesat e vjetërsisë dhe në vijim të sistemohen nese ka mos rakordim mes vjetërsisë në librezë krahasuar me atë në listëpagesë (bordoro), nga përgjegjësja e financës dhe specialisti i personelit.* Gjatë likuidimit të pagave të punonjësve në Dppi, nëpërmjet urdhër-shpenzimeve mujore, për periudhën e audituar u konstatua se, listë prezenca e punonjësve është përgatitur për çdo muaj e plotësuar për 22 ditë punë për çdo punonjës dhe ishin të bashkëlidhur pagesës të, *por këshillojmë se, duhet të përgatitet një listë prezencë përmbledhëse të punonjësve të plotësuar me të dhënat e listëprezencave analitike të drejtorive, e cila duhet firmosur nga strukturat përgjegjëse dhe miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, pastaj dorëzohet në financë për veprim, që mbahet bashkëlidhur me listë pagesat mujore të punonjësve për të kaluar për veprim të mëtejshëm.*

*Në përfundim të trajtimit të këtij sistemi vlerësojmë punën e bërë në drejtim të respektimit të numrit të punonjësve, përlllogaritjes së pagës bruto të punonjësve të administratës dhe punonjësve mbështetës si dhe administrimin e dosjeve të personelit.* Por, mjedisi i kontrollit duhet të përmirësohet më tej, në mënyrë që procedurat e rekrutimit të gjithë punonjësve të sigurojnë transparencë maksimale, konkurrencë, trajtim të barabartë dhe meritokraci. Mbi këtë bazë menjëherë duhet përcaktuar procedura e konkurrimit për pozicionet dhe marrja në punë nëpërmjet procedurave.

Gjatë përlllogaritjes së pagës së punonjësve janë ushtruar kontrole efektive parandaluese e zbuluese në lidhje me administrimin e listëprezencave në punë të punonjësve, të cilat përbëjnë dokument vërtetues për përmbushjen e detyrimeve në lidhje me kohën e punës; përcaktimin e pagës së grupit sipas nivelit të diplomës që zotërojnë punonjësit; përlllogaritjet e pagave sipas gjithë shtesave mbi pagë; duke vlerësuar punën e mirë në këtë drejtim.

#### IV.5. Sistemi i prokurimeve të fondeve publike

Objektivi i auditimit: Vlerësimi nëse parashikimi, realizimi i prokurimeve dhe raportimi janë në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimet publike.

*Fushat të cilat do të merren në konsideratë gjatë auditimit:*

- Hartimi i regjistrit vjetor të parashikimit të prokurimeve publike dhe raportimi i realizimit të tyre, sipas kërkesave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.
- Argumentimi dhe dokumentimi i mënyrës së përlllogaritjes së fondit limit; hartimi dhe argumentimi i specifikimeve teknike dhe i kriterëve të veçanta të kualifikimit.
- Respektimi i dispozitave ligjore në procedurat e prokurimit të zhvilluara nga autoriteti kontraktor.
- Monitorimi i kontratave të lidhura.

Auditimi i prokurimit të fondeve publike është kryer sipas kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; e Udhëzimit të APP nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

Titullari i autoritetit kontraktor për çdo vit ushtrimor ka ngritur komisionin për blerjet me vlera të vogla në përbërje me tre punonjës/e. Urdhrat e brendshëm për ngritjen e komisionit me blerje të vogla janë përgatitur dhe protokolluar për çdo periudhë ushtrimore vjetore. *këshillojmë se në përcaktimin e personit përgjegjës për blerjet nëpërmjet App-së, të mos përfshihet drejtori i financës dhe shërbimeve, për arsye të konfliktit të interesit me detyrën.*

Gjithashtu titullari i institucionit ka ngritur komisionin për pritjen e mallrave dhe shërbimeve për çdo periudhë ushtrimore vjetore, *këshillojmë se në komisionin e pritjes së mallrave të mos përfshihen punonjës mbështetës si punonjës me kontratë të përkohshme apo sanitare, etj.*

Nga verifikimi për periudhën e audituar rezultoi se, për çdo vit ushtrimor është hartuar regjistri i parashikimit dhe realizimit vjetor të prokurimeve publike dhe janë dërguar dhe raportuar në organet kompetente, në përputhje me afatet të parashikuar në dispozitat ligjore në fuqi.

**1.** Për periudhën e audituar në blerjet e vogla, nga verifikimi i procedurave lidhur me testimin e tregut dhe përcaktimin e fondit limit, u konstatua se janë zhvilluar procedura nën dhe mbi 100,000 lekë, për të cilat mungonte *testimi i tregut në teren, mbajtja e procesverbalit dhe përlllogaritja e saktë e fondit limit.* Komisioni i blerjeve, *nuk ka bërë testim tregu për përcaktimin e fondit limit.* Por gjatë dokumentimit të procedurave kanë përdorur formularin tip nr. 5 për blerjet e realizuara, edhe si procesverbal testim tregu, në fakt të dhënat e çmimeve të tregut duhet të ishin marrë nga testimi në terren dhe jo nga plotësimi formal në zyrë, për të cilat i trajtojmë sipas gjetjes në vijim.

**Titulli i gjetjes:** Për procedurat e blerjeve të vogla me vlera nën dhe mbi 100,000 lekë dhe mbi 1,000,000 lek pa tvsh për periudhën e audituar, nuk ka testim tregu dhe në disa procedura për periudhën e audituar, nuk ka përlllogaritje të saktë të fondit limit.

<b>Gjetje nr. 1</b>	
<b>Subjekti i audituar</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale
<b>Njësit/subjektet e interesuara</b>	Titullari i Autoritetit Kontraktor Drejtori i financës dhe shërbimeve Nëpunësi zbatues Personi përgjegjës për prokurimet Komisioni i blerjeve të vogla
<b>Përmbledhje e bazës ligjore</b>	-Ligji nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; -VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; -Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021 “Për përdorimin e procedurës me vlera të vogla dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<p><b>Situata:</b> Nga auditimi i procedurave të zhvilluara me blerje me vlerë nën dhe mbi 100,000 lekë, të likuiduar nëpërmjet bankës në BKT, u konstatua se komisioni i blerjeve të vogla, <i>nuk ka kryer testim të tregut për të pëcaktuar çmime reale dhe fondin limit të saktë, nëpërmjet dokumentimit në një procesverbale treguesit e çmimeve</i>, pa administruar 3 ofertat e marra në kuadër të këtij procesi. Kanë përdorur procesverbalin për specifikimet teknike dhe të përgjithshme edhe si procesverbal testim tregu, pa i dokumentuar të dhënat e çmimeve në teren, por duke i plotësuar formalisht nga zyra direkt në procesverbalin e specifikimeve, duke kryer edhe përlllogaritjen e fondit limit, kur në fakt fondi limit merret i gatshëm nga procesverbali i testimit në treg për blerjet e vogla.</p> <p>Për sa më sipër për mungesë të mos dokumentimit me një procesverbal të treguesit e çmimeve në treg, mbajnë përgjegjësi komisioni i blerjeve, përgjegjësi i financës dhe personi përgjegjës për prokurimin.</p> <p><b>Kriteri:</b> -Nenit 12 pika 4 dhe 13 pika nr. 1, 2, 3, 4, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;</p> <p>-Në pikën 7, të udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021 “Për përdorimin e procedurës me vlera të vogla dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, përcaktohet: “Në rastet kur në përlllogaritjen e fondit përdoret metoda e testimit të tregut, nuk është e domosdoshme të administrohen ofertat e marra në kuadër të këtij procesi, por vetëm treguesit e çmimeve, të cilat dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël”.</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Shpallja fitues e operatorëve ekonomik, me procedurë të drejtëperdrejtë apo elektronike për blerjet e vogla, ka sjellë mos pasqyrimin e çmimeve reale në treg dhe mos pasqyrimin e saktë të</p>

	<p>fondit limit, gjatë realizimit të procedurave të blerjes për periudhën e audituar.</p> <p><b>Shkaku:</b> Mungesa e përditësimit me aktet nënligjore në fuqi, nga komisioni i blerjeve të vogla.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)</b>	I mesëm
<b>Konkluzioni</b>	Komisioni i blerjeve të vogla në procedurat e realizuara nën dhe mbi 100,000 lekë, nuk ka kryer testim të tregut dhe nuk ka të dokumentuar treguesit e çmimeve në një procesverbal, mbi bazën e të cilit përcaktohet edhe fondit limit i blerjes së mallit apo shërbimit në procedurat e prokurimit, por komisioni çmimet e artikujve i ka hedhur drejtëpërdrejtë në çdo rast blerje në procesverbalin e specifikimeve, duke kryer nga zyra edhe përlllogaritjen e fondit limit, kur në fakt fondit limit merret i gatshëm nga procesverbali i testimit në treg për blerjet e vogla, i cili i bashkëlidhet procesverbalit të specifikimeve teknike dhe të përgjithshme në procedurat e blerjeve.
<b>Rekomandimi</b>	Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nën dhe mbi 100,000 lekë, duhet të kryejë testimin e tregut në teren, dhe të dokumentojë treguesit e çmimeve në një procesverbal, si dhe të bëjë përcaktimin e saktë të fondit limit për blerjet me vlera të vogla.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimeve</b>	<i>Observacioni nuk pranohet nga audituesi</i>
<b>Statusi i rekomandimit</b>	<i>Nuk ndryshon statusi dhe risku</i>

2. Gjatë auditimit të blerjeve të vogla dhe nga verifikimi i procedurave lidhur me fazën e hapjes së ofertave nga kvo -ja u konstatua se në disa procedura personi përgjegjës për prokurimin nuk ka qenë i pranishëm, për të kryer funksione të karakterit ndihmës. Komisioni i vlerësimit të ofertave për të gjitha blerjet e vogla, *nuk ka mbajtur "Raportin Përmbledhës" siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore për prokurimet, që do trajtohen në gjetjen vijuese.*

**Titulli i gjetjes:** Mungesa e mbajtjes të raportit përmbledhës në procedurat e blerjeve të vogla dhe miratimi nga titullari i autoritetit kontraktor.

<b>Gjetje nr. 2</b>	
<b>Subjekti i audituar</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale
<b>Njësit/subjektet e interesuara</b>	Titullari i Autoritetit Kontraktor Drejtori i financës dhe shërbimeve

	Nëpunësi zbatues Personi përgjegjës për prokurimet Komisioni i blerjeve të vogla
<b>Përmbledhje e bazës ligjore</b>	-Ligji nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; -VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; -Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021 “Për përdorimin e procedurës me vlera të vogla dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<p><b>Situata:</b> Gjatë auditimit të blerjeve të vogla dhe nga verifikimi i procedurave lidhur me fazën e hapjes së ofertave nga kvo -ja u konstatua se në disa procedura personi përgjegjës për prokurimin nuk ka qenë i pranishëm, për të kryer funksione të karakterit ndihmës. Komisioni i vlerësimit të ofertave për të gjitha blerjet e vogla, <i>nuk ka mbajtur “Raportin Përmbledhës” siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore për prokurimet, që do trajtohen në gjetjen vijuese.</i></p> <p><b>Kriteri:</b> -Neni 99 “Raporti përmbledhës për procedurën e prokurimit” të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; -Neni 84 “Raporti përmbledhës” pika 1 dhe pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; -Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021 “Për përdorimin e procedurës me vlera të vogla dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Mungesa e ndjekjes së të gjitha fazave të hapjes së ofertave duke qenë i pranishëm personi përgjegjës për regjistrimin e çdo fase të procesit dhe tekstit përfundimtar të tij, si dhe mungesa e mbajtjes së raportit përmbledhës, ka dhënë ndikim negativ në realizimin e procedurave të blerjes për periudhën e audituar.</p> <p><b>Shkaku:</b> Mos rakordimi i veprimeve mes KVO-së, personit përgjegjës dhe titullarit (titullari të mos përfshihet në proces), si dhe mungesa e përditësimit me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)</b>	I mesëm
<b>Konkluzioni</b>	Gjatë auditimit të blerjeve të vogla dhe nga verifikimi i procedurave lidhur me fazën e hapjes së ofertave nga kvo -ja u konstatua se në disa procedura personi përgjegjës për prokurimin nuk ka qenë i pranishëm, për të kryer funksione të karakterit ndihmës. Komisioni i vlerësimit të ofertave për të gjitha blerjet e vogla, <i>nuk ka mbajtur “Raportin Përmbledhës” siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore për prokurimet, që do trajtohen në gjetjen vijuese.</i>

<b>Rekomandimi</b>	Të merren masa për çdo procedurë prokurimi të mbahet raporti përmbledhës dhe miratimi nga titullari i autoritetit kontraktor.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimeve</b>	<i>Në vijim të ndiqet rekomandimi</i>
<b>Statusi i rekomandimit</b>	<i>Nuk ndryshon statusi dhe risku, nga observacioni i dërguar</i>

3. Për periudhën e audituar 2024 dhe 10 mujori 2025, rezultoi se titullari i institucionit ka miratuar me urdhër të brendshëm krijimin e komisionit të pritjes së mallrave dhe marrjes në dorëzim të shërbimeve në institucion. Në të gjitha furnizimet e kryera, procesverbali i pritjes së mallrave dhe shërbimeve është nënshkruar nga komisioni me të dhëna të përgjithshme, por marrja në dorëzim nga komisioni rezultoi jo i plotë dhe formal, ku në të gjitha procesverbalet e marrjes në dorëzim ose kryerjes së shërbimit nuk janë shprehur për plotësimin e specifikimeve teknike dhe të përgjithshme sipas përcaktimeve në ftesën për ofertë dhe në kontratat e nënshkruar nga DPPI.

**Titulli i gjetjes:** Marrja në dorëzim e furnizimeve nga komisioni i pritjes së mallrave dhe shërbimeve, nuk është kryer sipas specifikimeve dhe kushteve teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë dhe në kontratë.

<b>Gjetje Nr. 3</b>	
<b>Subjekti i audituar</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale
<b>Subjektet e interesuara nga gjetja</b>	Titullari i Autoritetit Kontraktor Drejtori i financës dhe shërbimeve Nëpunësi zbatues Personi përgjegjës për prokurimet Komisioni i blerjeve të vogla
<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	Ligji nr.10296, datë 9.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<b>Situata:</b> Për periudhën e audituar 2024- 10 mujori 2025 rezultoi se, për të gjitha procedurat e prokurimit me vlera të vogla, titullari ka miratuar me urdhër të brendshëm krijimin e komisionit të pritjes së mallrave dhe marrjes në dorëzim të shërbimeve në institucion. Procesverbali mbi marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve është nënshkruar nga komisioni në të gjitha furnizimet e kryera. <i>Por marrja në dorëzim të mallrave nuk është kryer sipas objektit dhe specifikimeve teknike të procedurës, komisioni furnizimet nuk i ka</i>

*marrë në mënyrë analitike, për çdo artikull zë për zë dhe sipas specifikimeve dhe kushteve teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë dhe kushteve të kontratës. Marrja në dorëzim e mallrave nga komisioni rezulton jo i plotë dhe formal, procesverbalet e marrjes në dorëzim ose të kryerjes së shërbimit, nuk kanë lidhje me specifikimet dhe kushtet teknike të kontratës për çdo procedurë prokurimi të realizuar, si:*

- Përfundimi i procedurës është bërë në datë ..., dhe sipas faturës së operatorit ekonomik nr..., datë.....
- Vlera e shërbimit analitik sipas zërave është x... lekë;
- Ky procesverbal mbahet në tre kopje, etj.

Të dhënat e evidentuara nga komisioni janë të përshkruar në dokumentacionin e dorëzuar si fitues. Asnjë nga pikat në procesverbale, nuk ka lidhje me plotësimin e kushteve teknike në ftesën për ofertë dhe në kontratë, pra marrja në dorëzim është jo e plotë dhe formal. Në zbatim të akteve ligjore, nënligjore dhe Urdhërit të brendshëm, detyra e komisionit të pritjes së mallrave, ka qëllim marrjen e furnizimeve nga subjekti fitues për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre si dhe të dokumentacionit shoqërues, gjë për të cilat, komisioni nuk e ka shprehur në procesverbalet e marrjes në dorëzim të mallrave nga OE fitues. Në disa procedura të realizuara ka patur dhe situata të proces verbaleve të pritjes mallit, ku ka mjaftuar vetëm përshkrimi në total njesia copë x sasia = vlerën lekë, nuk ka listë emërore të personave pjesëmarrës të ftuar në aktivitet e prokuruar, në disa procedura nuk i ka analitikisht zerat e artikujve të blerë, por ka mjaftuar vetëm përshkrimi në total njesi, sasi, vlerë, Veprimet më lart, kanë krijuar shpenzime të pa justifikuar, për të cilët ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Autoritetit kontraktor, Nëpunësin zbatues, Përgjegjësi/e i financës dhe Komisioni i Marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve.

**Kriteri:** - Ligji nr.10296, datë 9.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 8, pika 1 dhe pika 8, germa ç); neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”, pika 1 dhe pika 4, germa dh) dhe germa ë); neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”, pika 2, germa e) dhe germa f).

- Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar:

Çështja -Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara:

-Paragrafi nr. 42. “Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë,

	<p><i>cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues”, gjithashtu dhe paragrafet nr. 45 dhe 47, 48, 50, të udhëzimit.</i></p> <p>Çështja -Veprimet që kryejnë strukturat e nëpunësit zbatues:</p> <p>-Paragrafi nr.54.“<i>Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat duhet të kontrollojnë në se fletëhyrja origjinale ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si proces verbal i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, <u>procesverbal i marrjes në dorëzim të mallit, certifikatë origjinale dhe cilësie, fletë analize laboratorike, garanci malli etj</u>”, dhe paragrafet 52 dhe 58, të udhëzimit.</i></p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Mungesa e një aktiviteti kontrolli mjaft të rëndësishëm, i cili konfirmon përmbushjen ligjore të kërkesave, specifikimeve teknike/termave të referencës, sipas përcaktimit në ftesën për ofertë, dhe në zbatimin e kushteve të kontratës.</p> <p><b>Shkaku:</b> Mungesa e veprimit nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues për paisjen e këtij dokumentacioni justifikues të saktë, dhe jo verbal, para likuidimit të kontratës. Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut</b>	I lartë
<b>Konkluzioni</b>	<p>Të gjitha furnizimet nga blerjet e vogla, të zhvilluara gjatë vitit 2024-10-mujori 2025, janë marrë në dorëzim me procesverbal “Për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve”, të nënshkruar nga komisioni në të gjitha furnizimet e kryera, por marrja në dorëzim e mallrave nuk është kryer në mënyrë analitike, për çdo artikull zë për zë dhe sipas specifikimeve dhe kushteve teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë dhe kushtet e kontratës.</p> <p>Marrja në dorëzim rezultoi jo i plotë dhe formal, procesverbalet e marrjes në dorëzim (ose të kryerjes së shërbimit), nuk janë të mbështetur në aktet ligjore, nënligjore dhe urdhërit të brendshëm, sipas kushteve të kontratës në sasi, cilësi, lloji, specifikimet, etj, gjë për të cilat ka munguar në procesverbalet e mbajtura nga komisioni duke u shprehur me një format modeli të njëjtë.</p>
<b>Rekomandimi</b>	-Marrja në dorëzim e mallrave dhe shërbimeve nga operatorët ekonomik fitues, të bëhet sipas përcaktimeve të specifikimeve teknike

	në ftesën për ofertë dhe kushteve të kontratës, nga komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave. -Nëpunësi zbatues, përgjegjësi i financës dhe komisioni i pritjes së mallit, duhet të përditësohen me përcaktimet e akteve ligjore/nënligjore në fuqi; veçanërisht me aktet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollin, si dhe në fushën e menaxhimit të aktiveve në njësitë e sektorit publik.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	<i>Observacioni nuk pranohet, në vijim të ndiqet rekomandimi</i>
<b>Statusi i rekomandimit</b>	<i>Nuk ndryshon statusi dhe risku</i>

4. Nga auditimi i procedurave të prokurimeve të vogla për periudhën e audituar, rezultoi se në të gjitha procedurat e realizuara me blerje të vogla, dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti kontraktor në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë respektive, nuk i është dorëzuar me proces verbal “Dorëzim dokumete” të komisionit me operator ekonomik fitues, në Zyrën e Protokollit të DPPI.

**Titulli i gjetjes:** Mungesa e dorëzimit me proces verbal të dokumentacionit të kërkuar në Zyrën e Protokollit.

<b>Gjetje Nr. 4</b>	
<b>Subjekti i audituar</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale
<b>Subjektet e interesuara nga gjetja</b>	Titullari i Autoritetit Kontraktor Drejtori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse Nëpunësi zbatues Njësia e Prokurimeve Personi përgjegjës për prokurimin Komisioni i blerjeve të vogla
<b>Përmbledhja bazës ligjore</b>	Ligji nr. 161, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar. VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<b>Situata:</b> Nga auditimi i procedurave të realizuara me prokurimeve elektronike për blerje të vogla për periudhën e audituar, rezultoi se në procedurat e realizuara, dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti kontraktor në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë respektive, janë dorëzuar nga operatori ekonomik fitues, në Zyrën e

	<p>Protokollit të Dppi, pa mbajtur procesverbal mbi dorëzimin e dokumenave nga OE me përfaqësues të komisionit të blerjeve.</p> <p><b>Kriteri:</b> Pika nr. 17 e Udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Mungesa e dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor me proces verbal, nuk jep siguri se operatori ekonomik i dorëzon gjithë dokumentet sipas afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë.</p> <p><b>Shkaku:</b> Mungesa e përditësimit të Komisionit të Blerjeve të Vogla me bazën ligjore në fuqi për prokurimin, si dhe mungesën e krijimit të një praktike më të mirë në drejtim të procedurave të blerjeve me vlera të vogla.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut</b>	I mesëm
<b>Konkluzioni</b>	<p>Nga auditimi i procedurave të prokurimeve të vogla rezulton se dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti kontraktor në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë respektive, nuk është dorëzuar me procesverbal nga operatori ekonomik fitues në Zyrën e Protokollit të DPPI, ato janë dorëzuar pa procesverbal mbi dorëzimin e dokumenave nga OE.</p> <p>Komisioni i blerjeve të vogla nuk është përditësuar me përcaktimet në udhëzimin për blerjet me vlera të vogla, të ndryshuar, për të krijuar një praktike më të mirë në drejtim të këtyre procedurave.</p> <p>Mungesa e protokollimit të këtyre dokumenteve me procesverbal, nuk jep siguri se operatori ekonomik i shpallur fitues i ka dorëzuar gjithë dokumentet e kërkuara sipas përcaktimit në Ftesën për Ofertë.</p>
<b>Rekomandimi</b>	Të dorëzohet nga çdo operator ekonomik në zyrën e protokollit dokumentacioni i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor me procesverbal, në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	<i>Menjëherë</i>
<b>Statusi i rekomandimit</b>	<i>Nuk ka observacion nga strukturat</i>

5. Në Njesinë e Prokurimit ndodhen dosjet e prokuruar të pasistemuara, ndersa në arkivën e institucionit nuk ka praktika të administruara në dosje të veçantë të inventarizuar, të çdo prokurimi

me vlerë të vogël nën dhe mbi 100,000 e deri në 1,000,000 lekë pa tvsh, të zhvilluar nga autoriteti kontraktor gjatë periudhës së audituar 2024- 10 maji 2025.

**Titulli i gjetjes:** Mungesa e administrimit të dokumentacionit të dosjeve të prokurimit në arkivën e institucionit.

<b>Gjetje Nr. 5</b>	
<b>Subjekti i audituar</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale
<b>Subjektet e interesuara nga gjetja</b>	Titullari i Autoritetit Kontraktor Personi përgjegjës për prokurimin Personi përgjegjës për protokollin
<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	-Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”; -Ligji për Prokurimin Publik.
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<p><b>Situata:</b> Në njësinë e prokurimit administroheshin dosjet e prokurimeve nga personi përgjegjës për prokurimet në App, të cilët nuk ishin dorëzuar në arkivin e institucionit të Dppi-së, nuk ka praktika të administruara në dosje të inventarizuara , të çdo prokurimi me vlerë të vogël mbi 100,000 lekë deri e mbi në 1,000,000 lekë, zhvilluar nga autoriteti kontraktor gjatë periudhës së audituar, por bashkëlidhur urdhër shpenzimeve për likudimin e shërbimeve/mallrave të prokuruar ndodhen dokumentet si: urdhër prokurimi, ftesa për ofertë; njoftim fituesi, procesverbal dorëzimi, , fatura të fiskalizuar, fletë hyrje, etj. Madje jo gjithë dokumentet e përgatitura gjatë procedurave të prokurimit janë protokolluar, p.sh ftesa për ofertë e përgatitur nga njesia e prokurimit, në asnjë rast nuk është me nr. protokollit dhe datën e saj.</p> <p><b>Kriteri:</b> -Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”; -Ligji për Prokurimin Publik.</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Moszbatim i rregullave dhe normave tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në RSH ka sjellë mungesën e arkivimit të çdo procedure në dosje të veçantë. Gjatë punës në terren për periudhën e audituar janar-dhjetor 2024 dhe janar-tetor 2025, janë vënë në dispozicion dokumentet justifikuese të procedurave të prokurimeve me vlera të vogla nga strukturat përgjegjëse.</p> <p><b>Shkaku:</b> Mungesa e praktikave më të mira; shoqëruar me mungesën e trajnimit të anëtarëve të Komisionit të Blerjeve të Vogla dhe punonjësit të ngarkuar me detyrën e personit përgjegjës për blerjet dhe protokoll-arkivit.</p>

<b>Vlerësimi i nivelit të riskut</b>	I Mesëm
<b>Konkluzioni</b>	Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, zhvilluar gjatë periudhës 2024- 10/M/2025, janë administruar në dosje të veçantë nga njesia e prokurimit, por pa i arkivuar, sipas përcaktimeve në normat tekniko profesionale të shërbimit arkivor në RSH. Madje jo gjithë dokumentet e përgatitura gjatë procedurave të prokurimit janë protokolluar, siç është ftesa për ofertë e përgatitur nga njesia e prokurimit, në asnjë rast nuk është me nr. protokolli dhe datën e saj.
<b>Rekomandimi</b>	-Të krijohet një praktikë e mirë e protokollimit të gjithë dokumenteve të çdo procedure prokurimi, dorëzimin dhe protokollimin e dokumentave të kërkuara OE-së, si dhe inventarizimi për arkivën i dosjeve të prokurimeve. -Të administrohen në një dosje të veçantë dokumentet e procedurës së prokurimit, dosje të cilat duhet të arkivohen për llogari të çdo viti ushtrimor, si dhe trajnimi i punonjësit të ngarkuar me detyrën e personit përgjegjës dhe sekretari-arkivit.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	<i>Menjëherë dhe në vijim</i>
<b>Statusi i rekomandimit</b>	<i>Nuk ka observacion nga strukturat</i>

Në drejtim të monitorimit të zbatimit të kontratave si dhe procedurave të blerjeve me vlera të vogla të kryera gjatë vitit 2024-2025, u konstatua se bashkëlidhur urdhër shpenzimeve të likuidimit të mallrave/shërbimeve, ndodhen dokumentet justifikuese (urdhër prokurimi, faturë elektronike, fletë hyrje, etj), duke përfshirë edhe proces-verbalet e marrjes në dorëzim të mallit/shërbimit, *por mungon gjurma e auditit në të gjitha dosjet e prokurimeve.*

*Në përfundim të këtij sistemi, në opinionin e audituesve të brendshëm mungesa e përditësimit të njohurive e mungesën e trajnimeve të punonjësve të Komisionit me Vlera të Vogla ka çuar në kryerjen e procedurave jo në përputhje të plotë me përcaktimet në kriter. Pra aktivitetet e kontrollit të gjurmës faktike të auditimit të ndjekur për zhvillimin e prokurimeve me vlera të vogla, nuk kanë qenë plotësisht efektive, kryesisht në përlllogaritjen e fondit limit; deklarimin e konfliktit të interesit në momentin e emërimit dhe hapjes së ofertave; në çdo rast blerje/shërbimi dokumentimin e përmbushjes së kritereve sipas dokumenteve provuese ligjore dhe administrimin e çdo procedure në dosje të veçantë.*

Megjithatë vlerësojmë përpjekjet e punonjësve për kryerjen e veprimeve në përputhje me bazën ligjore të prokurimeve, ku nga ana e AK në çdo rast të blerjeve të vogla Titullari ka urdhëruar ngritjen e komisionit të blerjeve dhe komisionit të pritjes së mallrave dhe shërbimeve me urdhër të brendshëm; Lidhur me procedurat e prokurimit, në vijueshmëri, meqenëse komisioni i blerjeve ka

ndryshime në përbërje, kanë nevojë të përditësohen me përcaktimet e bazës ligjore të prokurimeve publike.

-Auditimi i prokurimit të fondeve publike në DPPI, me procedurë prokurimi mbi 1,000,000 lek pa Tvsh, është kryer sipas ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, etj.

U shqyrtua dokumentacioni teknik dhe ligjor dhe verifikimi për procedurat e prokurimit, të kryera nga Autoriteti Kontraktor DPPI, ku audituesi është mbështetur në metodën e gjurmimit të dokumentacionit, në hartimin dokumentacionit teknik dhe ligjor dhe llogaritjen e fondit limit, si dhe procedurat e shpalljes së prokurimit; hartimi i kërkesave për kualifikim, miratimi i dokumentave standarte të tenderit; paraqitja dhe shqyrtimi i ofertave; vlerësimi i ofertave dhe klasifikimi i ofertuesve, verifikimi në sistemin prokurimit elektronik (SPE); menaxhimi i procesit të ankimit, pjesëmarrësit në proces; njoftimi, hartimi dhe nënshkrimi i kontratës me operatorin fitues dhe zbatimi i saj, si dhe çdo paqartësi është diskutuar me personat përgjegjës për procesin e prokurimit të audituar.

### **Mbi auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare të procedurave mbi 1,000,000 lekë.**

6. Procedurë e hapur e thjeshtuar me objekt: *“Projekt mbi studimin, identifikimin dhe nxitja e regjistrimit të treguesve gjeografik”*.

Përshkrimi i procedurës: Nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) është realizuar procedurë me tender të hapur të thjeshtuar me mjete elektronike me fond limit 4,100,000 (Katër milionë e Njëqindë mijë) lekë pa tvsh, dhe me vlerë kontrate prej 4,920,000 (Katër milionë nëntëqindë e njëzetë mijë) lekë me tvsh. Autoriteti kontraktor ka ngritur grupet e punës dhe komisionet përkatëse, si dhe lidhur Kontratë shërbimi nr. 2628/9 prot., datë 19.08.2025, me subjektin të shpallur fitues OE “Optima Communication” shpk me NIPT- K71903025A Tiranë.

Përmbledhja e procedurës në tabelë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: <i>“Projekt mbi studimin, identifikimin dhe nxitja e regjistrimit të treguesve gjeografik”</i>		
Urdhër Prokurimi : Nr. 2628/2 prot., (79) datë 02.07.2025		
2. Lloji i procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me një fazë. REF -53181-07-02-2025	2. Njësia e Prokurimit: urdhër nr. 2628 prot., (68) datë 17.06.2025 i përbërë (P.Mezini -Kryetar, A.Silaj dhe F.Xhafa -Anëtar komisioni).	3. Komisioni për Hartimin e Specifikimeve Teknike: urdhër nr. 2627 prot. (67)., datë 17.06.2025 ka ngritur grupin e punës (I.Dervishi, A.Cupi, M.Cico Anëtar komisioni)

4. Fondi limit (pa TVSH): 4,100,000 lek, pa TVSH.	5. Burimi i Financimit (Me vet financim): Buxheti i DPPI Tiranë (nga të ardhurat).	6. Data e hapjes së tenderit: 14.07.2025 ora 13:00
7. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesmarrës: OE "Optima Communication" sh.p.k Tiranë; OE "Primes Albania" shpk Tiranë. b) Kualifikuar: OE "Optima Communication" shpk.	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër nr. 2806 prot., (72) datë 26.06.2025, (E.Shiroka -kryetar, M.Memuri dhe S.Dhimarko, Anëtar komisioni).	9. Oferta fituese: 3,520,000 lekë pa tvsh; 4,224.000 lekë me tvsh.
10. Data e lidhjes së kontratës: Kontratë furniz nr. 2628/9 prot., datë 19.08.2025	11. Diferenca gjendje me fondin limit (pa TVSH) : 580,000 lekë.	12. Ankimime S'ka
13. Struktura për ndjekje kontrate: Adminisrtator kontrate E. Shiroka	14. Raporte monitorimi janë tetë të tilla; faturë elektronike nr. 99, datë 17.10.2025.	15. Afati i kontratës : 2 (dy) muaj nga hyrja në fuqi e kontratës.

Nisur nga të dhënat e nxjerra nga audituesi në tabelën përkatëse rezulton se, Titullari i AK të DPPI-së me urdhër nr. 2627 prot., (67) datë 17.06.2025 ka ngritur grupin e punës "Për Ngritjen e Komisionit për Përlllogaritjen e Fondit Limit dhe Hartimin e Specifikimeve Teknike/Termave të Referencës" të procedurës, grupi i punës sipas ftesës për ofertë nr. 26227/1, datë 18.06.2025, derguar tre OE-ve me qëllim argumentimin e fondit limit të nevojshëm për fillimin e procedurës, u ka kërkuar ofertat e tyre deri më datë 20.06.2025. Tre OE kanë paraqitur ofertat më datë 19.06.2025 (bashkëlidhur) dhe me Proces-Vërbal nr. 2627/2 prot, datë 19.06.2025 "Për Përlllogaritjen e Fondit Limit dhe Hartimin e Specifikimeve Teknike/ kanë përcaktuar : I-Specifikimet teknike ; II-Përlllogaritjen e fondit limit vlere 4,100,000 lekë pa tvsh; III- Përmbledhje të gjithë takimeve me foto dhe video. Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe për përlllogaritjen e fondit limit dhe njësia e prokurimit përcaktuan specifikimet teknike dhe të përgjithshme në dokumentet standarde të tenderit ( DST). Ky fond limit është përlllogaritur duke ftuar me ftesë 3 OE, nga të cilat janë përgjigjur 3 OE me ofertën ekonomike dhe marrë në konsideratë mesataren e ofertave të poseduar nga komisioni.

-Nuk u gjend shkresë "Relacion Për Vlerë Kontrate", nga grupi punës (I.D, A.C, M.C) për t,ia paraqitur drejtorit të përgjithshëm të DPPI (M.S) për vlerën e fondit limit të kontratës të bazuar në studimin e tregut (mesatarja ofertave e marrë nga tre OE), i cili duhet të miratonte vlerën 4.100,000 lekë pa Tvsh "Miratim i vlerës së kontratës", tek Titullari për procedurën me objekt "*Projekt mbi studimin, identifikimin dhe nxitja e regjistrimit të treguesve gjeografik*", e bazuar në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Vlora e fondit të përcaktuar është vënë në dispozicion nga të Ardhurat e DPPI-së, e cila është parashikuar në regjistrin e parashikimit të prokurimeve për 2025.

-Dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti fitues i procedurës oferta ekonomike nuk është dorëzuar në zarf me vete por se bashku në një zarf me dokumentat e tenderit, duhej brenda një zarfi të madh duhen futur dy zarfa, njëri me ofertën ekonomike dhe tjetri me dokumentet e tenderit.

-Sipas urdhërave të brendshëm të paraqitur në tabel rezulton se, është ngritur -Njësia e Prokurimit dhe është cituar fondi limit, lloji i procedurës dhe ngarkimi i njësisë prokurimit me “Hartimin e dokumentave të tenderit” të procedurës, komisioni ka nënshkruar deklaratën e konfliktit të interesit; është ngritur -Komisioni Vlerësim Ofertash”, komisioni ka nënshkruar deklaratën e konfliktit të interesit.

-Në datën 03.07.2025 me nr. 2628/3 prot, Njësia e Prokurimit ka përcaktuar kriteret kualifikuese të vendosur në DST për procedurën e prokurimit, me objekt “*Projekt mbi studimin, identifikimin dhe nxitja e regjistrimit të treguesve gjeografik*” me fond limit 4,100,000 lekë pa tvsh. Afati për hapjen e ofertave është data 14.07.2025. Dokumentacioni i plotë është hedhur në sistemin elektronik me përcaktimin e anëtarit të NJP z. A.Silaj person përgjegjës për kryerjen e veprimeve në SPE në sistemin e APP-së.

-Drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së me shkresë nr. 2628/4 prot., datë 03.07.2025 ka bërë Njoftimin e Shkurtuar të Kontratës, ka përcaktuar zhvillimin me procedurë të hapur të thjeshtuar dhe fond limit 4,100,000 lekë pa tvsh dhe numrin e referencës REF-53181-07-02-2025, si dhe kohëzgjatja e kontratës 2 (dy) muaj nga hyrja në fuqi e kontratës dhe hapja e ofertave datë 14.07.2025 ora 13:00.

#### *Publikimi i Formularit të njoftimit të fituesit.*

Njësia e Prokurimit ka publikuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) Formularin e njoftimit të fituesit me nr. 2628/5 prot, datë 08.07.2025. Kanë paraqitur ofertë dy OE të cilat janë pranuar, nuk ka OE të skualifikuar, oferta ekonomike e OE “Optima Communication” shpk me vlerë 3,520,000 lekë pa tvsh dhe OE “Primes Albania” shpk me vlerë 3,615,036 lekë pa tvsh, është shpallur fitues oferta ekonomike e OE “Optima Communication” shpk me vlerë 3,520,000 lekë pa TVSH. Nga verifikimet rezulton që nuk ka ankesa në lidhje me procesin e vlerësimit dhe sipas Raportit Përmbledhës të paraqitur nga KVO, Kontraktori i DPPI-së ka shpallur fitues OE “Optima Communication” dhe ka publikuar në buletin e APP-së.

Më datë 11.08.2025 me anë të shkresës nr. 2628/6 prot., Njësia e Prokurimit ka publikuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) Formularin e njoftimit të fituesit (shtojca 13). Nga kjo procedurë prokurimi fitues është shpallur oferta ekonomike e OE “Optima Communication” shpk me vlerë 3,520,000 lekë pa tvsh dhe vlerë totale të kontratës 4,224,000 lekë me tvsh, si dhe është bërë publikimi i fituesit në Buletin.

#### *Hapja, shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave.*

Komisioni i vlerësimit të ofertave, i ngritur me Urdhër nr. 2806 prot., (72) datë 26.06.2025, ka mbajtur procesverbalat në datën 14 dhe 15.07.2025, nr. 2806/1 dhe nr. 2806/2 prot, për të dokumentuar hapjen e ofertave, duke u shprehur se ofertat ekonomike janë të rregullt dhe dokumentacioni i dorëzuar nga dy OE, është në përputhje me atë të paraqitur në sistemin elektronik të App-së. Në këtë procedurë janë paraqitur dy operator ekonomik (OE) si më poshtë:

- OE “Optima Communication” sh.p.k me ofertë ekonomike 3,520,000 lekë pa TVSH, duke e renditur në vendin e parë.
- OE “Prima Albania” sh.p.k me ofertë ekonomike 3,615,036 lekë pa TVSH, duke e renditur në vendin e dytë.

Komisioni i vlerësimit të ofertave, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit për Kriteret e Përgjithshme për operatorin ekonomik Fitues është shprehur se, dy Operatorët Ekonomik plotësojnë Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe nga vlerësimi i dokumenteve teknike dhe ekonomike rezultoi se të dy OE plotësojnë të gjitha kriteret në DST, të përcaktuara nga DPPI, *por rezultoi se shqyrtimi i dokumentacionit është shtyrë nga data 21.07.2025 të behet më datë 28.07.2025*, duke e arsyetur se një nga punonjësit e KVO-së ka qenë me pushimin vjetor prej 7 ditë të miratuar nga drejtori i përgjithshëm. Mbi këtë bazë më datë 28.07.2025 janë mbajtur dy procesverbale me nr. 2806/4 dhe nr. 2806/5 “Për hapjen dhe shqyrtimin e dokumentave dhe vlerësimin e tyre”, KVO ka nënshkruar kualifikimin e dokumentacionit për të dy OE, duke i vlerësuar se plotësojnë kërkesat e përgjithshme për kualifikim dhe kriteret e veçanta sipas përcaktimeve në dokument e tenderit.

#### *Publikimi i Formularit të njoftimit të fituesit.*

Njësia e Prokurimit ka publikuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) Formularin e njoftimit të fituesit nr. 2628/6 prot, datë 11.08.2025. Në këtë procedurë prokurimi është paraqitur dy OE, oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga fondi limit është kualifikuar dhe shpallur fituese për lidhjen e kontratës: Oferta ekonomike e OE “Optima Communication” shpk me Nipt- K71903025A me vlerë 3,520,000 lekë pa TVSH, është ofertë Fituese, krahasuar me ofertën e OE “Primes Albania” shpk me Nipt- L62122020K me vlerë 3,615,036 lekë pa TVSH, pas njoftimit të fituesit, kontraktori ka pritur afatet e ankimimit.

Nga verifikimet rezulton që nuk ka ankesa në lidhje me procesin e vlerësimit dhe sipas Raportit Përmbledhës nr. 2806/6 prot., datë 04.08.2025, të paraqitur nga KVO, Administratori i DPPI-së ka miratuar me nënshkrim dhe ka shpallur fituesin në buletin nr. 44, datë 18.08.2025. Menjëherë është lidhur kontratë furnizimi nr. 2628/9 prot., datë 29.08.2025 me OE fitues OE “Optima Communication” shpk me Nipt- K71903025A me vlerë 3,520,000 lekë pa TVSH, njoftuar me nr. 2628/8 prot, datë 19.08.2025 “Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar”, bashkëlidhur “Formulari i Sigurimit të Kontratës” nr 2628/7 prot, datë 15.08.2025. Kontrata do të ndiqet për zbatim nga Administrator Kontrate (S.M) drejtori i komanduar pranë drejtorisë së korrdinimit promovimit, trajnimeve dhe analizës, me urdhër nr. 89 prot., datë 15.08.2025, e cila është ngarkuar për ndjekjen, zbatimin e detyrimeve të kontratës së nënshkruar.

#### *Marrje në Dorëzim të Madhrave të Furnizuara dhe Pranimit të Shërbimit.*

Midis OE “Optima ommunication” shpk me Nipt -K71903025A Tiranë dhe DPPI, është lidhur kontratë shërbimi nr. 2628/9 prot., datë 29.08.2025 me Objekt “*Projekt mbi studimin, identifikimin dhe nxitja e regjistrimit të treguesve gjeografik*”, subjekt i cili ka ndjekur zbatimin e projektit dhe në mbikqyrje nga Autoriteti Kontraktor për realizimin e detyrimeve të kontratës.

Nga auditimi i dokumenteve të punës rezultoi se autoriteti kontraktor ka kryer tetë raporte monitorimi për takimet e realizuara në zbatim të Aneksit 1 “*Përshkrimi i paisjeve të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to*”, nga të cilët u konstatua:

1- Ndryshimi i vendodhjes së zhvillimit të aktivitetit;

2- Raportet e monitorimit në tre raste nuk janë bërë në vëndet e përcaktuara në DS dhe aneksin 1 të kontratës, ndersa raport monitorimi i tetë nuk është brenda afatit dy mujor të kontratës së shërbimit;

3. Materialet promocionale të pa përdorura nuk janë bërë hyrje në magazinën e institucionit;

4. Projekti i realizuar si investim nuk ka produktin final përveç foto dhe video. Komisioni i mbajtjes dhe përgatitjes së raporteve të monitorimit, ka realizuar takimet nga data 4 shtator deri 16 tetor 2025 janë mbajtur 8 (tetë) raporteve të monitorimi, por rezultoi se komisioni i specifikimeve teknike, nuk ka përcaktuar në DST dhe kontratë datat dhe afatet e takimeve që do zhvillohen me qëllim për një monitorim efikas, është përcaktuar vëndi ku do realizohen takimet.

Pas përfundimit të Monitorimeve, nuk është mbajtur në akt të marrjes në dorëzim sipas specifikimeve teknike të dokumentave standart për projektin dhe aneksit 1 të kontratës.

Gjithashtu për materialet promovuese të mbetura, të pushpërndara nuk është mbajtur Proçes Verbal me protokoll mes palëve, për tu kthyer dhe bërë hyrje në magazinën e institucionit duke krijuar dem ekonomik në buxhetin e shtetit në vlerën 146.100 lekë, vlerë e cila në se do të magazinohet dhe do të përdoret nga institucioni për pritje përcjellje dhe evente të tjera.

**Titulli i gjetjes:** Mungesa e zbatimit të kushteve të kontratës, lidhur me organizimin dhe realizimin e takimeve dhe mungesa e dorëzimit të materialeve të pa përdorura në magazinën e institucionit; Mungesa e dhënies të një produkti final për kryerjen e një analize të tregut, për evidentimin e bizneseve/grupeve të prodhuesve potencial, për regjistrimin e shoqatave në treguesit gjeografik.

<b>Gjetje Nr. 6</b>	
<b>Subjekti i audituar</b>	Drejtor i Përgjithshëm i DPPI Tiranë
<b>Subjektet e interesuara nga gjetja</b>	Titullari i Autoritetit Kontraktor Personi përgjegjës për prokurimin Komisioni KVO Komisioni i ndjekjes dhe monitorimit të kontratës Nëpunësi zbatues dhe specialisti i Financës
<b>Përmbledhja bazës ligjore</b>	-Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; -VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; -Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 30 date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. -Kontratë shërbimi nr. 2628/9 prot., datë 29.08.2025 me Objekt“Projekt mbi studimin, identifikimin dhe nxitja e regjistrimit të treguesve gjeografik”.
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<b>Situata:</b> Gjatë auditimit të shërbimit për projektin mbi studimin, identifikimin dhe nxitja e regjistrimit të treguesve gjeografik u konstatua se, komisioni i mbajtjes dhe përgatitjes së raporteve të monitorimit, ka realizuar nga data 4 shtator deri 16 tetor 2025 8 (tetë) raporte monitorimi të shoqërues

me video përmbledhëse dhe në formë elektronike me USB, nga të cilët në shtatë raste ka devijime të takimeve përfundimtare me ato të projektuara me palëve sipas dokumenteve standart dhe aneksit 1 të kontratës së nënshkruar mes Subjektit “Optima Communication” shpk dhe DPPI-së, pa dhënë dakortësinë e ndryshimeve, takimet e realizuara janë si më poshtë:

***Sipas DST dhe Aneksi 1, i kont:***

1. Duhej takimi në Peshkopi,
2. Duhej takimi në Klos,
3. Duhej takimi në Maqellar,
4. Duhej takimi në Zagrad,
5. Duhej takimi në Bulqizë,
6. Duhej takimi në Kastriot,
7. Duhej takimi në Melan,
8. Duhej takimi në Grevë,

***Sipas Raport monitorimit:***

- Realizuar në dt.04.9.2025-Peshkopi,  
 Realizuar në dt.16.9.2025-Suç,  
 Realizuar në dt.16.9.2025-Burrel,  
 Realizuar në dt.23.9.2025-Kastriot,  
 Realizuar në dt.03.10.2025-Peshkopi,  
 Realizuar në dt.10.10.2025-Peshkopi,  
 Realizuar në dt.15.10.2025-Maqellar,  
 Realizuar në dt.16.10.2025-Peshkopi.

Pra siç shihet përgatitjet e takimeve me grupet e interesit, nga subjekti fitues dhe dpri-ja, nuk janë zbatuar dhe realizuar në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuar në DST dhe Aneksin 1 të kontratës. Në takimet e realizuara në kuadër të këtij projekti rezultoi se, zonat e Qarkut të Dibrës kanë shfaqur interes si sipërmarrës, prodhues të ndryshëm të zonave për traditat, natyrën dhe pasuritë autentike për zhvillimin prodhimt, lidhur me treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës, si dhe rendësinë e regjistrimit të subjekteve pranë DPPI-së. U konstatua se raport monitorimi nr. 3493/10 prot, datë 21.10.2025, është mbajtur jashtë afatit 2 mujor të kontratës së shërbimit e lidhur më datë 19.08.2025, në kundërshtim me nenin 22 “Zgjatja e kontratës” dhe pa iu përmbajtur specifikimeve teknike sipas zërave të përcaktuar në aneksin 1 të kontratës. Pra Aktiviteti përfundimtar është kryer më datë 21.10.2025, subjekti pa dorëzuar shërbimin e projektit ka prerë faturën elektronike më datë 17.10.2025 me nr. 99 (dy ditë më përpara), ndersa likujdimi i faturës është kryer me urdher transferimi më datë 24.10.2025. Konstatohet ka mospërputhje me nenin 15 “Dëmet e likujduara” për kryerjen e vonuar të vleres së mbetur 470,400 lekë, duhej të mbahej penaltet për 4 ditë në vlerën 7,526 lekë, si dhe për materialet e mberuara (të pa përdorura) me dokument të nënshkruar mes palëve, ngarkon me përgjegjësi për demin ekonomik të krijuar në vlerën 146.100 lekë, plus penalitetin 7,526 lekë, totali prej 153,626 lekë, do çdëmtohet nga OE “Optima Communication” shpk Tiranë.

Vlen të theksojmë nga i gjithë projekti i realizuar në vlerën 4,244.000 lekë me tvsh, nuk është arritur qëllimi për krijimin, identifikimin, nxitjen dhe regjistrimin për treguesit gjeografik nga zonat e përcaktuara në DST, *projekt i cili nuk ka produktin final, përveç foto dhe video takimesh, etj, pra projekti nuk ia ka aritur qëllimit për të regjistruar produktet me potencial gjeografik,*

	<p><i>për justifikimin e shpenzimeve të kryera, pasi nuk ka informacion të detajuar si:</i></p> <p><i>1- Kryerjen e një analize të tregut për evidentimin e bizneseve/grupeve të prodhuesve potencial për regjistrimin dhe mbrojtjen e objekteve të PI, kryesisht të treguesve gjeografik.</i></p> <p><i>2- Mungesën e një informacioni për dokumentacionin e regjistrimit të shoqatave prodhuese në qarkun e Dibrës.</i></p> <p><u>Per sa më lart</u>, menaxhimi i institucionit të marrë në shqyrtim dhe të analizojë punën e strukturave përgjegjëse, të cilët kanë shfaqur mungesë përkushtimi dhe përgjegjësie në kryerjen e detyrës.</p> <p>Siç shihet observuesi, ka pranuar gjetjen për arsye se nuk ka përputhje dhe personat që kanë marrë pjesë sipas listë prezencave nuk vërtetojnë që pjesëmarrësit janë nga zonat e përcaktuara, në specifikimet e DST- së, aneksi 1 faqe 34, <i>megjithatë në projekt- raport kemi trajtuar 7 raste mos përputhje të takimeve, pranojmë dy raste, dhe lihen 5 raste mospërputhje, por përsëri nuk ndryshon statusi dhe rekomandimi i gjetjes, për arsye se, nuk është realizuar qëllimi kryesor i projektit i trajtuar në këtë gjetje dhe sqaruar në Aneksin nr. 2, nga audituesi.</i></p> <p><b>Kriteri:</b> -Ligji nr.162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar;  -VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar;  -Pika 36 dhe pika 37, e udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 30 date 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar;  -Neni 1 pika 1 dhe 1.2, Neni 4, pika 4.1 dhe 4.2, Neni 8, pika 8.2, Neni 3 pika 3.1 "Afati i realizimit të kontratës", Neni 15 "Dëmet e likujduara", Neni 22 "Zgjatja e kontratës", Aneksi 1, etj, të Kontratës së shërbimit nr. 2628/9 prot., datë 29.08.2025 me Objekt "Projekt mbi studimin, identifikimin dhe nxitja e regjistrimit të treguesve gjeografik".</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Moszbatim i rregullave të përcaktuara në DST dhe kushtet e kontratës nga menaxhimi i institucionit si dhe mungesa e përgjegjësisë në kryerjen e detyrës, ka shkaktuar mungesë të produktit final të projektit.</p> <p><b>Shkaku:</b> Mungesa e praktikave të mira; shoqëruar me mungesën e trajnimit të punonjësve të përfshirë në proceset e prokurimit dhe të monitorimit të kontratës.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut</b>	I Lartë
<b>Konkluzioni</b>	Nga auditimi i projektit mbi studimin, identifikimin dhe nxitja e regjistrimit të treguesve gjeografik u konstatua se, komisioni i mbajtjes dhe përgatitjes së raporteve të monitorimit, ka realizuar nga data 4 shtator deri 16 tetor 2025

	<p>janë mbajtur 8 (tetë) raporteve të monitorimi, nga të cilët në 5 (pesë) raste ka devijime të takimeve përfundimtare me ato të projektuara me palëve sipas dokumenteve standart dhe aneksit 1 të kontratës së nënshkruar mes Subjektit “Optima Communication” shpk dhe DPPI-së, pa dhënë dakortësinë e ndryshimeve, pra nuk janë zbatuar dhe realizuar në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuar në DS dhe Aneksin 1 të kontratës.</p> <p>Gjatë takimeve të realizuara në kuadër të këtij projekti rezultoi se, zonat e prefekturës së Dibrës kanë shfaqur interes si sipërmarrës, prodhues të ndryshëm të zonave për traditat, natyrën dhe pasuritë autentike për zhvillimin prodhimt, lidhur me treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës, si dhe rendësinë e regjistrimit të subjekteve pranë DPPI-së.</p> <p>U konstatua se raport monitorimi nr. 3493/10 prot, datë 21.10.2025, është mbajtur jashtë afatit 2 mujor të kontratës së shërbimit, në kundërshtim me nenin 22 “Zgjatja e kontratës”, ndersa aktiviteti përfundimtar është kryer më datë 21.10.2025, subjekti pa dorëzuar shërbimin e projektit ka prerë faturën elektronike më datë 17.10.2025 me nr. 99 (dy ditë më përpara), likujdimi i faturës është kryer më datë 24.10.2025. Rezultoi mospërputhje me nenin 15 “Dëmet e likujduara” për kryerjen e vonuar të vlerës së mbetur 470,400 lekë, duke krijuar penalitet për 4 ditë, dhe mungesë magazinimi të materialeve të pa përdorura, ngarkon me përgjegjësi strukturat e DPPI-së, si dhe për demin ekonomik të krijuar në total 153,626 lekë me tvsh, do ç’dëmtohet nga OE “Optima Communication” shpk Tiranë.</p> <p>Projekti i realizuar në vlerën 4,244.000 lekë me tvsh, nuk ia ka aritur qëllimit, lidhur me krijimin e identifikimin, nxitjen dhe regjistrimin të treguesve gjeografik në zonat e përcaktuara në DST, <i>pra në opinionin e audituesit rezulton se nuk ka dhënë produktin final dhe nuk ka informacion të detajuar si:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1- <i>Kryerja e një analize të tregut për evidentimin e bizneseve/grupeve të prodhuesve potencial për regjistrimin dhe mbrojtjen e objekteve të PI, kryesisht të treguesve gjeografik.</i></li> <li>2- <i>Mungesa e një informacioni për dokumentacionin e regjistrimit të shoqatave prodhuese në qarkun e Dibrës, etj.</i></li> </ol> <p><u>Mbi këtë bazë</u>, investimi i këtij projekti të realizuar gjatë vitit ushtrimor 2025, nuk është menaxhuar në përputhje me të dhënat e DST dhe me zbatimin e kushteve të kontratës së lidhur midis palëve.</p>
<b>Rekomandimi</b>	<p>- Strukturat përgjegjëse të marrin masa të menjëhershme që në DST dhe në kushtet e kontratës të përcaktohen datat e takimeve, ndersa marrja në dorëzim dhe afatet e monitorimit të kontratave si dhe likujdimi, duhet të jenë në përputhje me dokumentet dhe aktet përkatëse.</p> <p>- Të merren masat nga institucioni për arkëtimin e vlerës 153,626 lekë nga</p>

	OE "Optima Communication" shpk Tiranë, i cili ka shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	<i>Të ndiqet rekomandimi brenda vitit buxhetor, observacioni nuk pranohet nga audituesi, përgjigjia është në Aneksin nr. 2, bashkëlidhur Raportit</i>
<b>Statusi i rekomandimit</b>	<i>Nuk ndryshon gjetja dhe rekomandimi i trajtuar</i>

7. Procedurë e hapur e thjeshtuar me objekt: "Shërbime për panairin "Promovimi i Treguesve Gjeografikë dhe Kulturës Shqiptare në Gjeneve (SIDE EVENT)".

Përshkrimi i procedurës: Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) ka realizuar procedurë me tender në bazë të Nenit 100, të Ligjit Nr.162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar si dhe Nenit 1 të VKM-së Nr.768 datë 15.12.2021 "Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të veçanta, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik, si dhe rregullave të detajuara për prokurimin e tyre", i ndryshuar, me fond limit 13,500,000 (Trembëdhjetë milionë e Pesëqindë mijë) lekë pa tvsh, përcaktuar nga kontraktori. Ndërsa OE fitues ka lidhur kontratë prej 12,516,980 (Dymbëdhjetë milionë pesëqindëgjatëmbëdhjetë mijë nëntëqindëtetëdhjetë) lekë pa tvsh dhe 15,020,276 (Pesëmbëdhjetë milionë njëzetë mijë dyqindëstetëdhjetëgjatë) lekë me tvsh. Autoriteti kontraktor ka ngritur grupet e punës dhe komisionet përkatëse, si dhe ka lidhur Kontratë shërbimi nr. 1592/11 prot., datë 11.06.2025, me OE "Iceberg Communication" shpk me NIPT- K31518077S Tiranë.

Procedura është mbështetur në rekomandimin e Vendimit të KPP-së nr. 433/2025 të datës 02.04.2025, që Autoriteti Kontraktor mund ti referohet zbatimit të VKM-së Nr. 768 datë 15.12.2021 "Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të veçanta, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik, si dhe rregullave të detajuara për prokurimin e tyre", i ndryshuar, pasi i përshtatet objektit të kësaj procedure.

#### Përmbledhja e procedurës në tabelë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Shërbime për panairin "Promovimi i Treguesve Gjeografikë dhe Kulturës Shqiptare në Gjeneve (SIDE EVENT)", me Kod CPV: 79956000-0 (Shërbime për organizim Panairi dhe Ekspozite) të Shtojcës Nr.1 të VKM-së Nr.768 datë 15.12.2021.		
Urdhër Prokurimi : Nr. 2628/2 prot., (79) datë 02.07.2025		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit: "Shërbime Sociale", shërbimi kod CPV: 79956000-0 (Shërbime për organizim Panairi dhe Ekspozite) REF -53181-07-02-2025	2. Njësia e Prokurimit: Urdhër nr. 1592 prot., (49) datë 11.04.2025 i përbërë (P.Mezini - Kryetar, A.Silaj dhe	3. Komisioni për Hartimin e Specifikimeve Teknike: Me urdhër nr. 1591 prot. (48), datë 11.04.2025 ka ngritur grupin e punës (A.Çupi - Kryetar, A.Zahaj-specialist i jashtëm; M.Cico-specialist i jashtëm Anëtarë)

	S.Dhimarko -Anëtar komisioni).	
4. Fondi limit (pa TVSH): 13,500,000 lek, pa TVSH.  Afati i realizimit : 30 ditë duke filluar nga nënshkrimi i kontratës.	5. Burimi i Financimit (Me vet financim)  Buxheti i DPPI Tiranë (nga të ardhurat).	6. Afati përfundimtar për paraqitjen e ofertave nga OE deri me datën 27.05.2025, ora 11.00 sipas Ftesës së Hapur për negociatë me Nr.1592/3 datë 07.05.2025.
7. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesmarrës: OE “Iceberg Communication” shpk Tiranë; b) Kualifikuar: OE “Iceberg Communication” shpk Tiranë;	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër nr. 1903 prot., (55) datë 08.05.2025, (S.Meka - kryetar, Xh.Lulaj dhe F.Xhaja, Anëtar komisioni).	9. Oferta fituese: 12,516,980 lekë pa tvsh; 15,020,276 lekë me tvsh. Raport Përmbledhës i KVO-së nr1903/4 datë 02.06.2025, vlerësim me Pikë 93.68 sipas Kriteve të Vlerësimit.Njoftim Shpallje fituesi në Buletinin Nr.28 datë 02.06.2025 te Njoftimeve Publike pranë APP-së.
10. Data e lidhjes së kontratës:  Kontratë furniz nr. 1592/11 prot., datë 11.06.2025	11. Diferenca gjendje me fondin limit (pa TVSH) : 983,020 lekë.	12. Ankimime  S’ka
13. Urdhër Nr.2437 datë 11.06.2025 për monitorim Kontrate Nr.1592/11 datë 11.06.2025:  Kryetar: E. Shiroka; Anëtar S.Qatipi, N.Nuraj.	14. Raporte monitorimi nr 2437/2 datë 28.07.2025; faturë e fiskalizuar nr. 99, datë 17.10.2025.	15. Afati i kontratës :  30 ditë sipas Nenit11 nga data 16.06.2025 dhe përfundon 16.07.2025.

Nisur nga të dhënat e nxjerra nga audituesi në tabelën përkatëse rezulton se, Titullari i AK të DPPI-së me urdhër nr. 1591 prot. (48), datë 11.04.2025 ka ngritur grupin e punës (A.Çupi -Kryetar, A.Zahaj-specialist i jashtëm; M.Cico- specialist i jashtëm Anëtarë) “Për Ngritjen e Komisionit për Përlllogaritjen e Fondit Limit dhe Hartimin e Specifikimeve Teknike/Termave të Referencës” të procedurës, grupi i punës sipas ftesës për ofertë nr. 1591/2, datë 18.04.2025, dërguar tre OE-ve me qëllim argumentimin e fondit limit të nevojshëm për fillimin e procedurës, u ka kërkuar ofertat e tyre deri më datë 22.04.2025. Tre OE kanë paraqitur ofertat më datë 07.05.2025 (bashkëlidhur) dhe me Proces-Verbal nr. 1591/6 prot, datë 07.05.2025 “Për Përlllogaritjen e Fondit Limit dhe Hartimin e Specifikimeve Teknike/ kanë përcaktuar:

I-Specifikimet teknike ; Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe për përlllogaritjen e fondit limit dhe njësia e prokurimit përcaktuan specifikimet teknike dhe të përgjithshme. Ky fond limit është përlllogaritur duke ftuar me ftesë 3 OE, nga të cilat janë përgjigjur 3 OE, por ofertat e tyre nuk rezultojnë të jenë sjell deri në datën 22.04.2025 dhe kanë ardhur në datën 07.05.2025, por në PV janë bashkëlidhur ofertat ekonomike të paprotokolluara nga Zyra e Protokollit, ndryshe nga sa shkruhet në PV e mbajtur nga grupi i punës dhe konstatohet që në ofertën ekonomike të OE “Iceberg Communication” shpk vlera e ofertës është 13,457,980 lekë dhe në PV është shkruar 13,475,980 lekë, kuptohet që kemi të bëjmë me invers numrash. Kështu që mesatarja e ofertave të poseduar nga

komisioni rezulton në përputhje me Pikë 1/b të Nenit 76 të VKM-së nr.285, ku vlera e fondit limit është 13,500,000 lekë.

-Nuk u gjend shkresë “Relacion përmbledhës”, nga grupi punës (A.Ç, A.Z, M.C) për tia paraqitur drejtorit të përgjithshëm të DPPI (M.S) për vlerën e fondit limit të përlogaritur prej 13,500,000 lekë pa Tvsh për procedurën me objekt “Shërbime për panairin “Promovimi i Treguesve Gjeografikë dhe Kulturës Shqiptare në Gjeneve (SIDE EVENT) ”.

Urdhër Prokurimi Nr. 1592/1 (54), datë 07.05.2025 i titullarit të Autoriteti Kontraktor ka caktuar njësinë e prokurimit për hartimin e dokumenteve të tenderit, procedurën që do të përdoret, fondin limit dhe arsyet e përdorimit të kësaj procedure.

Me shkresën Nr. 1592/4, datë 08.05.2025 “Dërgohet për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike”, Njoftimi “Ftesë e Hapur për negociatë” ka dal në Buletinin Nr.24, në datën 12.05.2025 ku afati përfundimtar për paraqitjen e ofertave nga OE është data **27.05.2025, ora 11.00**, pranë DPPI, Zyra e Protokollit. Vlera e fondit të përcaktuar është vënë në dispozicion nga të Ardhurat e DPPI-së, e cila në regjistrin e parashikimit të prokurimeve për vitin 2025 për shkak të anulimit të procedurës së hapur me vendim Nr. 433/2025 të KPP-së, ka ndryshuar lloji i procedurës me VKM nr.768 datë 15.12.2021 “Shërbime Sociale” me kod CPV 79956000 (Shtojca Nr.1). Dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti fitues i procedurës oferta ekonomike nuk është dorëzuar në zarf me vete por së bashku në një zarf me dokumentat e tenderit.

-Sipas urdhërave të brendshëm të paraqitur në tabel rezulton se, është ngritur -Njësia e Prokurimit dhe është cituar fondi limit, lloji i procedurës dhe ngarkimi i njësisë prokurimit me “Hartimin e dokumentave të tenderit të procedurës”, komisioni ka nënshkruar deklaratën e konfliktit të interesit; Titullari i AK-së ka ë ngritur -Komisionin e Vlerësimit të Ofertave” me Urdhër nr. 1903 (55) prot., datë 08.05.2025 “Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave” në përbërje (S.M;Xh.L;F.Xh), të cilet kanë plotësuar dhe deklaratat e konfliktit të interesit.

-Me PV me nr. 1903/2 datë 27.05.2025 KVO ka ndjekur procedurën për hapjen e ofertave të paraqitura nga OE dhe me PV nr. 1903/3 datë 29.05.2025, kanë kryer shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, ka rezultuar vetëm një ofertë dhe pas vlerësimit me pikëzim në total me 93.68 pikë, KVO ka renditur OE “Iceberg Communication” shpk fitues me ofertë me vlerë 12,516,980 lekë.

-Me shkresën nr. 1903/4 datë 02.06.2025 “Raport përmbledhës i KVO-së”, është njoftuar titullari i AK-së dhe Njësia e Prokurimit ka dërguar për publikim Formularin e Njoftimit të Kontrates së nënshkruar e cila është publikuar në Buletinin nr. 28 date 02.06.2025 të Njoftimeve Publike pranë APP-së, është njoftuar OE fituese duke i kërkuar sigurimin e kontratës brenda 5 ditëve.

Nga verifikimet rezulton që nuk ka ankesa në lidhje me procesin e vlerësimit dhe sipas Raportit përmbledhës nr. 1903/4 datë 02.06.2025, të paraqitur nga KVO, Titullari i AK-së ka miratuar dhe ka shpallur fituesin duke e publikuar në buletin, si dhe me fituesin ka lidhur kontratë nr. 1592/11 prot., datë 11.06.2025 me OE fitues Iceberg Communication shpk me Nipt- K31518077S me vlerë 12,516,980 lekë pa TVSH. Bashkëlidhur “Formulari i Sigurimit të Kontratës” nr 2628/7 prot, datë 15.08.2025. AK ka administruar sigurimin e kontratës ku rezulton 10% e vlerës totale me TVSH në

përputhje me Nenin 36, Pika 1 e VKM-së nr. 285 date 19.05.2025 “Per miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Kontrata do të ndiqet për zbatim me Urdhër Nr. 59 datë 04.09.2025 “Për Monitorimin e Kontratës nr. 1592/11 datë 11.06.2025 nga komisioni i ngritur me përfaqësues : Kryetar E.Shiroka dhe Anëtar grupi S.Qatipi dhe N.Nuraj. Në Pikën 4 të Urdhërit theksohet se grupi i monitorimit do të monitorojë realizimin e kontratës dhe do të **marrë në dorëzim shërbimin objekt i kontratës sipas përcaktimeve në specifikimet teknike.**

*Marrje në Dorëzim të Mallrave të Furnizuara dhe Pranimet të Shërbimit.*

Midis Operatorit Ekonomik “Iceberg Communication” shpk dhe DPPI-së është lidhur kontratë nr.1592/11, datë 11.06.2025 me Objekt: “Shërbime për panairin “Promovimi i Treguesve Gjeografikë dhe Kulturës Shqiptare në Gjenevë (SIDE EVENT)”.

Nga kontrolli i dokumentacionit rezulton se nuk është ngritur Urdhëri për marrjen në dorëzim nga Titullari i AK dhe si rrjedhojë mungon Proçes Verbal për marrjen në dorëzim të shërbimeve që do të realizohen sipas Aneksit 1 të Kontratës së lidhur, proçes i cili i ngarkohej ta kryej Komisioni i Monitorimit të kontratës sipas zërave më poshtë:

1. Implementimi i Interiorit të skenës sipas zërave përkatës (përshkruar në zërat 1 – 7);
2. Promovimi i produkteve bujqësore dhe ushqimore (produkte për degustim) të përshkruara në sasi të përcaktuara në Aneksin 1 (nga 1 – 10) ;
3. Prodhimet sipas treguesve gjeografikë (Gliko, mjaltë, kërpudhë dhe vaj ulliri sipas sasive përkatëse të përcaktuara në Aneksin 1 të Kontratës së lidhur (nga 1 – 4);
4. Përgatitja e recetave për degustim në përputhje me sasi të racioneve të përshkruara sipas Aneksit 1 të Kontratës së lidhur (nga 1 – 7 ) gjithsej 560 racione;
5. Produktet për promovim : 6 modele të ndryshme të xhubletave të vendosura në kornize rreth 600 copë të përshkruara sipas Aneksit 1 të Kontratës së lidhur;
6. Transporti i produkteve ushqimore, kushtet e ruajtjes si dhe transporti i materialeve të Panairit ( në vajtje dhe në kthim);
7. Përgatitja e degustimit;
8. Konsulenti i Panairit;
9. Materialet promovuese të Panairit për marrjen në dorëzim të sasive të tyre sipas specifikimeve të përshkruara në Aneksin 1 të Kontratës së lidhur (nga 1 – 5 ).
10. Fotograf/Videograf dhe IT për Panairin;
11. Prezantimi sipas kulturës dhe traditës (nr instrumentistëve, realizimi i videos dhe permbajtja e videos sipas detajeve dhe minutazhit) , si dhe elementët e tjerë të përshkruar në Aneksin 1 të Kontratës së lidhur ( nga 1 – 6), pra siç edhe është vërejtur nuk ka pasur marrje në dorëzim të këtij shërbimi për shkak se nuk është ngritur dhe ka funksionur komisioni i marrjes në dorëzim për këtë qëllim.

*Proçes verbali i marrjes në dorëzim të mallit duhet të jetë i protokolluar, i rregullt në të gjithë elementët e tij, të mos ketë gabime dhe mospërputhje, të përmbajë datën e hartimit dhe vendin e marrjes në dorëzim, të përshkruaj me saktësi shërbimet dhe treguesit e produkteve sasiore, cilësorë dhe të vlerës, veprimet e kryera për verifikimin e tyre, dokumentacionin shoqërues dhe çdo të dhënë*

të nevojshme në përputhje me Piken 36 të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 30 datë 27.12.2011  
“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Në Raport Monitorimin për Side Event me nr. 2437/2 datë 28.07.2025, grupi i monitorimit ka bërë një panoramë të përgjithshme të aktivitetit dhe nuk ka asnjë Proçes Verbal mbi monitorimin real sipas specifikimeve të Aneksit 1 për shërbimet që do të realizohen.

Pra siç vërehet, nuk ka pasur monitorim të realizimit të Kontratës në përputhje me Aneksin 1 të Kontratës së lidhur të këtij shërbimi dhe nuk ka një Plan për zbatimin e kësaj kontrate, ku të përcaktohej ndjekja e kontratës sipas kushteve të përcaktuara në Termat e Referencës, shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit pasi këto dokumente siç referohet në kontratë përbëjnë pjesë integrale të saj.

Nuk kemi një monitorim të Kontratës sipas Nenit 1 të saj në lidhje me implementimin dhe zbatimin e elementeve të përshkruar nga AK ,për termat e referencës dhe specifikimet teknike si më poshtë:

- Skena e panairit (ngyrat e përdorura, struktura dhe banku i ekspozimit etj, sipas përcaktimeve të dhëna në dokumentat e tenderit;
- Specifikat e kostumeve tradicionale;
- Prezantimi audioviziv;
- Lenda e parë dhe recetat e planifikuara për eventin sipas specifikimeve teknike të AK;
- Strategjia e komunikimit;
- Paketimi i materialeve të skenës dhe produktet për transport dhe ekspozim si dhe stafin teknik, pasi AK ka parashikuar udhëtimin dhe akomodimin e stafit.

Personat përgjegjës për ndjekjen e kontratës duhet të kryenin monitorimin e proçesit të realizimit për tu siguruar që kontrata zbatohet në përputhje me termat dhe kushtet e prokuruar sipas Nenit 124, pika 1 të LPP-së. Gjithashtu sektori i Financës duhet të kryente kontroll për rregullshmërinë e dokumenteve të marrjes në dorëzim para realizimit të kryerjes së pagesës sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Fatura e kontraktorit duhet të verifikohet nga komisioni i marrjes në dorëzim , struktura për ndjekjen e zbatimit të kontratës dhe ne vijim nga struktura përgjegjëse për financat lidhur me sasinë dhe vlerën e paraqitur në faturë, e cila duhet të përputhet me sasinë dhe vlerën e marrë në dorëzim nga kontraktori.

Nga auditimi i dokumenteve të punës rezultoi se autoriteti kontraktor ka kryer dy likujdime në Bankën Kombëtare Tregtare kontraktorit, ku janë bashkëlidhur kërkesë për parapagim dhe shuma e kërkuar prej 3,042,000 lekë, Faturë tatimore nr. 388 datë 20.06.2025 me vlerën 3,042,000 lekë ndërkohë që Memo nga grupi i monitorimit me nr. 1592/13 date 26.06.2025, drejtuar Titullarit të AK është përgatitur në datën 26.06.2025. Me kërkesë të kontraktuesit 4 ditë pas fillimit të zbatimit të kontratës është kërkuar me shkresën 1592/2 date 20.06.2025 pagesë pjesore për impementimin e skenës së panairit dhe shërbim arkitekti (projektim), ndërkohë që në Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.2.1 është kërkuar vërtetim për xhiron vjetore të tre viteve të fundit me argumentimin se i shërbejnë AK për njohjen e gjendjes financiare të OE dhe mundësisë së operatorit fitues, për përmbushjen me sukses të kontratës.

Kushtet e kontratës parashikojnë pagesë të veçantë në Nenin 17 , por jo në masën 20%. Kërkesa e OE është e pa argumentuar edhe me zërat përkatës për implementimin e standës si më poshtë:

Përshkrimi	Sasia	Cmimi/njesi	Çmimi total(leke)
Qilim tradicional	1	90,000	90,000
Elemente dekorative	9	65,000	585,000
Ekspozitore banak	4	45,000	180,000
Dollap i mbyllur	2	45,000	90,000
Raft metalik 5 ndarje	4	55,000	220,000
Raft metalik 2 ndarje	2	55,000	110,000
Panele me print	1	210,000	210,000
Çmimi pa Tvsh			1,485,000 lekë
<b>Çmimi me Tvsh</b>			<b>1,782,000 lekë</b>

-Sipas Urdhër Transfertës të datës 02.07.2025 është likuiduar nga sektori i financës shuma prej 3,042,000 lekë, paguar 20% të vlerës kontratës, vlerë e cila nuk është parashikuar në Nenin 17 “Afatet e pagesës” dhe nga dokumentet likuidimi do të kryhej për vlerën e implementimit të standës në vlerën 1,782,000 lekë, sipas listës të trajtuar më lart nga grupi i auditimit.

Siç shihet diferenca e likuiduar më tepër është 1,260,000 lekë, vlerë e cila duhej të likuidohej me përfundimin e shërbimit dhe zbatimin e kushteve të kontratës (kthimi i standës, materialet promocionale, produktet ushqimore TGJ, transporti, etj). *U konstatua se më datë 28.07.2025 është likuiduar nga sektori i financës pjesa e mbetur e kontratës në shumën 11,978,276 lekë.*

Pas përfundimit të Panairit, nuk është mbajtur Akt dorëzimi të standës së përfunduar sipas specifikimeve teknike në Panairin e Gjenevës midis palëve dhe nuk ka asnjë dokument dorëzimi të materialeve të Panairit të nënshkruar mes palëve. Gjithashtu për prodhimet ushqimore të mbetura, materialet promocionale të pashpërndara nuk është mbajtur Proçes Verbal mbi sasi të përdorura (nuk ka informacion sa janë përdorur) dhe sasi të përdorura për tu kthyer në magazinën e institucionit, *duke krijuar një efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit në vlerën 6,331,980 lekë, vlerë e cila në se do të magazinohet, do përdoret nga institucioni për pritje përcjellje dhe evente të tjera vijuese gjatë aktiviteteve ushtrimore të institucionit.*

**Titulli i gjetjes:** Mungesa e miratimit të Relacionit nga titullari lidhur me përcaktimin e fondit limit nga komisioni i përlllogaritjes së fondit limit; Mungesë e marrjes në dorëzim sipas kushteve të kontratës së nënshkruar mes palëve; Kryerja e pagesës pa siguruar dokumentacionin përkatës dhe jo në përputhje me Kontratën.

<b>Gjetje Nr. 7</b>	
<b>Subjekti i audituar</b>	Drejtoria e Përgjithshme e DPPI Tiranë
<b>Subjektet e interesuara nga gjetja</b>	Titullari i Autoritetit Kontraktor Komisioni hartimit specifikimeve dhe percaktimit fondit limit Personi përgjegjës për prokurimin Komisioni KVO Komisioni i ndjekjes dhe monitorimit te kontratës Nëpunësi zbatues dhe specialisti i Financës
<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	-Ligji Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar; -VKM-së Nr. 768 datë 15.12.2021 "Për percaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të veçanta, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik, si dhe rregullave të detajuara për prokurimin e tyre", i ndryshuar; -VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar; -Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. -Shkresa e MEKI-t nr. 4026/1 prot, datë 18.03.2025.
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<b>Situata:</b> Për procedurën me objekt "Shërbime për panairin "Promovimi i Treguesve Gjeografikë dhe Kulturës Shqiptare" në Gjenevë (SIDE EVENT)", nuk është përgatitur "Relacion përmbledhës", nga grupi punës (A.Ç, A.Z, M.C) për përlllogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike për tia paraqitur Titullarit të AK percaktimin e vlerës së fondit limit të përlllogaritur prej 13,500,000 lekë pa Tvsh i cili mbi këtë bazë vepron për daljen e Urdher Prokurimit dhe vazhdimin e procedurës në vijim.  Midis Operatorit Ekonomik "Iceberg Communication" shpk dhe DPPI-së është lidhur kontratë nr. 1592/11 prot, datë 11.06.2025 me Objekt: "Shërbime për panairin "Promovimi i Treguesve Gjeografikë dhe Kulturës Shqiptare" në Gjeneve (SIDE EVENT)".  Nga kontrolli i dokumentacionit rezulton se nuk është ngritur Urdhëri për marrjen në dorëzim nga Titullari i AK dhe si rrjedhojë mungon Proçes verbali për marrjen në dorëzim të shërbimeve që do të realizohen sipas Aneksit 1 të Kontratës së lidhur, proçes i cili i ngarkohej edhe Komisionit të Monitorimit.  Kontrata do të ndiqet për zbatim me Urdhër Nr.59 datë 04.09.2025 "Për monitorimin e Kontratës nr. 1592/11 prot, datë 11.06.2025 nga

komisioni i ngritur me përfaqësues: Kryetar E.Shiroka dhe Anëtar grupi S.Qatipi dhe N.Nuraj. Në Pikën 4 të Urdhërit theksohet se grupi i monitorimit do të monitorojë realizimin e kontratës dhe do të ***marrë në dorëzim shërbimin objekt i kontratës sipas përcaktimeve në specifikimet teknike.***

-Sipas Urdhër Transfertës datë 02.07.2025, është likuiduar nga sektori i financës shuma 3,042,000 lekë, paguar 20% e vlerës kontratës, vlerë e cila nuk është parashikuar në Nenin 17 “Afatet e pagesës”, kur në fakt duhej likuiduar vlera e implementimit të standës në shumën 1,782,000 lekë, sipas listës të trajtuar nga grupi i auditimit në tabel. Siç shihet diferenca e likuiduar më tepër është 1,260,000 lekë, vlerë e cila duhej të likuidohet me përfundimin e shërbimit dhe zbatimin e kushteve të kontratës (kthimi i standës, mat.prom, prod.ushqimore TGJ, transport). Më vonë më datë 28.07.2025 është likuiduar vlera e mbetur e kontratës prej 11,978,276 lekë.

Pas përfundimit të Panairit, nuk është mbajtur Akt dorëzimi të standës së përfunduar sipas specifikimeve teknike në Panairin e Gjenevës midis palëve, si dhe nuk ka asnjë dokument dorëzimi të materialeve të Panairit të zhvilluar në Gjenevë. Gjithashtu për produktet ushqimore të mbetura, materialet promocionale të pashpërndara, nuk është mbajtur Proçes Verbal mbi sasitë e përdorura (nuk ka informacion sa janë përdorur) dhe sasitë e papërdorura për tu kthyer në magazinën e institucionit. Si rrjedhojë asnjë nga zërat përbërës të standës, nga verifikimi i Fletë-Hyrjeve të magazinës nuk rezulton të jetë bërë hyrje në institucion.

Mos kryerja e këtyre veprimeve ngarkojnë strukturat përgjegjëse, me përgjegjësi për shkak efektit financiar negativ të krijuar në buxhetin e shtetit në shumën 6,331,980 lekë, vlerë e cila AK mund ta përdorte për pritje përcjellje ose evente të tjera vijuese.

Raport Monitorimi për Side Event me nr. 2437/2 datë 28.07.2025, i mbajtur nga grupi i monitorimit, rezultoi se është firmosur nga anëtarët e komisionit, *por zj. N.Nuraj anëtare komisioni, nga verifikimi i shkresës të MEKI-t nr. 4026 prot., datë 18.03.2025 “Miratim kërkesë për kryerje shërbimi” në Gjenevë, Zvicër, nuk ka marrë pjesë në Panairin e zhvilluar dhe si rrjedhojë ka nënshkruar në mënyrë fiktive raportin e monitorimit.*

**Kriteri:** -Neni 124, Pika 1, Neni 125, i Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;

	<p>-VKM-së Nr.768 datë 15.12.2021 “Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të veçanta, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik, si dhe rregullave të detajuara për prokurimin e tyre”, i ndryshuar;</p> <p>-Neni 36, Pika 1, VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;</p> <p>-Pika 36, e Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar,</p> <p>-Shkresa e MEKI-t nr.4026/1 datë 18.03.2025, protokolluar në DPPI me nr. 1316 prot, datë 19.03.</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> -Mungesa e dorëzimit me proces verbal të materialeve dhe artikujve të pa përdorura mes Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktorit, nuk jep siguri në menaxhimin e buxhetit; Krijon mungesë monitorimi për kontrata të tjera vijuese, për arsye të mosfunksionimit të kontrollit të brendshëm në institucion.</p> <p><b>Shkaku:</b> -Mungesa e magazinimit të materialeve dhe artikujve, ka shkaktuar efekt negativ në buxhetin e shtetit, dhe mungesa e trajnimit të punonjësve për monitorimin e kontratave.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut</b>	I Lartë
<b>Konkluzioni</b>	<p>Nga auditimi dhe analiza e situatës së paraqitur në procedurën me objekt “Shërbime për panairin “Promovimi i Treguesve Gjeografikë dhe Kulturës Shqiptare” në Gjenevë (SIDE EVENT)”, konstatohet, mungesa e duhur e zbatimit të kontratës dhe monitorimit të saj, si dhe marrjes në dorëzim të shërbimit dhe pagesë pa dokumente justifikues, të realizimit të kontratës nr. 1592/11, datë 11.06.2025, Gjithashtu rezultoi se mungojnë dokumente si relacion përmbledhës, proces verbal marrjeje në dorëzim, akt dorëzimi stende/materialelesh, proces verbal për produktet ushqimore dhe materiale promocionale të mbetura), si dhe pagesa të parakohshme dhe jo në përputhje me afatet kontraktuale, monitorim me nënshkrim fiktiv, ka krijuar efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit në vlerën e paktën <b>6,331,980 lekë</b>. Veprime të cilët ngarkojnë me përgjegjësi, strukturat përgjegjëse të autoritetit kontraktues (AK).</p>
<b>Rekomandimi</b>	<p>-Të bëhet hyrje në magazinë sipas zërave të stendës vlera e munguar prej 1,782,000 lekë, të evitohen pagesat e parakohshme nga financa, komisioni i monitorimit të mos nënshkruaj në mënyrë fiktive pa marrë pjesë në panair dhe pa dokumente justifikuese.</p> <p>-Në të gjitha panairët e organizuara, AK për çdo kontratë të krijoj komision të marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve, të bëhen hyrje artikujt e kthyer dhe të pa përdorur, veprime që kanë krijuar efekt</p>

	financiar negativ në buxhet në vlerën 6,331,980 lekë, vlerë e cila institucioni e përdorte për pritje përcjellje dhe evente të tjera vijuese.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	<i>Të ndiqet rekomandimi, audituesi nuk pranon dhe nuk ndryshon qëndrim ndaj gjetjes dhe konkluzionit. Vlera e trajtuar si efektit financiar nuk konsiderohet dëm ekonomik</i>
<b>Statusi i rekomandimit</b>	<i>Nuk ndryshon Niveli i Riskut dhe Statusi</i>

8. Në arkivin e institucionit të DPPI-së, nuk ka praktika të administruara në dosje të veçantë të çdo prokurimi me vlerë të vogël nga 100,000 lekë deri në 1,000,000 lekë dhe me vlerë mbi 1,000,000 lekë pa tvsh, zhvilluar nëpërmjet sistemit elektronik në app, nga autoriteti kontraktor gjatë periudhës së audituar. Personi përgjegjës për prokurimin dorëzon gjithë dokumentet e procedurës së prokurimit te nëpunësi zbatues, nëpërmjet një procesverbali, i cili nënshkruhet nga dy palët, të gjithë praktikant e blerjeve elektronike ndodheshin bashkëlidhur urdhër shpenzimeve në financë dhe në dosje të pa inventarizuar nga personi përgjegjës i hedhjes në sistem të procedurave; pra rezulton nuk ka patur praktikë të blerjeve të administruar në dosje të veçantë të inventarizuar, sipas rregullave të shërbimit arkivor.

**Titulli i gjetjes:** Mungesa e arkivimit të dokumentacionit në dosje të veçantë për çdo procedurë elektronike prokurimi.

<b>Gjetje Nr. 8</b>	
<b>Subjekti i audituar</b>	Drejtor i Përgjithshëm i DPPI Tiranë
<b>Subjektet e interesuara nga gjetja</b>	Titullari i Autoritetit Kontraktor Personi përgjegjës për prokurimin Personi përgjegjës për sekretari-arkivin e institucionit Nëpunësi zbatues
<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	-Ligji nr.9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”; -Ligji për Prokurimin Publik dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; -Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.17, datë 06.07.2021 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr.13, datë 10.03.2020 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr.24, datë 29.08.2019 “Për përdorimin e Arkivës Elektronike në procesin e ekzekutimit të buxhetit të shtetit nga Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<b>Situata:</b> Në arkivin e institucionit të DPPI-së nuk ka praktika të prokurimeve të realizuara, të administruara në dosje të veçantë, të çdo prokurimi me vlerë të vogël nga 100,000 lekë deri në 1,000,000 lekë dhe me vlerë mbi 1,000,000 lekë pa tvsh, zhvilluar në rrugë elektronike nga autoriteti kontraktor gjatë periudhës së audituar të vitit

	<p>2024-2025. Personi përgjegjës për prokurimin dorëzon gjithë dokumentet e procedurës së prokurimit te nëpunësi zbatues, nëpërmjet një procesverbali, i cili nënshkruhet nga dy palët. Procesverbali ndër të tjera përmban edhe inventarizimin e gjithë dokumenteve të dorëzuara, pra emërtimin, njësinë dhe sasinë e fletëve.</p> <p>Pra, gjithë dokumentacioni i procedurave të prokurimit administrohet në arkivën e Sektorit të Financës dhe jo në Arkivën e Institucionit.</p> <p><b>Kriteri:</b> -Ligji nr.9154 date 06.11.2003 “Për Arkivat”.</p> <p>Normat tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në RSH, neni 5, neni 20, neni 21.</p> <p>Vendim i Këshillit të Lartë të Arkivave nr. 4, datë 19.6.2017 “Për miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të RSH”.</p> <p>paragrafi me nr.9, paragrafi nr.10, i çështjes V. Dokumentacioni mbështetës i nevojshëm sipas natyrës së transaksionit financiar, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.17, datë 06.07.2021 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr.13, datë 10.03.2020 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr.24, datë 29.08.2019 “Për përdorimin e Arkivës Elektronike në procesin e ekzekutimit të buxhetit të shtetit nga Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Moszbatim i rregullave dhe normave tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në RSH ka sjellë mungesën e arkivimit të çdo procedure në dosje të veçantë. Gjatë punës në terren për periudhën e audituar janë vënë në dispozicion urdhër shpenzimet e likuidimit të prokurimeve dhe dokumentet justifikuese bashkëlidhur urdhër shpenzimit dhe dosje prokurimi që mbaheshin nga përgjegjësi i sistemit; pra pa patur praktikë të administruar në dosje të veçantë sipas rregullave të shërbimit arkivor.</p> <p><b>Shkaku:</b> Mungesa e praktikave të mira; shoqëruar me mungesën e trajnimit të punonjësve të përfshirë në proceset e prokurimit dhe punonjësit të ngarkuar me detyrën e protokoll-arkivit.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut</b>	I mesëm
<b>Konkluzioni</b>	<p>Proçedurat e prokurimit me vlerë të vogël, zhvilluar me proçedurë elektronike gjatë periudhës së audituar nuk janë administruar në dosje të veçantë të sistemuar me gjurmë auditi, e më pas nuk janë arkivuar, sipas përcaktimeve në normat tekniko profesionale të shërbimit arkivor në RSH. Madje jo gjithë dokumentet e përgatitura gjatë procedurave të prokurimit janë protokolluar.</p>

	<p>Personi përgjegjës për prokurimin dorëzon gjithë dokumentet e procedurës së prokurimit te nëpunësi zbatues, nëpërmjet një procesverbal, i cili evidenton dokumentacionin e dosjeve dhe nënshkruhet nga dy palët.</p> <p>Procesverbali ndër të tjera përmban edhe inventarizimin e gjithë dokumenteve të dorëzuara, pra emërtimin, njësinë dhe sasinë e fletëve. Pra, gjithë dokumentacioni i procedurave të prokurimit administrohet në Sektorin e Financës (bashkëlidhur çdo urdhër shpenzimi) dhe administrohet në arkivën sektorit juridik (përgjegjesi i sistemit të App-së), dhe jo dokumentuar çdo dosje prokurimi me protokoll në Arkivën e Institucionit.</p> <p>Nuk mund të administrojë nëpunësi zbatues dhe nëpunësi përgjegjës për sistemin të gjithë dosjen e procedurave të prokurimit, sepse është përcaktuar në udhëzimin e MFE se çfarë dokumentesh justifikuese duhet të përmbajë bashkëlidhur çdo urdhër shpenzim.</p>
<b>Rekomandimi</b>	-Të administrohen në një dosje të veçantë dokumentet e procedurës së prokurimit për prokurimet elektronike, dosje të cilat duhet të arkivohen për llogari të çdo viti ushtrimor, si dhe të mundësohet trajnimi i punonjësve të komisionit të blerjeve të vogla dhe punonjësit të ngarkuar me detyrën e sekretari-arkivit.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	<i>Të ndiqet rekomandimi i lënë në vijim</i>
<b>Statusi i rekomandimit</b>	<i>Statusi dhe risku nuk ndryshon</i>

Megjithë punën e mirë të bërë nga komisioni i prokurimeve që nga kërkesa për blerje, urdhër prokurimi, përcaktimi i fondit limit dhe specifikimet teknike, ftesa për ofertë, vlerësimi i fituesit, pritjen të mallit me proceverbal, njoftimi i kontratës, etj, e deri në krijimin e dosjes së procedurës së prokurimit për blerjet elektronike dorëzuar për likujdim në financë, përsëri sistemi paraqet mangësi të cilat duhet të korrigojen në vijim sipas gjetjeve të trajtuara nga grupi i auditimit. Për këtë arsye, si dhe nisur nga fakti që në datën 31.03.2021 ka hyrë në fuqi ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe janë miratuar akte nënligjore në zbatim të tij, rekomandohet që punonjësit e përfshirë në procesin e prokurimit të kryejnë trajnime për të përditësuar njohuritë e tyre me legjislacionin dhe praktikën më të mira të kësaj fushe.

Për sa më sipër, vlerësojmë se, konstatohet dobësi në mjedisin e kontrollit dhe në aktivitetet e ushtruara të kontrollit.

#### IV. 6. Sistemi i pagesave

Objektivi i auditimit: Vlerësimi nëse pagesat janë kryer konform Ligjit për buxhetin dhe udhëzimeve përkatëse nga Ministria e Financave për zbatimin e procedurave të zbatimit të buxhetit.

*Fushat të cilat do të merren në konsideratë gjatë auditimit:*

- Kryerja e shpenzimeve në përputhje me planin buxhetor të miratuar sipas programeve buxhetore ku bën pjesë njësia.
- Kryerja e kontrolleve para pagesës, lidhur me dokumentet origjinale të mjaftueshme që vërtetojnë kryerjen e shpenzimit dhe kontrollet e tjera të nevojshme dokumentare.
- Regjistrimi i realizimit të shpenzimeve buxhetore sipas klasifikimit buxhetor ekonomik në ditarin e shpenzimeve.

1. Nga auditimi rezultoi se shpenzimet janë kryer në përputhje me planin buxhetor të miratuar, sipas programeve të këtij institucioni dhe janë regjistruar sipas klasifikimit buxhetor ekonomik në ditarin e shpenzimeve, gjithashtu realizimi dhe rakordimi i shpenzimeve janë kryer në përputhje me pagesat e kryera nëpërmjet bankës BKT Tiranë, *por këshillojmë që të gjitha veprimet e kryera nëpërmjet bankës, të regjistrohen në kohë reale në kontabilitetin e institucionit, pasi i krijuan vështësi grupit të auditimit gjatë punës në terren.*

2. Gjatë zbatimit të buxhetit vjetor është ndjekur likuidimi i kontratave, në raste të veçanta u konstatua mosrespektimi i afatit të likuidimit prej 30 ditë nga data e paraqitjes së faturës tatimore origjinale të operatorit ekonomik, në përputhje me Nenin 52, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, trajtuar në gjetjen e këtij sistemi.

3. Nga verifikimi i urdhër shpenzimeve dhe dokumentacionit shoqërues bashkëlidhur, nuk rezultoi se kontraktuesi e ka realizuar objektin e kontratës jashtë afatit kontraktual. Nga ana e nëpunësit zbatues, është ndjekur furnizimi e mallit/shërbimit brënda afatit kontraktual dhe është likuiduar vlera e plotë e kontratës, *përfunduar rastit që kemi trajtuar në gjetjen në sistemin e detyrimeve të prapambetura.*

1. Nga auditimi rezultoi se shpenzimet janë kryer në përputhje me planin buxhetor të miratuar, sipas programeve të këtij Institucioni dhe janë regjistruar sipas klasifikimit buxhetor ekonomik në ditarin e shpenzimeve dhe të bankës. Por nga auditimi u konstatua se regjistrimi i urdhër shpenzimeve mujore në ditaret financiare nuk është kryer në mënyrë kronologjike sipas numrit rendor të shpenzimit me datën e faturimit por regjistrohej fatura e subjektit me datën e likuidimit, veprim jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore për këtë qëllim.

**Titulli i gjetjes:** Kryerja dhe regjistrimi i shpenzimeve buxhetor nuk behet me datën e faturimit por regjistrohej fatura me datën e likuidimit, veprim jo në përputhje me rregjistrimin kronologjik kontabël, në ditarin e shpenzimeve dhe ditarin e bankës.

<b>Gjetje nr.1</b>	
<b>Subjekti audituar</b>	i Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale Tiranë

<b>Subjektet e interesuara nga gjetja</b>	Drejtor i Përgjithshëm Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Nëpunësi zbatues Përgjegjësi dhe Specialisti i financës
<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	Ligji 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; sipas të cilit “Sistem kontabël” është sistemi që përdoret për përcaktimin, marrjen në llogari, matjen, klasifikimin dhe paraqitjen e të dhënave financiare të veprimtarisë së një njësie ekonomike. Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar.
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<p><b>Situata:</b> Nga auditimi i ditarit të shpenzimeve dhe ditarit të veprimeve me bankën rezultoi se, regjistrimi i urdhër shpenzimeve mujore nuk është kryer në mënyrë kronologjike sipas numrit rendor të shpenzimit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore për këtë qëllim. U konstatua se urdhër transfertat janë pa numër rendor vetëm me datë, si dhe fatura e subjektit në çdo rast regjistrohej me datën e likujdimit të në ditarin e bankës dhe ditaret financiare, gjë për të cilat grupit të auditimit, i krijoi vështërsi dhe vonesa në verifikimin e shpenzimeve buxhetore të realizuara.</p> <p><u>Për sa më sipër</u> për mungesë të rregjistrimit kronologjik kontabël dhe regjistrim të faturave me datën e likujdimit me urdhër transfertë pa numër rendor në periudhën e audituar, në ditarin financiar dhe ditarin e bankës, ngarkohen me përgjegjësi nëpunësin zbatues dhe përgjegjësi i financës.</p> <p><b>Kriteri:</b> -Pika nr.1 dhe nr. 2, të nenit 3, Ligji 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, sipas të cilit: 1. “Mbajtje e kontabilitetit” është regjistrimi kronologjik në ditar dhe në llogari i të gjitha veprimeve dhe fakteve ekonomike që i përkasin një njësie ekonomike; 2. “Sistem kontabël” është sistemi që përdoret për përcaktimin, marrjen në llogari, matjen, klasifikimin dhe paraqitjen e të dhënave financiare të veprimtarisë së një njësie ekonomike.</p> <p>-Germa ë, paragrafi nr.3, neni 12, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ka përcaktuar një si prej përgjegjshmërive menaxheriale të nëpunësit zbatues “Mbajtjen e sistemit të kontabilitetit, raportimit për vendimmarrjen, në funksion të realizimit të objektivave, kontabilizimin e plotë, të saktë dhe në kohë të të gjitha transaksioneve, si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të njësisë, në përputhje me rregullat e miratuara nga Ministria e Financave”.</p> <p>-Paragrafi nr. 34, germa c) i Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar.</p>

	<p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Mungesa e regjistrimit të shpenzimeve buxhetore në mënyrë kronologjike në ditaret financiare sipas datës së faturimit nga OE, jep efekt negativ në drejtim të pasqyrimin jo të saktë të të dhënave kontabël.</p> <p><b>Shkaku:</b> Mungesa e regjistrimit kronologjik të urdhër transfertave me numër rendor të shpenzimeve në ditaret financiar, jep ndikim në një prej treguesve të performancës gjatë kontabilizimit të shpenzimeve të buxhetit.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut</b>	I mesëm
<b>Konkluzioni</b>	Regjistrimi i shpenzimeve financiare dhe faturave të operatorëve ekonomik (OE), jo në përputhje me normat dhe parimet e përgjithshme për mbajtjen kronologjike të kontabilitetit, gjatë veprimtarisë ekonomiko-financiare të vitit ushtrimor 2024 deri në 10 mujorin 2025, ndikon në mosidentifikimin e veprimeve të gabuara dhe në krijimin e risqeve të reja, si dhe ka ndikim në treguesit e performancës për kontabilitetin.
<b>Rekomandimi</b>	Të gjitha urdhër transfertat e plotësuar për kalimet në bankë (BKT), përveç datës së veprimit të plotësohet edhe me numër rendor, të regjistrohen në ditaret financiare në mënyrë kronologjike sipas numërit rendor të shpenzimit të kryer, dhe faturat e subjektit të regjistrohen me datën e faturimit dhe jo me datën e likuidimit në bankë, gjithë aktivitetit ushtrimor të vitit kalendarik.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	<i>Menjëherë dhe në vijimsi</i>
<b>Statusi i rekomandimit</b>	<i>Sipas rekomandimit</i>

2. Gjatë zbatimit të buxhetit vjetor u konstatua se në shumë raste nuk është respektuar afati i likuidimit prej 30 ditë, nga data e paraqitjes së faturës tatimore origjinale të operatorit ekonomik.

**Titulli i gjetjes:** Mungesa e respektimit të afatit 30 ditor nga data e paraqitjes së faturës tatimore origjinale të operatorit ekonomik, të likuidimit të shpenzimit.

<b>Gjetje Nr. 2</b>	
<b>Subjekti i audituar</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale Tiranë

<b>Subjektet e interesuara nga gjetja</b>	Drejtor i Përgjithshëm Nëpunësi autorizues Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve Nëpunësi zbatues
<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.07.2018 “Për Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit”.
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<p><b>Situata:</b> Gjatë auditimit të pagesave lidhur me zbatimin e buxhetit vjetor për periudhën e audituar u konstatua se, në disa raste nuk është respektuar afati i likuidimit prej 30 ditë, nga data e paraqitjes së faturës tatimore origjinale të operatorit ekonomik, sipas nenit 52, të ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor.</p> <p>Rasti 1: Fatura Tatimore datë 05.07.2025, e subjektit Fastech shpk rezulton se nuk është likuiduar për vlerën 1,879,400 lekë.</p> <p>Rasti 2: Fatura (Invoice) nr. 4, datë 30.04.2024, e subjektit EPO (zyra europiane e patentave) rezulton se nuk është likuiduar për vlerën 11,828,500 lekë.</p> <p>Rasti 3: Fatura (Invoice) nr. 7, datë 31.07.2024, e subjektit EPO (zyra europiane e patentave) rezulton se, nuk është likuiduar për vlerën 14,427,000 lekë.</p> <p>Rasti 4: Fatura (Invoice) nr. 10, datë 31.10.2024, e subjektit EPO (zyra europiane e patentave) rezulton se, nuk është likuiduar për vlerën 13,636,500 lekë.</p> <p>Përveç 4 raste të identifikuara në vlerën totale 41,771,400 lekë nga muajt e përzgjedhur, të cilat kanë krijuar detyrim të prapambetur, ka edhe veprime dhe raste të tjera të shpenzimeve financiare, që janë likuiduar me vonesë nga strukturat përgjegjëse, por janë në vlera të vogla për periudhën e audituar.</p> <p>Fatura Tatimore elektronike dhe dokumentacioni justifikues i shpenzimeve për blerje dhe shërbime, duhet të paraqiten në bankë brenda afateve të përcaktuara ligjore (nga data e faturës origjinale), me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore dhe shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura.</p> <p><u>Për sa më sipër</u> për mos respektim të disiplinës financiare dhe afateve të përcaktuara, strukturat përgjegjëse (nëpunësi zbatues dhe personi i ngarkuar me buxhetin dhe veprimet me bankën) ngarkohen me përgjegjësi për të gjithë periudhën e audituar.</p> <p><b>Kriteri:</b> -Neni 52, i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas të cilit: <i>“Nëpunësi zbatues i njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e</i></p>

	<p><i>pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE</i>”.</p> <p>-Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.07.2018 “Për Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit”:</p> <p>Paragrafi 185. <i>Nëpunësi zbatues i njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të Operatorit Ekonomik</i>”.</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Tejkalimi i afatit kohor të përcaktuar në ligj, pra mosrespektim i dispozitës ligjore, si dhe ndikim në një prej treguesve të performancës të ekzekutimit të buxhetit vjetor.</p> <p><b>Shkaku:</b> Mungesa e përlllogaritjes së faktorit “afat kohor” nga struktura përgjegjëse të ngarkuar për ndjekjen e fondeve dhe përgatitjen e urdhër shpenzimeve sipas planit buxhetor të miratuar.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut</b>	I Mesëm
<b>Konkluzioni</b>	Për periudhën e audituar Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues si dhe përgjegjësi i financës kanë krijuar detyrimeve të prapambetura (mbartur fatura për likuidim në vitin pasardhës), nuk kanë marrë masa lidhur me paraqitjen pranë BKT-së Tiranë, të faturës origjinale të OE dhe dokumentacionit justifikues të shpenzimeve, brenda afateve të përcaktuara ligjore. Gjatë vitit ushtrimor ka munguar respektimi i disiplinës financiare dhe përgatitjes së urdhër shpenzimit për likuidim, nuk është respektuar afati i likuidimit të shpenzimit prej 30 ditë, pas lëshimit të faturës tatimore origjinale të operatorit ekonomik.
<b>Rekomandimi</b>	Nëpunësi Zbatues dhe përgjegjësit i financës, të marrin masa, lidhur me paraqitjen për likuidim në kohë në BKT Tiranë, me Urdhër-transfer të për rastet e pagesave ndaj OE, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore dhe shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	<i>Menjëherë</i>
<b>Statusi i rekomandimit</b>	<i>Sipas rekomandimit</i>

Në përfundim vlerësojmë punën e mirë të nëpunësit zbatues për shoqërimin e urdhër shpenzimeve me dokumente justifikuese bashkëlidhur; ushtrimin e kontroleve efektive parandaluese e zbuluese mbi ligjshmërinë, saktësinë e plotësinë e përmbajtjes së këtyre dokumenteve justifikuese. Por Vlerësohet se nuk ka patur kontrole parandaluese për likuidimin në afat të faturave tatimore të operatorëve ekonomikë dhe detyrimeve që lindin nga marrëveshjet nderkombëtare (trajtuar tek detyrimet), kontraktuesi e ka realizuar objektin e kontratës brënda afatit kontraktual.

Për sa më sipër, sistemi i pagesave ka funksionuar sipas një mjedisi të mirë kontrolli; aktivitete efektive kontrolli dhe monitorim të plotë të aktivitetit ekonomik.

#### **IV. 7. Sistemi për kontabilitetin e raportimin financiar, duke përfshirë edhe auditimin e detyrimeve të prapambetura dhe menaxhimin e aktiveve.**

*Objektivi i auditimit:* Vlerësimi nëse regjistrimi i veprimeve financiare, pasqyrimi i detyrimeve të prapambetura dhe nxjerrja e pasqyrave financiare është kryer në përputhje me aktet ligjore në fuqi për kontabilitetin. Vlerësimi nëse menaxhimi i aktiveve kryhet në përputhje me udhëzimin përkatës për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik dhe në funksion të veprimtarisë së institucionit.

*Fushat të cilat do të merren në konsideratë gjatë auditimit:*

- Krijimi dhe mbajtja e regjistrit kontabël të gjithë aktiveve.
- Pasqyrimi në bilanc i të drejtave dhe detyrimeve.
- Pasqyrimi në bilanc sipas llogarive përkatëse i aktiveve dhe amortizimi i aktiveve.
- Pasqyrimi i inventarëve të aktiveve; rakordimi i tyre midis inventarizimit fizik dhe gjendjes kontabël të këtyre aktiveve.

Për periudhën objekt auditimi në DPPI rezulton se nëpunësi zbatues nuk ka krijuar dhe përditësuar regjistrin kontabël të aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra, sipas përcaktimeve në paragrafët 26-30, të udhëzimit nr.30. Regjistri kontabël mbahet në formën e kartelave, në përputhje me paragrafin nr. 26, të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar.

Për auditimin e këtij sistemi audituesi përzgjedhi pasqyrat financiare të vitit 2024, nga ku rezultoi se ato janë plotësuar në përputhje me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”; janë përgatitur të unifikuara sipas formateve të përcaktuara si dhe janë depozituar në kohë në Degën e Thesarit Tiranë sipas shkresës të institucionit nr. 1360/1 prot, datë 04.04.2025, depozituar me vonesë, këshillojmë se, *data e fundit e dorëzimit të bilancit është 31.03.2025.*

-Nga auditimi në drejtim të verifikimit të pasqyrimin të të drejtave dhe detyrimeve në bilancin e vitit 2024, rezulton:

Për vitin 2024, pasqyrimi në bilanc i mjeteve monetare në bankë në vlerën 119,790,764 lekë, e barabartë me llogarinë në rubrikën VI “Teprica në fund të vitit ushtrimor (119,790,764) në formatin nr. 3; -Llogaria 423.429 personeli, paradhënie, deficite e gjoba paraqitet në vlerën 0/lekë dhe pasqyrimi në bilanc i detyrimeve llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” rezulton në vlerën 0/lekë.

Për periudhën e audituar, sipas të dhënave kontabël në ditaret financiare u konstatua se nuk ka detyrime afatgjata të prapambetura ndaj punonjësve, subjekteve private apo ndaj të tretëve, perjashtuar vlera 59,935 lekë. Edhe në të dhënat e pasqyruar në bilancin 2024 lidhur me detyrimet e prapambetura për vitin 2024, llogaria 401-408 është 59,935 lekë, ndersa llogaria 467 rezulton 0 lekë.

Amortizimi vjetor i aktiveve dhe normat e amortizimit gjatë vitit 2024 janë aplikuar nga nëpunësi zbatues, sipas klasifikimit të aktiveve afatgjata materiale, në përputhje me pikën 36, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

- Nga auditimi i llogarive ekonomike të paraqitura në formatin nr. 1, bilanci 2024, pasqyrimi i tyre është i saktë, sipas klasifikimit ekonomik të llogarive të Aktiveve afatgjata materiale, rakordon me gjendjen kontabël të aktiveve në formatin 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Teprica Neto)”, të cilat paraqiten në shumën 15,395,137 lekë.

Formati nr.1, llogaria 212 “Ndërtime e Konstrukione” me vlerë 2,526,195 lekë; Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri e paisje” me vlerë 11,842,910 lekë; Llogaria 215 “mjete transporti” me vlerë 1,326,971 lekë; Llogaria 218 “Inventar ekonomik” me vlerë 4,700,994 lekë, gjendja Kontabël në bilanc është në total 20,397,070 lekë. Ndersa gjendja e inventarit qarkullues, Llogaria 31 “Materiale” me vlerë 5,635,484 lekë; gjendja kontabël në bilanc është në total 5,635,484 lekë.

Totali i Aktivit është i barabartë me totalin e Pasivit per shumën 271,990,947 lekë.

Nga auditimi i llogarive ekonomike të paraqitura në formatin nr. 2, bilanci 2024, pasqyrimi i tyre është i saktë, për të ardhurat vlera 256,919,873 lekë e krahasuar me formatin nr. 3 rubrika I “Veprimtarit e shfrytëzimit” (256,919,873); dhe shpenzimet vlera 129,186,282 lekë e krahasuar me veprimet në bankë BKT, këto janë të dhena të sakta me programin financa 5.

Në drejtim të pasqyrimin në bilanc sipas llogarive përkatëse të aktiveve dhe pasiveve si dhe formatet nr.3, nr.4, nr.5, nr. 6 dhe nr. 7/a, rezulton se ky pasqyrim është i saktë, sipas klasifikimit ekonomik. Edhe amortizimi vjetor i aktiveve dhe normat e amortizimit gjatë vitit 2024, janë aplikuar sipas klasifikimit të aktiveve afatgjata materiale.

Por gjatë raportimit të bilancit 2024, është raportuar datë 04.04.2025 gabim tek aktivet, llogaria ekonomike 512 “Mjete monetare në bankë” shuma 119,790,764 lekë, krahasuar me raportimet nga ridërgimi i bilancit më datë 27.05.2025 me shkresë nr. 2106/1 prot., raportuar 114,878,554 lekë, llogaria ekonomike 512 “Mjete monetare në bankë”, pra është raportuar 2 herë me vlera të ndryshme, më pak 4,912,210 lekë, për këtë mban përgjegjësi nëpunësi zbatues dhe autorizues, të cilët duhet të çertifikonin bilancin 2024 nga audituesi i pavarur deri më 31.03.2025, kjo vertetohet edhe nga kontrata e lidhur me vonesë nga institucioni me audituesin në datë 01.05.2025.

Gjithashtu pasqyrat financiare të vitit 2024, janë mbyllur jo të sakta dhe të plota me të gjitha formatet pasi u konstatua se nuk ka pasqyrimin të shumës 39,892,000 lekë, në llog. 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në aktiv, kundrejt llog. 467 “Kreditor të ndryshëm” në pasiv, në pasqyrat financiare 2024 (Çështje e sqaruar më poshtë tek analiza e detyrimeve të prapambetura) nuk janë kontabilizuar 3 fatura të palikujduara të EPO-së, të vitit 2024.

*Këshillojmë se bilanci vjetor raportohet dhe çertifkohet nga audituesi i pavarur, vetëm 1 herë në vit deri më datë 31.03.2025, ku na rezulton se nuk janë zbatuar afatet e dorëzimit të bilancit dhe pasqyrat financiare 2024, të cilat janë mbyllur jo të sakta në formatet e tij, veprim i cili bie në*

*kundërshtim me aktet ligjore për pasqyrat financiare dhe kontabilitetin, si rrjedhojë të bëhet sistemimi në bilancin e vitit 2025 sipas afatit ligjor.*

### **Inventarizimi i pronës në DPPI për vitin 2024.**

Nga auditimi u konstatua se institucioni ka kryer procesin e inventarizimit përpara mbylljes së llogarive vjetore për periudhën e audituar, në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kreu IV pika 74. Titullari ka ngritur komision të inventarizimit, për të përfunduar procesin e inventarizimit, në përbërje janë tre punonjës me specialistë të fushës, një kryetar dhe dy anëtar/e sipas urdherit nr. 4719 prot, datë 04.12.2024 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të përgjithshëm”.

Këto veprime janë kryer sipas Ligjit nr. 25, datë 10.05.2018, “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, neni 15 “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve”, pika 1; Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme”, Kreu 3.1 “Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 30. “Mbi këtë bazë, në kontabilitet bëhen veprimet për sistemimin e diferencave midis gjendjes fizike me gjendjen kontabile për llogari të vitit që mbyllet”.

Komisioni i inventarizimit ndër të tjera ka për detyrë të verifikojë ekzistencën e aktiveve dhe të vlerësojë aktivet, sipas listës së aktiveve të dorëzuara nga nëpunësi zbatues, sipas pikës 81 të udhëzimit nr. 30 ku citohet “Lista e aktiveve për inventarizim hartohet nga nëpunësi zbatues bazuar në të dhenat e regjistrit kontabël të aktiveve të njësisë”.

U konstatua se përpara fillimit të inventarizimit, nuk është fiksuar nr rendor i FH dhe FD së fundit me proces vëbal sipas pikës 83 të udhëzimit nr.30; komisioni nuk ka përpiluar një raport për gjendjen fizike të aktiveve, për të evidentuar aktivet e dëmtuara dhe kryerjen e procedurave për seleksionimit dhe asgjësimin e tyre, proces i cili nuk është kryer në vite, pamvarsisht blerjeve të kryera për paisje zyre, kompjuterike, etj. Komisioni ka dokumentuar procesin me një relacion përmbledhës të paraqitur titullarit të institucionit me mangësi të theksuara lidhur me klasifikimin e llogarive ekonomike sipas raportimit të tyre në formatin 7/a të bilancit 2024. Pra inventari është kryer formal, pa e ndarë në llogari aktive të qendrueshme dhe inventar qarkullues.

*Këshillojmë se inventari i përgjithshëm të rakordojë me llogarit ekonomike të bilancit vjetor 2025 dhe të zbatohen konstatimet e trajtuara më lart, para mbylljes së pasqyrave financiare 2025.*

*Në përfundim vlerësojmë se, DPPI për vitin 2024 ka kryer inventarin fizik vjetor të aktiveve në administrim të tij, një aktivitet kontrolli mjaft i rëndësishëm. U konstatua se kanë munguar aktivitetet e kontrollit efektiv mbi rakordimin e të gjithë të dhënave kontabël të pasqyruara në bilanc me inventarin fizik, të aktiveve të institucionit, vlerësojmë përpjekjet e strukturave, por ka nevojë për përmirësim më të mirë në këtë drejtim.*

Pasqyrat financiare të vitit 2024, janë mbyllur jo të sakta dhe të plota me të gjitha formatet pasi u konstatua se nuk ka pasqyrimin të shumës 42,235,131 lekë, në llog. 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në aktiv, kundrejt llog. 467 “Kreditor të ndryshëm” në pasiv, në pasqyrat financiare 2024 (Çështje e sqaruar analitikisht më poshtë tek analiza e detyrimeve të prapambetura). Rakordimi i të dhënave nuk ka qenë efektiv, duke mos ofruar informacion financiar të plotë e të saktë dhe në

afatet e përcaktuara ligjore. Bilanci 2024 ka pasqyruar aktivitetin ekonomik-financiar jo në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”. Nga krahasimi me situacionin e shpenzimeve për vitin 2024, shpenzimet e kryera nëpërmjet BKT-së rezultojnë se ato janë të barabartë me pasqyrën e performancës financiare (formati 2 dhe formati 3) të bilancit 2024.

### **Auditimi i të drejtave dhe detyrimeve të prapambetura për vitin 2024**

Nga auditimi i të drejtave ndaj punonjësve dhe të tretëve për 2024, sipas pasqyrave financiare rezultoi se, llogaria 423.429 “*Personeli, paradhënie, deficite, gjoba*” paraqitet në vlerën 0 (zero) lekë. Llog. 468 “*Debitorë të ndryshëm*” paraqitet në vlerën 0 lekë.

Llogaria 4342 “*Të tjera operacione me shtetit debitor*” (të drejta) paraqitet në vlerën 0 lekë në aktiv, ndersa detyrimet afatshkurtra në pasiv *shuma 21,323,016 lekë*, që përfaqëson detyrimet që ka DPPI ndaj furnitoreve 59,935 lekë, ndaj punonjësve për muajin dhjetor 2024 përkatësisht për pagat në vlerën 3,067,218 lekë, për tatim taksa në vlerën 368,773 lekë, për sigurime shoqërore dhe shendetsore në vlerën 1,075,091 lekë, si dhe llog.4341 “*Detyrime me shtetin*” 16,752,000 lekë, të cilat rezultuan të paguara janar dhe në gusht 2025.

Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura për vitin 2024 dhe 10 mujori 2025, u konstatua se sektori i financës nuk ka kryer në kohën e duhur pagesat për mbulimin e detyrimit ndaj EPO-S (Zyra europiane të patentave) *shuma 39,892,000 lekë* dhe Fastech shpk *shuma 1,879,400 lekë* si dhe penalitete për mos përmbushje të marrëveshjes mes palëve (DPPI dhe EPO) *shuma 463,731 lekë*, në total **42, 235,131 lekë**, rezultuan të pa kontabilizuara për detyrime ndaj të tretëve.

### ***Vlerësimi i saktësisë së regjistrimit të detyrimeve të prapambetura; -Analiza e detyrimeve të konstatuara për periudhën e audituar.***

Nga auditimi për regjistrimin e detyrimeve të prapambetura nga periudhat ushtrimore 2024 e në vijim, rezulton se nuk është kryer regjistrimi dhe raportimi në përputhje të Udhëzimit nr. 37, datë 06.10.2020, “*Për monitorimin dhe Publikimin Periodik të Stokut të Detyrimeve të Prapambetura*”, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.01.2018 “*Për procedurat standarte të zbatimit e buxhetit*”, pika 221, të Udhëzimit plotësues i Ministrit të Financave nr. 1, datë 24.01.2023 “*Për Zbatimin e Buxhetit 2024*”.

Raportimet mbi detyrimet e prapambetura nga Drejtoria e Buxhetit dhe shërbimeve në DPPI, për periudhën e audituar, nuk janë kryer në ministrinë përgjegjëse për ekonominë, për çdo 3 mujor nga 1 janari deri datë 31.03.2024. Gjatë punës në terren nuk është vendosur në dispozicion shkresa e raportimit të detyrimeve 1 prill 2024 deri 30 qershor 2024, edhe nga 1 korrik deri datë 31.08.2024, nuk ka raportime të detyrimeve, gjithashtu nga 1 tetor deri datë 31.08.2024, nuk ka raportime të detyrimeve. Vlera e akumuluar vjen si rezultat i mbartjes së detyrimeve të tre faturave të pa shlyera në vlerën 39,892,000 lekë

Referuar Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.01.2018 “*Për procedurat standarte të zbatimit e buxhetit*”, pika 221, dhe të Udhëzimit plotësues i Ministrit të Financave nr. 1, datë 24.01.2023 “*Për Zbatimin e Buxhetit 2024*” si dhe nga analiza e audituesit detyrimi duhet të ishin likujduar nga strukturat e ngarkuara për ndjekjen e buxhetit për të mos u mbartur për vitin 2025, ku sipas Urdhër Trensferete datë 22.07.2025, është likujduar fatura Invoice nr. 2000050, datë 15.05.2025 vlera 463,731 lekë, vlerë e paguar si penalitet për pagesë të vonuar të faturave datë 30.04.2024,

31.07.2024, 31.10.2024 (interesa në favor të EPO, perkatësisht 153,173 lekë, 210,891 lekë dhe 99,668 lekë). Gjithashtu për Kontratën nr. 26 datë 01.09.2022 “Për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të informacionit dhe implementimin e tij”, u konstatua se fatura e datës 01.07.2027 për shërbimet e mirëmbajtjes së sistemit, nuk është likuajduar për shumën 1,879,400 lekë, trajtimi i detyrimeve është në vijim të gjetjes.

1-Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura për vitin 2024 dhe 10 mujori 2025, u konstatua se drejtoria e financës nuk ka kryer në kohën e duhur pagesat për mbulimin e detyrimit ndaj EPO-S (Zyra europiane të patentave) shuma 39,892,000 lekë dhe Fastech shpk shuma 1,879,400 lekë si dhe penalitete për mos përmbushje të marrëveshjes mes palëve (DPPI dhe EPO) shuma 463,731 lekë, në total **42, 235,131 lekë**, rezultuan të pa kontabilizuara për detyrime ndaj të tretëve.

**Titulli i gjetjes:** Mungesa e likuidimit, regjistrimit, mosraportimit, mbartja e detyrimeve të prapambetura të vitit 2024 dhe 10 mujori 2025 të veprimtarisë ekonomike, në kundërshtim me aktet në fuqi.

<b>Gjetje Nr. 1</b>	
<b>Subjekti i audituar</b>	Drejtoria e Përgjithshme e DPPI Tiranë
<b>Subjektet e interesuara nga gjetja</b>	Drejtor i Përgjithshëm Nëpunësi Autorizues Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Nëpunësi zbatues Punonjësi përgjegjës për ndjekjen e buxhetit
<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	Ligji për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor  Udhëzimet në zbatim të Ligjit për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<b>Situata:</b> Gjatë periudhës së audituar u konstatua detyrim akumuluar nga mungesa e regjistrimit dhe mosraportimit, të tre faturave të vitit 2024 në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, duke çuar në akumulim të detyrimeve të faturave të dërguara nga EPO në vlerën 39,892,000 lekë, si dhe sipas Kontratës nr. 26 datë 01.09.2022 “Për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të informacionit dhe implementimin e tij”, u konstatua se fatura e datës 01.07.2025 për shërbimet e mirëmbajtjes së sistemit, nuk është likuajduar për shumën 1,879,400 lekë për vitin 2025. Vlera e mbartur në vitin 2025, ka krijuar pagesë penaltetesh (interesa vonesë) në shumën totale prej <u>463,731</u> lekë. Kjo sipas Urdhër Transfertes datë 22.07.2025, likuajduar fatura Invoice nr. 2000050, datë 15.05.2025 vlera 463,731 lekë, e paguar si penaltet të vonuar për mos zbatim të marrëveshjes të lidhur mes DPPI dhe EPO, të faturave datë 30.04.2024, 31.07.2024, 31.10.2024 (153,173 lekë, 210,891 lekë dhe 99,668 lekë).  Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura për vitin 2024 dhe 10 mujori 2025, drejtoria e financës dhe shërbimeve nuk ka kryer në kohën e duhur pagesat për mbulimin e detyrimit ndaj EPO-S (Zyra europiane të patentave) shuma 39,892,000 lekë dhe Fastech shpk shuma 1,879,400

lekë si dhe penalitete për mos përmbushje të marrëveshjes mes palëve (DPPI dhe EPO) shuma 463,731 lekë, në total **42, 235,131 lekë**, vlerë e cila rezulton e pa kontabilizuar, dhe e pa raportuar si detyrime ndaj të tretëve, për periudhën e audituar.

Në vlerësimin e audituesit, pamvarësisht se institucioni ka patur fonde të mjaftueshme në dispozicion, nëpunësi autorizuas dhe drejtoria e financës dhe shërbimeve, duhet të kishin marrë masa për kryerjen e pagesës sipas kushteve të vendosura që pagesa të kryhet brenda 30 ditëve nga data e faturës vlerën 42, 235,131 lekë. Gjithashtu për këtë problem për ti paraprirë penaltetit, strukturat duhet të ishin më eficient në ekzekutimin e veprimit financiar, dhe duhej bërë një analizë rreth këtij detyrimi, i cili duhet të zerohej me kohë për të shmangur dëmin ekonomik të krijuar prej 463,731 lekë.

Gjithashtu rezulton se, nuk është kryer regjistrimi dhe raportimi i detyrimeve të prapambetura të vitit 2024, në përputhje me Udhëzimin nr. 37/2020, si dhe raportimet tremujore nga strukturat përgjegjëse në DPPI dhe nuk janë dërguar në Ministrinë përgjegjëse për ekonominë (MEI) për periudhën e vitit 2024 dhe 10 mujori 2025.

Si pasojë, sipas Urdhrit të Transfertës datë 22.07.2025, është paguar penaltitet (interesa për vonesë) për faturat e datës 30.04.2024, datë 31.07.2024 dhe datë 31.10.2024 në favor të EPO-së, përkatësisht: Vlera 153,173 lekë plus vlera 210,891 lekë plus 99,668 lekë, në **Total penaltitete: 463,731 lekë** (sipas faturës Invoice nr. 2000050, datë 15.05.2025), ky veprim ka ardhur si rezultat i moskoordinimit të nëpunësit autorizues me nëpunësin zbatues, për likuidimin e vonuar.  
**Efekt financiar:** Dëm ekonomik në vlerën 463,731 lekë (pagesë penaltitetesh për shkak të likuidimit me vonesë).

Për sa më lart, kjo situatë tregon mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm financiar të institucionit, duke rezultuar në humbje financiare të shmangshme nga strukturat përgjegjëse.

**Kriteri:** -Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

-Ligji Nr.10296, datë 08/07/2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar;

-Pika 186 dhe pika 221-Përcakton procedurat për likuidimin e detyrimeve brenda vitit buxhetor për të shmangur mbartjen, e udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar.

-Udhëzimi plotësues të Ministrit të Financave nr. 1, datë 24.01.2023 "Për Zbatimin e Buxhetit 2024", -plotëson kërkesat për zbatim të buxhetit 2024, duke theksuar likuidimin e detyrimeve dhe shmangien e mbartjes në vitin pasardhës (2025-2026).

	<p>-Udhëzimi nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe Publikimin Periodik të Stokut të Detyrimeve të Prapambetura” -kërkon monitorim dhe raportim periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura.</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> -Mungesa e likujdimimit të faturave të vitit 2024-2025, ka dhënë ndikim në mosrealizimin e buxhetit të akorduar, mos realizimin e objektivave kryesore për përmbushjen e të cilave është akorduar ky buxhet.</p> <p>-Mosrespektim i transparencës dhe monitorimit të stokut të detyrimeve publike dhe mbartje të detyrimeve në vitin 2025-2026, duke rritur stokun dhe ngarkon buxhetin e ardhshëm, si dhe shkelje e rregullave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.</p> <p><b>Shkaku:</b> Mungesa e përmbushjes së detyrimeve nga strukturat e ngarkuara për ndjekjen e buxhetit (Titullari, Drejtoria e financës dhe shërbimeve në DPPI); Mungesë monitorimi dhe ndjekjeje për likuidimin e detyrimeve brenda vitit buxhetor 2024 -10 mujori 2025; Moszbatim i procedurave standarde për regjistrim, raportim dhe likuidim të detyrimeve në kohë.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut</b>	I Lartë
<b>Konkluzioni</b>	<p>Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura për vitin 2024 dhe 10 mujori 2025, u konstatua se drejtoria e financës nuk ka kryer në kohën e duhur pagesat për mbulimin e detyrimit ndaj EPO-S (Zyra europiane të patentave) shuma 39,892,000 lekë dhe Fastech shpk shuma 1,879,400 lekë si dhe penalitete për mos përmbushje të marrëveshjes mes palëve (DPPI dhe EPO) shuma 463,731 lekë, në total <b>42, 235,131 lekë</b>, rezultuan të pa kontabilizuara për detyrime ndaj të tretëve.</p> <p>Detyrimi për tre faturat e palikujduara me fondet e vitit 2024, ngarkon fondet buxhetore të vitit 2025. Situata është krijuar si rezultat i moskoordinimit të veprimeve mes Titullarit dhe Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve në DPPI, ka dhënë efekt financiar: Dëm ekonomik në vlerën 463,731 lekë, për pagesë penaltetesh për shkak likujdimi me vonesë të tre faturave të vitit 2024, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, duke çuar në akumulim të detyrimeve të faturave të dërguara nga EPO në vlerën totale 39,892,000 lekë, kjo e konstatuar sipas Urdhër Transfertes datë 22.07.2025 në BKT, likujduar fatura Invoice nr. 2000050, datë 15.05.2025 vlere 463,731 lekë, e paguar si penaltet të vonuar, si rezultat të moszbatimit të marrëveshjes të lidhur mes DPPI dhe EPO, të faturave datë 30.04.2024, datë 31.07.2024, datë 31.10.2024 (153,173 lekë, 210,891 lekë dhe 9,668 lekë). Gjithashtu sipas kontratës nr. 26, datë 01.09.2022 “Për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të informacionit dhe implementimin e tij”, nuk është likujduar fatura e shërbimit datë 01.07.2025 për shërbimet e mirëmbajtjes së sistemit, në shumën 1,879,400 lekë, si dhe nuk është raportuar si detyrim të prapambetur për 9 mujorin 2025.</p>

	Veprimtaria financiare e DPPI-së, nuk është në përputhje të plotë me kërkesat ligjore për regjistrimin, raportimin dhe pagesën në kohë të detyrimeve. Kjo situatë tregon mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm financiar të institucionit, duke rezultuar në humbje financiare të shmangshme. Audituesi vlerëson se kontrolli i brendshëm është joefektiv në këtë aspekt, me nivel rreziku deri të lartë, duke kërkuar përmirësime të menjëhershme për të shmangur përsëritje, të dëmit ekonomik të shkaktuar buxhetit të DPPI-së për periudhën e audituar, në vlerën 463,731 lekë.
<b>Rekomandimi</b>	-Të respektohet disiplina buxhetore, të shmanget risku për krijimin e detyrimeve të prapambetura, të kryhet analizë të shkaqeve dhe vonesave, të merren masa administrative/organizative/financiare ndaj përgjegjësve për dëmin ekonomik të shkaktuar në vlerën 463,731 lekë, vlerë e cila çdëmtohet, pas vlerësimit nga grupi punës të ngritur nga titullari. -Të kryhet menjëherë regjistrimi dhe raportimi i plotë i detyrimeve të prapambetura, të hartohet plan veprimi për likuidimin e detyrimeve brenda 30 ditëve nga faturimet në vijim të EPO-së, për të shmangur penalitete në të ardhmen, të forcohet monitorimi dhe të integrohet në sistemet e brendshme për të parandaluar përsëritjen.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	-Mbas analizës nga Dppi, të nxjerrjen përgjegjësit ndaj personave -Të çdëmtohet vlera deri në muajin shtator 2026
<b>Statusi i rekomandimit</b>	<i>Observacioni nuk pranohet, të zbatohet rekomandimi i lënë</i>

- Probleme të ndryshme të konstatuara gjatë punës në terren.

Gjatë punës në terren, nga auditimi i veprimeve të kryera lidhur me fletë hyrje-daljeve të artikujve material nëpërmjet magazinës, veprime të cilat kanë nevojë për përmirësim; rezultoi si më poshtë:

## 2. Verifikimi dhe administrimi i karburantit në DPPI

Gjatë verifikimit të shpenzimeve karburantit drejtuesi i financës dhe shërbimeve ka autorizuar edhe tërheqjen e karburantit nga magazina me kërkesë të shoferit.

U konstatua për periudhën e audituar se, nuk janë mbajtur fletë -udhëtime nga shoferi i mjetit, ato janë regjistruar në një liber pa protokoll dhe pa datë nisje-mbrritje, për të gjitha lëvizjet e kryera brenda dhe jashtë rrethit (nën dhe mbi 100/km), gjithashtu të dhënat në fund të çdo muaj mbi konsumin e karburantit nuk janë plotësuar (gjendja, furnizimi, norma e mjetit, diferenca në fund të muajit). Për nevoja pune të institucionit lëvizjet jashtë rrethit nuk ishin të shoqëruar me autorizim të titullarit. Rezultoi se nuk është dokumentuar furnizimi fizik i mjeteve, pasi në asnjë rast nuk janë bashkëlidhur pamjet filmike të printuara nga personi që administron paketën elektronike të kompanisë furnizuese (është printuar historiku i furnizimeve për çdo muaj dhe mjet) dhe nuk është tërhequr kuponi tatimor sipas furnizimit për çdo rast nga shoferi në pikat e karburantit të OE "Gega Oil" shpk për të rakorduar me datat sipas historikut të furnizimeve që printohet nga paketa elektronike e kompanisë. Siç shihet mungon vetëkontrolli i furnizimeve nga drejtoria e financës dhe shërbimeve, mungon përcaktimi i normës së konsumit të karburantit i cili shkarkohet konsumi nga të dhenat e librit të makinës, dhe jo të dokumentuar e plotësuar me fletë udhëtime për lëvizjet e

mjetit, të gjitha levizjet jashtë rrethit janë pa autoorizim dhe pa urdhër pune. Duhet të rishikohet dhe të ngrihet komision për të bërë përcaktimin e ri të normës së konsumit për automjetin e institucionit, pasi konsumi bazohej mbi të dhënat e librit të makinës që nga blerja e saj.

**Titulli i gjetjes:** Mungesa e mbajtjes së fletë-udhëtimeve për lëvizjen e automjetit dhe mungesa e përcaktimit të normës së konsumit për mjetin e institucionit.

<b>Gjetje nr. 2</b>	
<b>Subjekti i audituar</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale
<b>Njësit/subjektet e interesuara</b>	Drejtori i Përgjithshëm i DPPI Drejtoria e Buxhetit dhe Shërbimeve Nëpunësi zbatues Specialisti i Shërbimeve Shoferi i mjetit
<b>Përmbledhje e bazës ligjore</b>	-Ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; -Urdhrit nr. 2881 prot, datë 30.06.2025 “Caktimin e Personit Përgjegjës për Menaxhimin e faqes elektronike për Disiplinimin e Shpenzimeve të karburantit”.
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<p><b>Situata:</b> Për periudhën e audituar të vitit 2024 deri 10 mujori 2025, u konstatua se fletë-udhëtimet nuk janë mbajtur nga shoferi, levizjet janë të nënshkruar nga nëpunësi udhëtues në një libër pa protokoll dhe pa të dhëna për kilometrat e pershkruara dhe normën e konsumit. Për të gjitha lëvizjet e kryera brenda dhe jashtë rrethit (nën dhe mbi 100/km), nuk është plotësuar datë nisje dhe kthimi, as kolona nëpunësi urdhërues ku duhet të nënshkruajë për lëvizjen e punonjësve, gjithashtu të dhënat në fund të çdo muaj mbi konsumin e karburantit nuk janë plotësuar (gjendja, furnizimi, norma e mjetit, diferenca në fund të muajit). Për nevoja pune të institucionit lëvizjet jashtë rrethit nuk ishin të shoqëruar me autorizim të titullarit.</p> <p>Gjithashtu rezultoi se, nuk është dokumentuar furnizimi fizik i mjeteve, në asnjë rast nuk janë bashkëlidhur pamjet filmike të printuara nga personi që administron paketën elektronike të kompaninë furnizuese ndersa për automjetin është printuar historiku i furnizimeve për çdo muaj, por nuk është terhequr kuponi tatimor sipas furnizimit për çdo rast nga shoferi në pikat e karburantit të OE “Gega Oil” shpk për të rakorduar me datat sipas historikut të furnizimeve që printohet nga paketa elektronike e kompanisë. Siç shihet mungon vetëkontrolli i furnizimeve nga drejtoria e financës dhe shërbimeve, dhe përcaktimi i normës së konsumit të karburantit nuk është kryer, prandaj duhet të rishikohet dhe të ngrihet komision për të bërë përcaktimin e ri të normës së konsumit të automjetit.</p> <p><u>Veprimet më lart</u>, ngarkon me përgjegjësi Titullarin e institucionit dhe Personin përgjegjës për menaxhimin e faqes elektronike për disiplinimin e</p>

	<p>shpenzimeve të karburantit”, i caktuar me urdhër të brendshëm, lidhur me shpenzimet për karburant dhe normën e konsumit të automjetit.</p> <p><b>Kriteri:</b> -Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;</p> <p>-Pika nr. 1, 2, 3, të Urdhrit nr. 2881 prot, datë 30.06.2025 “Caktimin e Personit Përgjegjës për Menaxhimin e faqes elektronike për Disiplinimin e Shpenzimeve të karburantit”.</p> <p><b>Ndikimi/Efekt:</b> -Mungesa e kontrolleve drejtuese nga DPPI.</p> <p><b>Shkaku:</b> -Mungesa e nënshkrimit për km/e përshkruar në fletë udhëtime nga nëpunësi urdhërues dhe udhëtues për çdo lëvizje të mjetit.</p>
<p><b>Vlerësimi i nivelit të riskut(i lartë, i mesëm, i ulët)</b></p>	<p>I Mesëm</p>
<p><b>Konkluzioni</b></p>	<p>Nga auditimi për vitin 2024 dhe 10 mujori 2025, u konstatua se fletë-udhëtimet nuk janë mbajtur nga shoferi, lëvizjet janë të nënshkruar nga nëpunësi udhëtues në një libër pa protokoll dhe pa të dhenat e kilometrave dhe normën e konsumit. Për të gjitha lëvizjet e kryera brenda dhe jashtë rrethit (nën dhe mbi 100/km), nuk ka fletë udhëtime të plotësuar për datë nisje dhe datë kthimi, as kolona nëpunësi urdhërues ku të nënshkruajë për lëvizjen e punonjësve, gjithashtu të dhënat në fund të çdo muaj mbi konsumin e karburantit nuk janë plotësuar (gjendja, furnizimi, norma e mjetit, diferenca në fund të muajit). Për nevoja pune levizjet jashtë rrethit nuk janë shoqëruar me autorizim të titullarit.</p> <p>Furnizimi i mjetit me karburant nuk është i dokumentuar me pamjet filmike për datat e furnizimit të printuar nga personi që administron paketën elektronike të kompanisë furnizuese dhe nga shoferi nuk është terhequr kuponi tatimor sipas furnizimit për çdo rast në pikat e karburantit të OE “Gega Oil” shpk për të rakorduar me datat sipas historikut të furnizimeve që printohet nga paketa elektronike e kompanisë. Nga drejtoria e financës dhe shërbimeve, nuk është bërë përcaktimi i normës së konsumit të karburantit, prandaj duhet të rishikohet dhe të ngrihet komision për të bërë përcaktimin e ri të normës së konsumit të automjetit.</p>
<p><b>Rekomandimi</b></p>	<p>- Të plotësohen lëvizjet e automjetit me fletë-udhëtime të nënshkruar nga nëpunësi urdhërues dhe udhëtues, me datë nisje- kthimi dhe terheqje kuponi tatimor, si dhe të përcaktohet norma e konsumit të karburantit për mjetin e institucionit.</p>
<p><b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimeve</b></p>	<p><i>Rekomandimi i lënë nuk është pranuar, sqarimet janë dhënë në Aneksin 2</i></p>

<b>Statusi i rekomandimit</b>	<i>Nuk ndryshon statusi i gjetjes dhe rekomandimi</i>
-------------------------------	---

### 3. Saktësia dhe rregullariteti i veprimeve të kryera në magazinë

Nga auditimi sa i takon ditarit të magazinës dhe librit të magazinës rezultoi se, është mbajtur nga specialisti e financës dhe magazinieri (punonjës me kontratë me kohë të pjesëshme, i ngarkuar me veprimet e magazinës), kanë rakorduar çdo muaj mes tyre dhe veprimet janë hedhur periodikisht në to me programin financa 5. Për periudhën e audituar rezultoi se fletëhyrjet dhe fletëdaljet e aktiveve dhe materialeve janë hartuar sipas rendit kronologjik dhe pa korrigjime. Hyrja e aktiveve dhe materialeve në magazinë dokumentohet bazuar në faturën e subjekteve dhe proces verbalin e pritjes së mallrave dhe në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet plotësohen nga magazinieri (teknik i mesëm), pasi është bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit, në përputhje me përcaktimet e paragrafit 37, kreu III, të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar. Kontabilizimet e fletë-daljeve dhe fletë-hyrjeve janë bërë në mbështetje të planit kontabël në ditaret e magazinës; por rezultoi se të gjitha fletë-daljet mujore të kryera për periudhën e audituar, nuk shoqërohen me listë-shpërndarjen mujore (plan shpërndarje të artikujve material të bëra dalje nga magazina dhe urdhër dorëzimi nga përgjegjësi i financës. Fletë daljet ishin të bazuar vetëm mbi bazën e kërkesës për nevoja të artikujve që furnizohej në magazinë të nënshkruar. Dokumentacioni i magazinës përpilohet nga magazinieri dhe kontrollohet përgjegjesi i financës dhe shërbimeve, ndërsa kontabilizimi i veprimeve kryhet nga një specialist i sektorit të financës, lidhur me rregullshmërinë e shkarkimeve mujore.

**Titulli i gjetjes:** Dokumentimi i fletë-daljeve kryhet vetëm me kërkesë për materiale.

<b>Gjetje Nr. 3</b>	
<b>Subjekti i audituar</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale
<b>Subjektet e interesuara nga gjetja</b>	Drejtori i Përgjithshëm i Pronësisë Industriale; Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse; Sektori Juridik.
<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	Ligji nr.10296, datë 9.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<b>Situata:</b> Për periudhën e audituar rezultoi se fletëhyrjet dhe fletëdaljet e aktiveve dhe materialeve janë hartuar sipas rendit kronologjik dhe pa korrigjime. Aktivet dhe materialet në magazinë janë dokumentuar bazuar në faturën e subjekteve dhe proces verbalin e pritjes së mallrave dhe në çdo rast me fletëhyrjen sipas gjendjes fizike të tyre. Ato janë plotësuar nga magazinieri, pasi është bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit, në përputhje me përcaktimet e paragrafit 37, kreu III, të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar.

	<p>Të gjitha fletë-daljet mujore të kryera për periudhën e audituar, nuk shoqërohen me urdhër dorëzimi, proces verbal se ku janë përdorur artikujt dhe listë-shpërndarjen mujore, <i>por rezultoi se të gjitha fletë-daljet mujore të kryera për periudhën e audituar, për materialet e marra nga magazina shoqërohen vetëm me një kërkesë nga strukturat të nënshkruar nga palët (dorëzuesi-marrësi), pa dhënë arsye për përdorimin e artikujve higjieno sanitare, elektrike etj.</i> Dokumentacioni i magazinës përpilohet nga magazinieri dhe përgjegjësi i shërbimeve, ndërsa kontabilizimi i veprimeve kryhet nga një specialiste e sektorit të shërbimeve mbështetëse.</p> <p><b>Kriteri:</b> -Ligji nr.10296, datë 9.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Neni 4, pika 26 “Dokument financiar” është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumenti elektronik rregullohet me ligjin që rregullon dokumentin elektronik”. -Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar: Çështja, -Dalja e aktiveve nga magazina, paragrafi nr. 38 “Dalja e aktiveve nga magazina bëhet mbi bazën e urdhër-dorëzimit, fletë kërkesës, planit të shpërndarjes e kartelës limit dhe dokumentohet me fletë-daljen ose dokument tjetër të njësuar me të sipas specifikave të aktiveve”.</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> -Mungesa e krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv, në përdorimin dhe konsumin mujor të materialeve në magazinë, krijon mundësinë e keq përdorimit dhe të shpërndarjes së bazës materiale jo në përputhje me nevojat dhe kërkesat e sektorëve në institucion.</p> <p><b>Shkaku:</b> -Mungesa e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut</b>	I Mesëm
<b>Konkluzioni</b>	Për periudhën e audituar rezultoi se fletëhyrjet dhe fletëdaljet e aktiveve dhe materialeve janë hartuar sipas rendit kronologjik dhe pa korrigjime. Aktivitetet dhe materialet në magazinë janë dokumentuar bazuar në faturën e subjekteve dhe proces verbalin e pritjes së mallrave dhe në çdo rast me fletëhyrjen sipas gjendjes fizike të tyre. Ato janë plotësuar nga magazinieri, pasi është bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit, në përputhje me përcaktimet e paragrafit 37, kreu III, të udhëzimit të ministrit të

	<p>Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar.</p> <p>Të gjitha fletë-daljet mujore të kryera për periudhën e audituar, nuk shoqërohen me urdhër dorëzimi, proces verbal se ku janë përdorur artikujt dhe listë-shpërndarjen mujore, <i>por rezultoi se të gjitha fletë-daljet mujore të kryera për periudhën e audituar, për materialet e marra nga magazina shoqërohen vetëm me një kërkesë nga strukturat të nënshkruar nga palët (dorëzuesi-marrësi), pa dhënë arsye për përdorimin e artikujve higjieno sanitare, elektrike etj.</i> Dokumentacioni i magazinës përpilohet nga magazineri dhe përgjegjësi i shërbimeve, ndërsa kontabilizimi i veprimeve kryhet nga një specialiste e sektorit të shërbimeve mbështetëse.</p>
<b>Rekomandimi</b>	Në asnjë rast magazineri të mos lëshojë fletë-dalje, pa siguruar dokumentacionin e urdhër-dorëzimit, list shpërndarjes për nevojat ditore, planin e shpërndarjes dhe procesverbalin e konsumimit apo përdorimit të artikujve, strukturat përgjegjëse duhet të përditësohen me përcaktimet e akteve ligjore/nënligjore, në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollin dhe menaxhimit të aktiveve në njësitë e sektorit publik.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	<i>Në vijim të ndiqet rekomandimi</i>
<b>Statusi i rekomandimit</b>	<i>Referuar observacionit nuk ndryshon gjetja</i>

#### V.8. Vlerësimi i komponentëve të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Gjatë auditimit rezultoi se organizimi dhe funksionimi i DPPI-së është i përcaktuar në Ligji nr. 9947, datë 07/07/2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar, ku si objekt të tij ka rregullimin e sistemit të dhënies dhe mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale, si dhe rregullimi i sistemit të mbrojtjes së sekretit tregtar kundrejt përvetësimit, përdorimit dhe bërjes publike në mënyrë të paligjshme.

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale është institucion publik jobuxhetor dhe funksionon si agjenci autonome nën mbikqyrrjen e ministrit përgjegjës për ekonominë, ndërsa mardhëniet e punës për punonjësit, rregullohen nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Objektivat e Pronësisë industriale janë: a) disenjot industriale; b) emërtimet e origjinës; c) markat tregtare; 2 ç) modelet e përdorimit; d) patentat për shpikje; dh) treguesit gjeografikë.

Ligji nr. 9947, ka pësuar ndryshime të vazhdueshme për përmirësimin e funksionimit të regjistrimit të objekteve të PI, si dhe në kuadër të përafrimit me direktivat dhe rregulloret e BE-së.

Në vitin 2025 janë miratuar dy ligje të rëndësishme si Ligji Nr.52/2025 “Për markat tregtare” që ka për qëllim rregullimin në mënyrë të plotë të marrëdhënieve juridike që lidhen me markat tregtare në territorin e RSH, si dhe Ligji nr.53/2025 “Për Patentat, modelet e përdorimit dhe çertifikatat e mbrojtjes shtesë që ka për qëllim t’u sigurojë mbrojtjen e duhur shpikjeve të bëra nga persona fisike ose juridike, vendas ose të huaj, brenda ose jashtë RSH.

Më poshtë paraqitet auditimi i funksionimit të strukturave të drejtimit dhe administrimit të institucionit, ku në përbërje janë:

-Drejtori i Përgjithshëm; -Struktura organike me drejtoritë e saj, Drejtoria e Kordinimit, Trajtimit, Promovimit dhe Analizës; Drejtoria e Ekzaminimit; Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve

Mbështetëse; Sektori Juridik; -Këshilli Mbikqyrës; -Bordi i Apelit; -Dhoma për Shfuqizim/zhvlerësim; Dhoma e Kundërshtimeve; Komisioni i Vlerësimit; Politika e Cilësisë dhe Njësia e Prokurimit.

***U konstatua se DPPI ka kryer reformën ligjore në fushën e Pronësisë Industriale***

Reforma është ushtruar në rregullimin dhe përmirësimin e akteve në fuqi, kryesisht në Ligjin nr. 9947, datë 07/07/2008 “Për pronësinë industriale” i cili ka pësuar ndryshime të vazhdueshme për përmirësimin e funksionimit të regjistrimit të objekteve të PI, si dhe në kuadër të përafrimit me direktivat dhe rregulloret e BE-së. Ky ligj që nga vitit 2008 ka ndryshuar 4 herë, si më poshtë:

- Me ligjin nr. 10/2013, datë 14.02.2013; nr. 55/2014, datë 29.05.2014; nr. 17/2017, datë 16.02.2017; nr. 96/2021, datë 7.7.2021, ndryshimi është kryer për shkak se duke qenë para faktit se ligji 9947/2008 “Për pronësinë industriale” ka patur të parashikuar të gjitha objektet e PI-së, strukturat sipas drejtorive kanë hasur vështësi të karakterit teknik dhe logjistik në punën e përditshme, gjithashtu ligji nuk ka mundur të parashikojë të gjitha detajet aq të domosdoshme për trajtimin dhe rregullimin e të gjithë pikave që lidhen me objektet industriale; mbi këtë bazë ka lindur ideja e ndryshimeve të mëtejshme dhe përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE, duke kryer një reformë të thellë ligjore në këtë fushë me ndarjen e gjitha objekteve të Pronësisë Industriale në ligje të veçanta, të bazuar në disa modele dhe studime ligjore të vendeve të BE-së (si p.sh atë kroat, greke, etj).

- Reforma ligjore ishte e parashikuar në dokumentin e Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022-2025, e miratuar me vendimin nr. 350, datë 26/05/2022 të këshillit Ministrave si dhe në Planin Kombëtar të Integritimit Europian 2022-2025. Kjo është arsyeja pse të gjitha vendet e Europës i trajtojnë dhe i rregullojnë objektet e pronësisë industriale të përmendura me ligje të veçanta, mbi këtë bazë janë miratuar akte ligjore.

*Mjedisi i kontrollit*- Nga kontrolli i mjedisit në DPPI rezultoi se, organizimi dhe funksionimi i DPPI-së është i përcaktuar në Ligji nr. 9947, datë 07/07/2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar, ku si objekt të tij kishte rregullimin e sistemit të dhënies dhe mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale, si dhe rregullimi i sistemit të mbrojtjes së sekretit tregtar kundrejt përvetësimit, përdorimit dhe bërjes publike në mënyrë të paligjshme.

Edhe aktet nënligjore/aktet administrative të funksionimit të institucionit janë rishikuar në vitin 2023, siç është rregullorja e brendshme e miratuar me vendim nr. 14, datë 19.12.2024 nga Këshilli Mbikqyrës. Gjithashtu me vendim nr. 5, datë 19.12.2023 nga Këshilli Mbikqyrës është miratuar struktura organike e DPPI-së prej 37 punonjës, por u konstatua se nga ana e strukturave përgjegjëse nuk është përgatitur Rregullore për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e cila duhet të miratohet nga titullari i institucionit, si dhe rregullore e brendshme për funksionimin dhe organizimin e Këshillit Mbikqyrës.

Duke konsideruar gjetjet në sistemin buxhetor, në sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore, në sistemin e prokurimeve publike, në sistemin e pagesave, sistemit të kontabilitetit dhe kontrollit të brendshëm, etj, mjedisi i kontrollit duhet të forcohet më tej nëpërmjet realizimit të fondeve buxhetore, procedurave transparente të punësimit; duke siguruar konkurrencë e meritokraci të kandidatëve të interesuar, zbatim të akteve për prokurimet sipas gjetjeve, si dhe mangësi në menaxhimin e veprimeve në kontabilitet dhe mungesë të kontrollit të brendshëm, etj.

*Vlerësimi i rrezikut-* Për periudhën e audituar, është hartuar regjistri i riskut për çdo vit ushtrimor, i bazuar në urdhërin për ngritjen e grupit të punës, rezulton i dërguar në MEKI për periudhën e audituar.

Sipas përcaktimit në Ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin “*menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes*”.

Ndërsa, sipas përcaktimeve në Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, është hartuar regjistri i riskut për çdo vit ushtrimor, i cili duhet të jetë objekt rishikimi të paktën dy herë gjatë çdo viti ushtrimor. Vlen të theksojmë se vlerësimi i rrezikut nuk duhet të jetë thjeshtë një proces formal, pra regjistri i riskut të konsiderohet të kontrollohet dy herë në vit, për tu kryer plotësisht ky proces; *por risku duhet të shoqërohet me vlerësim dhe monitorim të kontrolleve të ngritura nga strukturat përgjegjëse.*

Në kushtet aktuale, në vëmendje maksimale të jetë vlerësimi i riskut operacional e riskut financiar.

Për sa më sipër, është i nevojshëm trajnimi i stafit në lidhje me komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit; pjesë e të cilit është edhe menaxhimi i riskut.

*Aktivitetet e kontrollit-* Referuar gjetjeve të trajtuara në këtë material, theksojmë se gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit jo gjithë aktivitetet e kontrollit kanë qenë në përputhje me përcaktimin në kriter.

Gjatë mbylljes së bilancit të vitit ushtrimor kanë munguar kontrolle efektive në drejtim të të aktiveve sipas llogarisë përkatëse gjatë inventarizimit 2024, si dhe ridorëzimi me vonesë të bilancit 2024 mbas datës 31.03.2025, pasqyrim i cili ka çuar vlerë të munguar jo të barabartë tëk gjendja e vlerave monetare.

Si pasojë e mungesës së kontrolleve efektive për regjistrimin, inventarizimin e aktiveve, rakordimin e veprimeve, nuk është siguruar një prej aktiviteve të rëndësishme të kontrollit, sidomos të kthimit dhe inventarizimit të materialeve qarkulluese dhe aktive, nga dy eventet të zhvilluara gjatë vitit 2025.

Për sa më sipër, në sistemet kryesore të funksionimit të institucionit kanë munguar kontrollet efektive parandaluese e zbuluese.

*Informacioni dhe komunikimi-* Referuar trajtimit të gjetjeve sipas këtij materiali rezulton se shkëmbimi i informacioneve ndërmjet punonjësve të të gjithë niveleve është kryer si horizontalisht dhe vertikalisht. Dokumentet hyrëse dhe dalëse nuk janë komunikuar në formën dhe kohën e duhur, si rjellojë e mungesës së protokollit të komunikimeve mes drejtorive dhe sektorëve.

Vlen të përmendim se është mjaft i rëndësishëm që informacioni dhe komunikimi i lejuar të ofrohen edhe nëpërmjet faqes zyrtare të institucionit, për ta bërë sa me efektiv këtë komponent, gjithashtu aktiviteti i njësisë kryhej në bashkëpunim, lidhur me nivelin e fshehtësisë së informacionit dhe kofidencialitetin.

*Monitorimi*- Meqenëse numri i punonjësve, veçanërisht Drejtoria e financës dhe shërbimeve mbështetëse, si dhe sektorit Juridik (të ngrihet në nivel drejtorie 1 +4), ku numri i punonjësve është i vogël, numër i cili nuk mundëson ndarje të detyrave dhe monitorim sipas hierarkisë, sepse i njëjti punonjës mund të ndjekë një proces pune nga fillimi në fund, pa patur monitorim nga një nivel më i lartë hierarkie, theksi vendoset te bashkëpunimi (ka munguar) ndërmjet strukturave të administratës së Dppi-së, monitorimi i vazhdueshëm i punës duhet kryer nga Drejtori i përgjithshëm, drejtorët e drejtorive dhe çdo sektor, si dhe çdo punonjës sipas kompetencave përkatëse. Pra është i rëndësishëm bashkëpunimi ndërmjet strukturave, vet monitorimi i vazhdueshëm nga çdo punonjës të institucionit sipas përgjegjësisë.

1- Nga auditimi lidhur me përfshirjen punonjësve në interesa private ose për shkak të detyrës funksionale që janë të ngarkuar nga institucioni u kanstatua se, mungon hartimi dhe miratimi i Rregullores për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në institucionin dhe Rregullorja e Këshillit Mbikqyrës për funksionimin dhe organizimin e këshillit mbikqyrës, e cila duhet përgatitur dhe miratuar nga ministri përgjegjës.

**Titulli i gjetjes:** Mungesa e Miratimit të Rregullores për Parandalimin e Konfliktit të Interesit;  
Mungesa e Miratimit të Rregullores të Këshillit Mbikqyrës.

<b>Gjetje nr. 1</b>	
<b>Subjekti i audituar</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale
<b>Subjektet e interesuara nga gjetja</b>	Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit; Drejtori i Përgjithshëm i Pronësisë Industriale; Drejtoria e Kordinimit, Trajtimit, Promovimit dhe Analizës; Drejtoria e Ekzaminimit; Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse; Sektori Juridik; Këshilli mbikqyrës i DPPI-së.
<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	Ligji 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; Ligji nr. 9367, datë 7.04.2005 “Per parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”. -Ligji nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar;
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<b>Situata:</b> Nga auditimi i shoqërisë u kanstatua se, mungesa e miratimit të Rregullores për Parandalimin e Konfliktit të Interesit për institucionin. Integriteti dhe percaktimi i kushteve të konfliktit të interesit për personelin, janë elementë thelbësorë që kontribuojnë në krijimin e një mjedisi të mirë kontrolli dhe funksionaliteti të Dppi-së. Institucioni në mbështetje të parimit të proporcionalitetit dhe të natyrës së veçantë të funksioneve të institucioneve publike dhe/ose të çdo zyrtari, nxjerr një rregullore të brendshme për parandalimin e interesave konkrete, ku përgjegjësia e menaxherëve inkoron dhe qëndron në vendosjen dhe komunikimit, demonstrimit të integritetit, duke respektuar vlerat e për të

	<p>penguar interesat personale me miratimin e rregullore për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.</p> <p>Gjatë auditimit u konstatua se mbledhjet thirren nga kryetari, me kërkesë të anëtarëve dhe drejtorit të përgjithshëm të paktën katër herë në vit, por këshilli mbikqyrës i organizonte mbledhjet sipas kërkesave, pa u orientuar në një rregullore të brendshme për funksionimin dhe organizimin e këshillit mbikqyrës, ku Drejtori i përgjithshëm i dppi-së ia paraqet këtë rregullore për miratim ministrit përgjegjës për ekonominë.</p> <p><b>Kriteri:</b> - Neni 29, i Ligjit 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;</p> <p>-Neni 46, i ligjit 9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”;</p> <p>-Neni 189/e “Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës”, pika 3, e Ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar;</p> <p>Pika 3 “Këshilli Mbikqyrës harton rregulloren e tij të brendshme për funksionimin dhe organizimin e KB. Drejtori i Përgjithshëm i Dppi-së ia paraqet këtë rregullore për miratim ministrit përgjegjës për ekonominë”.</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Me miratimin e këtyre akteve, ka ndikim krijimi i një mjedisi më të mirë për arritjen e objektivave të institucionit.</p> <p><b>Shkaku:</b> Mungesa e përditësimit me aktet ligjore/nënligjore në fuqi.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut</b>	I Mesëm
<b>Konkluzioni</b>	<p>Për periudhën e audituar Drejtori i Përgjithshëm e Pronësisë Industriale, nuk është të miratuar rregulloren për parandalimin e konfliktit të interesit, në ushtrimin e funksioneve publike.</p> <p>Institucioni në mbështetje të parimit të proporcionalitetit dhe të natyrës së veçantë të funksioneve të institucioneve publike dhe/ose të çdo zyrtari, nxjerr një rregullore të brendshme për parandalimin e interesave konkrete, prandaj titullari i institucionit dhe strukturat përgjegjëse duhet të miratojnë Rregulloren për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.</p> <p>Gjatë auditimit u konstatua se mbledhjet thirren nga kryetari, me kërkesë të anëtarëve dhe drejtorit të përgjithshëm të paktën katër herë në vit, por këshilli mbikqyrës i organizonte mbledhjet sipas rasteve me kërkesë, pa u orientuar sipas një rregullore të brendshme për funksionimin dhe organizimin e këshillit mbikqyrës, ku nese do kishin rregullore, Drejtori i përgjithshëm i dppi-së ia paraqet këtë rregullore për miratim ministrit përgjegjës për ekonominë.</p>
<b>Rekomandimi</b>	Të hartohet dhe miratohet Rregullore për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe Rregullore të brendshme të këshillit mbikqyrës, për të përmirësuar funksionimin dhe organizimin e brendshëm dhe respektuar vlerat e për të penguar interesat personale të administratës së Dppi-së.

Afati i fundit për zbatimin rekomandimit	Të zbatohet rekomandimi deri në muajin Korrik 2026
Statusi i rekomandimit	Nuk ndryshon gjetja dhe rekomandimi nga observacioni

2- Nga auditimi i sistemit të menaxhimit financiar rezulton se, mungon gjurma e auditimit e hartuar nga strukturat përgjegjëse të drejtorive dhe sektorëve brenda drejtorive si dhe sektorë të tjerë të DPPI, nga të cilët duhej përgatitur dhe miratuar nga Titullari i institucionit.

**Titulli i gjetjes:** Mungesa e hartimit dhe miratimit të gjurmës specifike të auditimit.

<b>Gjetje nr. 2</b>	
<b>Subjekti i audituar</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale
<b>Subjektet e interesuara nga gjetja</b>	Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit Drejtori i Përgjithshëm i Pronësisë Industriale; Drejtorja e Kordinimit, Trajtimit, Promovimit dhe Analizës; Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse; Sektori Juridik; Këshilli mbikqyrës i DPPI-së.
<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	-Kodi i Procedurave Administrative; -Ligji nr. 10296, datë 08.09.20210 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	Situata: Gjatë auditimit në terren nuk është vendosur në dispozicion të audituesit shkresë apo dokumenta që kanë të bëjnë me detyrimin për përgatitjen e gjurmës së auditimit për procedura që lidhen me veprimtarit kryesore të institucionit, pra nuk ka një gjurmë auditimi të miratuar me dokumente si urdhër për ngritjen e grupit të punës për gjurmën e auditimit për komunikimin administrativ mes drejtorive dhe sektorëve të Dppi-së, nëpërmjet protokollit që lidhen me veprimtarit kryesore si misioni, qëllimi, objektivat, statusi, forma ligjore dhe veprimtaria administrative, etj, nuk ka dokumente apo dosje për gjurmë faktike të ndjekur prej tyre për vitin 2024 dhe 10 mujorin 2025.  <b>Kriteri:</b> - Neni 4/19 dhe neni 16, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, përcaktojnë përkufizimin për gjurmën e auditimit dhe detyrimin për përgatitjen e gjurmës së auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë.

	<p>- Neni 2, i Kodit të Procedurave Administrative (Ligji nr. 44/2015) përcaktojnë fushën e zbatimit të këtij ligji, në të cilën detyrimisht përfshihet edhe ky institucion publik;</p> <p>- Neni 5, i Kodit të Procedurave Administrative përcakton parimin e transparencës gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative.</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Mungesa e miratimit të gjurmës së auditimit të gjitha Drejtorit dhe sektorët në DPPI, shoqëruar me mungesën e një praktike të mirë, ka ndikuar në mungesën e një procedure të hapur e transparente të lënies së gjurmës.</p> <p><b>Shkak:</b> Mungesa e trajnimeve të punonjësve lidhur me Ligjin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Manualin në zbatim të tij; si dhe lidhur me tërësinë e akteve të tjera ligjore të cilat aplikohen në veprimtarinë e administratës publike.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut</b>	I Mesëm
<b>Konkluzioni</b>	<p>Gjatë auditimit u konstatua mungesa e gjurmës specifike të auditimit në institucion, edhe mungesa e një praktike të mirë të ndjekur më parë, nuk ka garantuar transparencë gjatë aktivitetit vjetor të vitit 2024 dhe 10 mujorit 2025. Strukturat e DPPI-së, nuk kanë një gjurmë auditimi të ndjekur apo miratuar nga drejtoritë dhe sektorë të tjerë të saj, nuk ka dokumente apo dosje për gjurmë faktike të ndjekur për aktivitetet ushtrimore, nuk është vendosur në dispozicion të audituesit shkresë apo dokumenta që kanë të bëjnë me detyrimin për përgatitjen e gjurmës së auditimit për procedura që lidhen me veprimtarit kryesore duke filluar nga planifikimi, miratimi, realizimi, monitorimi, etj, lidhur me veprimtarinë e drejtorive të dhe sektorëve, e të tjerë të DPPI-së.</p> <p>Mos kryerja e vetëkontrollit (kontrolli i brendshëm) etj, ka bërë që mundësia e ndodhjes së anomaliteteve, për pasojë edhe ndikimi të jetë i tillë, pra duke ruajtur nivelin e riskut të lartë në vazhdimësi, prandaj në zbatim të aktiviteteve të kontrollit të brendshëm, është i domosdoshëm miratimi i gjurmës specifike të auditimit për çdo drejtori nga Titullari.</p>
<b>Rekomandimi</b>	Të ngrihet grupi i punës për hartimin e gjurmës së auditimit për çdo drejtori, dhe çdo strukturë përgjegjëse në DPPI, si dhe të miratohet nga Titullari Gjurma e Auditimit.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	<i>Menjëherë</i>

Statusi i rekomandimit	Gjetja dhe rekomandimi nuk ndryshon
------------------------	-------------------------------------

## V. Rekomandimet.

Në përfundim të procesit të vlerësimeve të bëra nga grupi i auditimit, bazuar në germën “c” të nenit 6, dhe germën “e” të nenit 16, të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, të ndryshuar, për arritjen e objektivave të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, si dhe për të rritur efektivitetin në punën, funksionimin dhe drejtimin e këtij institucioni, referuar trajtimit të gjetjeve, janë lënë për zbatim 22 (njëzetë e dy) rekomandime.

Grupi i auditimit falënderon njësinë e audituar për bashkëpunimin e mirë dhe shpreh konsideratën për gatishmërinë e stafit dhe ndihmën e dhënë për kryerjen e angazhimit të auditimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale brenda 30 ditësh, duhet të hartojë dhe miratojë Planin e Veprimit në zbatim të rekomandimeve të lëna dhe të njoftojë Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm.

***Bashkëlidhur Raportit Aneksi 1 “Rekomandimet” dhe Aneksi 2 “Observacionet”, si dhe Plani i sugjeruar i masave.***

***Raporti Përfundimtar i Auditimit hartohet në 3 (tri) kopje, një prej të cilave i dërgohet subjektit të audituar (DPPI); një kopje administrohet në zyrën e protokollit të Ministrinë së Ekonomisë dhe Inovacionit dhe një kopje administrohet në dosjen korente të këtij angazhimi auditimi, në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm.***

**Grupi i auditimit**

Festim Ibrahim

Aida Gegaj

## PËRMBLEDHËSE E REKOMANDIMEVE

Nr.	REKOMANDIMET	Niveli i Riskut
1	<p>-Strukturat përgjegjëse të DPPI-së, duhet të ndjekin objektivat e marra të dy projektligjeve, kthimin dhe miratimin e tyre në dy ligje të veçanta dhe shoqërimin me rregulloret përkatëse, për Treguesit gjeografik dhe emërtimet e origjinës si dhe për Disenjot, në përputhje me aktet e Bashkimit Evropian.</p> <p>-Të merren masa për sigurimin e aplikimeve jo vetëm elektronikisht në sistemin unik qeveritar e-albania, por edhe fizikisht të printuar të protokolluara dhe të ruajtura në arkivën e institucionit, si dhe krijimin eambjenteve për këtë qëllim.</p>	I mesëm
2	<p>-DPPI me strukturat e saj, duhet të synojnë nivele të larta të realizimit të fondeve në dispozicion sipas artikujve ekonomik buxhetor, programeve të detajuara për shpenzime korrente dhe të projekteve për shpenzime kapitale të cilat transferohen prej disa vitesh duke krijuar gjendje të lartë të mjeteve monetare.</p> <p>-DPPI në bashkëpunim me strukturat e ministrisë përgjegjëse, duhet të kenë në vëmendje raportimet mbi zbatimin e buxhetit, të marrin masa për menaxhimin e fondeve të papërdorura, brenda vitit ushtrimor.</p>	I mesëm
3	<p>-Të përgatitet informacion shtesë në lidhje me parashikimin e realizimit të pritshëm të buxhetit të miratuar me shpenzimet e realizuara, në vëmendje të strukturës së financës dhe buxhetit, gjatë raportimit 8 mujor të vitit buxhetor 2026 dhe vijues.</p>	I mesëm
4	<p>-Të bëhet shpallja e gjithë vendeve vakante në Buletin e Njoftimeve Publike dhe faqen zyrtare të institucionit,si dhe të rishikohen nenet e rregullores së brendshme dhe të përcaktohen kriteret e punësimit, i cili duhet të përcaktojë saktë procedurat e rekrutimit nëpërmjet procedurave të konkurimit publik.</p> <p>- Të bëhet marrja e punonjësve në punë me kontratë të përkohshme në përpjestim të drejtë me numrin total të organikës së re.</p>	I Mesëm
5	<p>-Drejtoria e financës dhe shërbimeve, personi përgjegjës për personelin të marrin masa dhe të përditësojnë dosjet e personelit në përputhje me të gjitha kërkesat e akteve në fuqi.</p>	I Mesëm
6	<p>-Strukturat përgjegjëse të marrin masa për hapjen e regjistri themeltar i punonjësve, i protokolluar dhe me numër rendor dhe total të faqeve, i cili jep siguri dhe nuk lejon ndërhyrje në regjistër, ndryshime apo falsifikime të akteve të prodhuara të regjistruara për punonjësit në vite.</p>	I Mesëm

	-Dorëzimi i dokumentacionit të kandidatëve të interesuar për vendet vakante të shpallura nga institucioni, të administrohet edhe nga zyra e protokollit në çdo rast nëpërmjet dokumentimit me numrin përkatës të protokollit.	
7	-Të rishikohen listëpagesat e ardhshme për të përjashtuar kategoritë e përkohshme, duke u mbështetur vetëm në kriteret e miratuara në VKMB, dhe të identifikohen shkaqet (llogaritje gabim, shtesa jo të arsyetuara) dhe të merren masa për arkëtimin e shumës 91,878 lekë përfituar në kundërshtim me aktet ligjore. -Të kërkohet menjëherë dokumentacioni që mungon për punonjësit dhe nëse nuk plotësohet, të kthehen pagesat e përfituara. Gjithashtu të rishikohet kontrata për këshilltarë të jashtëm sipas VKM-së dhe të argumentohet marrja e tyre në punë, si dhe pagesa mujore të përcaktohet në masën 110,000 lekë/muaj.	I lartë
8	-Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nën dhe mbi 100,000 lekë, duhet të kryejë testimin e tregut në teren, dhe të dokumentojë treguesit e çmimeve në një procesverbal, si dhe të bëjë përcaktimin e saktë të fondit limit për blerjet me vlera të vogla.	I Mesëm
9	-Të merren masa për çdo procedurë prokurimi të mbahet raporti përmbledhës dhe miratimi nga titullari i autoritetit kontraktor.	I Mesëm
10	-Marrja në dorëzim e mallrave dhe shërbimeve nga operatorët ekonomik fitues, të bëhet sipas përcaktimeve të specifikimeve teknike në ftesën për ofertë dhe kushteve të kontratës, nga komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave. -Nëpunësi zbatues, përgjegjësi i financës dhe komisioni i pritjes së mallit, duhet të përditësohen me përcaktimet e akteve ligjore/nënligjore në fuqi; veçanërisht me aktet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollin, si dhe në fushën e menaxhimit të aktiveve në njësitë e sektorit publik.	I lartë
11	-Të dorëzohet nga çdo operator ekonomik në zyrën e protokollit dokumentacioni i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor me procesverbal, në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë.	I mesëm
12	-Të krijohet një praktikë e mirë e protokollimit të gjithë dokumenteve të çdo procedure prokurimi, dorëzimin dhe protokollimin e dokumentave të kërkuara OE-së, si dhe inventarizimi për arkivën i dosjeve të prokurimeve. -Të administrohen në një dosje të veçantë dokumentet e procedurës së prokurimit, dosje të cilat duhet të arkivohen për llogari të çdo viti ushtrimor, si dhe trajnimi i punonjësit të ngarkuar me detyrën e personit përgjegjës dhe sekretari-arkivit.	I mesëm

13	<p>-Strukturat përgjegjëse të marrin masa të menjëhershme që në DST dhe në kushtet e kontratës të përcaktohen datat e takimeve, ndersa marrja në dorëzim dhe afatet e monitorimit të kontratave si dhe likuidimi, duhet të jenë në përputhje me dokumentet dhe aktet përkatëse.</p> <p>-Të merren masat nga institucioni për arkëtimin e vlerës 153,626 lekë nga OE “Optima Communication” shpk Tiranë, i cili ka shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.</p>	I lartë
14	<p>-Të bëhet hyrje në magazinë sipas zërave të standës vlera e munguar prej 1,782,000 lekë, të evitohen pagesat e parakohshme nga financa, komisioni i monitorimit të mos nënshkruaj në mënyrë fiktive pa marrë pjesë në panair dhe pa dokumente justifikuese.</p> <p>-Në të gjitha panairt e organizuara, AK për çdo kontratë të krijoj komision të marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve, të bëhen hyrje artikujt e kthyer dhe të pa përdorur, veprime që kanë krijuar efekt financiar negativ në buxhet në vlerën 6,331,980 lekë, vlerë e cila institucioni e përdorte për pritje përcjellje dhe evente të tjera vijuese.</p>	I lartë
15	<p>-Të administrohen në një dosje të veçantë dokumentet e procedurës së prokurimit për prokurimet elektronike, dosje të cilat duhet të arkivohen për llogari të çdo viti ushtrimor, si dhe të mundësohet trajnimi i punonjësve të komisionit të blerjeve të vogla dhe punonjësit të ngarkuar me detyrën e sekretari-arkivit.</p>	I mesëm
16	<p>-Të gjitha urdhër transfertat e plotësuar për kalimet në bankë (BKT), përveç datës së veprimit të plotësohet edhe me numër rendor, të regjistrohen në ditaret financiare në mënyrë kronologjike sipas numërit rendor të shpenzimit të kryer, dhe faturat e subjektit të regjistrohen me datën e faturimit dhe jo me datën e likuidimit në bankë, gjithë aktivitetit ushtrimor të vitit kalendarik.</p>	I mesëm
17	<p>-Nëpunësi Zbatues dhe përgjegjësit i financës, të marrin masa, lidhur me paraqitjen për likuidim në kohë në BKT Tiranë, me Urdhër-transfertë për rastet e pagesave ndaj OE, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore dhe shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura.</p>	I mesëm
18	<p>-Të respektohet disiplina buxhetore, të shmanget risku për krijimin e detyrimeve të prapambetura, të kryhet analizë të shkaqeve dhe vonesave, të merren masa administrative/organizative/financiare ndaj përgjegjësve për dëmin ekonomik të shkaktuar në vlerën 463,731 lekë, vlerë e cila çdëmtohet, pas vlerësimit nga grupi punes të ngritur nga titullari.</p>	I lartë

	-Të kryhet menjëherë regjistrimi dhe raportimi i plotë i detyrimeve të prapambetura, të hartohet plan veprimi për likuidimin e detyrimeve brenda 30 ditëve nga faturimet në vijim të EPO-së, për të shmangur penalitete në të ardhmen, të forcohet monitorimi dhe të integrohet në sistemet e brendshme për të parandaluar përsëritjen.	
19	-Të plotësohen lëvizjet e automjetit me fletë-udhëtime të nënshkruar nga nëpunësi urdhërues dhe udhëtues, me datë nisje- kthimi dhe terheqje kuponi tatimor, si dhe të përcaktohet norma e konsumit të karburantit për mjetin e institucionit.	I mesëm
20	-Në asnjë rast magazinieri të mos lëshojë fletë-dalje, pa siguruar dokumentacionin e urdhër-dorëzimit, list shpërndarjes për nevojat ditore, planin e shpërndarjes dhe procesverbalin e konsumit apo përdorimit të artikujve, strukturat përgjegjëse duhet të përditësohen me përcaktimet e akteve ligjore/nënligjore, në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollin dhe menaxhimit të aktiveve në njësitë e sektorit publik.	I mesëm
21	-Të hartohet dhe miratohet Rregullore për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe Rregullore të brendshme të këshillit mbikqyrës, për të përmirësuar funksionimin dhe organizimin e brendshëm dhe respektuar vlerat e për të penguar interesat personale të administratës së Dppi-së.	I mesëm
22	-Të ngrihet grupi i punës për hartimin e gjurmës së auditimit për çdo drejtori, dhe çdo strukturë përgjegjëse në DPPI, si dhe të miratohet nga Titullari Gjurma e Auditimit.	I mesëm

**Grupi i auditimit**

Festim Ibrahim

Aida Gegaj

## Model plan veprimi mbi zbatimin e rekomandimeve në DPPI

Nr. Rek	Rekomandimet	Renditja sipas nivelit	Referenca e paragrafit në raport	Reagimi i menaxhimit të subjektit të audituar	Afati i përcaktuar	Personat përgjegjës për realizimin e rekomandimeve
1	<p>- Strukturat përgjegjëse të DPPI-së, duhet të ndjekin objektivat e marra të dy projektligjeve, kthimin dhe miratimin e tyre në dy ligje të veçanta dhe shogërimin me rregulloret përkatëse, për Treguesit gjeografik dhe emërimet e origjinës si dhe për Disenjojt, në përputhje me aktet e Bashkimit Evropian.</p> <p>- Të merren masa për sigurimin e aplikimeve jo vetëm elektronikisht në sistemin unik qeveritar e-albania, por edhe fizikisht të printuar të protokolluara dhe të ruajtura në arkivën e institucionit, si dhe krijimin eambjenteve për këtë qëllim.</p>	I Mesëm	Çështja IV.1; Vlersimi i Përpunshmërisë dhe Funksionimi kontrollit të brendshëm Gjetja nr. 1		Brenda vitit 2026	
2	<p>- DPPI me strukturat e saj, duhet të synojnë nivele të larta të realizimit të fondeve në dispozicion sipas artikulive ekonomik buxhetor, programeve të detajuara për shpenzime korrente dhe të projekteve për shpenzime kapitale të cilat transferohen prej disa vitesh duke krijuar gjendje të lartë të mjeteve monetare.</p> <p>- DPPI në bashkëpunim me strukturat e ministrisë përgjegjëse, duhet të kenë në vëmendje raportimet mbi zbatimin e buxhetit, të marrin masa për menaxhimin e fondeve të papërdorura, brenda vitit ushtrimor.</p>	I Mesëm	Çështja IV.2; Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm Gjetja nr. 1		Për çdo vit ushtrimor	
3	<p>- Të përgatitet informacion shtesë në lidhje me parashikimin e realizimit të prishëm të buxheit të miratuar me shpenzimet e realizuara, në vëmendje të struktures së financës dhe buxhetit, gjatë raportimit 8 mujor të vitit buxhetor 2026 dhe vijues.</p>	I Mesëm	Çështja IV.2; Gjetja nr. 2		Për çdo vit ushtrimor	
4	<p>- Të bëhet shpallja e gjithë vendeve vakante në Buletin e Njoftimeve Publike dhe fagen zyrtare të institucionit, si dhe të rishikohen nenet e rregullores së brendshme dhe të përcaktohen kriteret e punësimit, i cili duhet të përcaktojë saktë procedurat e rekrutimit nëpërmjet procedurave të</p>	I Mesëm	Çështja IV.4; Sistemi i Pagave dhe Menaxhimi i burimeve njerëzore Gjetja nr. 1		Menjeherë dhe në vijimësi	

	<p>konkurimit publik.</p> <p>- Të bëhet marrja e punonjësve në punë me kontratë të përkohshme në përpjesitim të drejtë me numrin total të organikës së re.</p>					
5	<p>- Drejtoria e financës dhe shërbimeve, personi përgjegjës për personelin të marrin masa dhe të përditësojnë dosjet e personelit në përputhje me të gjitha kërkesat e akteve në fuqi.</p>	I Mesëm	Çështja IV.4; Gjejtja nr. 2		Deri në gusht 2026	
6	<p>- Strukturat përgjegjëse të marrin masa për hapjen e regjistri themeltar i punonjësve, i protokolluar dhe me numër rendor dhe total të faqeve, i cili jep siguri dhe nuk lejon ndërhyrje në regjistrë, ndryshime apo falsifikime të akteve të prodhuara të regjistruara për punonjësit në vite.</p> <p>- Dorëzimi i dokumentacionit të kandidatëve të interesuar për vendet vakante të shpallura nga institucioni, të administrohet edhe nga zyra e protokollit në çdo rast nëpërmjet dokumentimit me numrin përkatës të protokollit.</p>	I Mesëm	Çështja IV.4; Gjejtja nr. 3		Brenda vitit 2026	
7	<p>- Të rishikohen listëpagesat e ardhshme për të përjashtuar kategoritë e përkohshme, duke u mbështetur vetëm në kriteret e miratuara në VKMB, dhe të identifikohen shkaqet (logaritje gabim, shtesa jo të arsyetuar) dhe të merren masa për arketimin e shumës 91,878 lekë përfituar në kundërshtim me aktet ligjore.</p> <p>- Të kërkohet menjëherë dokumentacioni që mungon për punonjësit dhe nëse nuk plotësohet, të kthehen pagesat e përfituara. Gjithashtu të rishikohet kontrata për këshiltarë të jashtëm sipas VKM-së dhe të argumentohet marrja e tyre në punë, si dhe pagesa mujore të përcaktohet në masën 110,000 lekë/muaj.</p>	I lartë	Çështja IV.4; Gjejtja nr. 4		Menjëherë dhe në vijimësi	
8	<p>- Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nën dhe mbi 100,000 lekë, duhet të kryejë testimin e tregut në teren, dhe të dokumentojë treguesit e çmimeve në një procesverbal, si dhe të bëjë përcaktimin e saktë të fondit limit për blerjet me vlera të vogla.</p>	I Mesëm	Çështja IV. 5; Sistemi i Prokurimeve Gjejtja nr. 1		Menjëherë dhe në vijimësi	

<p><b>9</b></p> <p>- Të merren masa për çdo procedurë prokurimi të mbahet raporti përmbledhës dhe miratimi nga titullari i autoritetit kontraktor.</p>	I Mesëm	Çështja IV.5; Gjetja nr. 2		Në vijimësi	
<p><b>10</b></p> <p>- Marrja në dorëzim e mallrave dhe shërbimeve nga operatorët ekonomik fitues, të bëhet sipas përcaktimeve të specifikimeve teknike në ftesën për ofertë dhe kushteve të kontratës, nga komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave.</p> <p>- Nëpunësi zbatues, përgjegjësi i financës dhe komisioni i pritjes së mallit, duhet të përditësohen me përcaktimet e akteve ligjore/nënligjore në fuqi; veçanërisht me aktet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollin, si dhe në fushën e menaxhimit të aktiveve në njësitë e sektorit publik.</p>	I lartë	Çështja IV.5; Gjetja nr. 3		Menjherë dhe në vijimësi	
<p><b>11</b></p> <p>- Të dorëzohet nga çdo operator ekonomik në zyrën e protokollit dokumentacioni i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor me procesverbal, në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë.</p>	I Mesëm	Çështja IV. 5; Gjetja nr. 4		Menjherë	
<p><b>12</b></p> <p>- Të krijohet një praktikë e mirë e protokollimit të gjithë dokumenteve të çdo procedure prokurimi, dorëzimin dhe protokollimin e dokumentave të kërkuara OE-së, si dhe inventarizimi për arkivën i dosjeve të prokurimeve.</p> <p>- Të administrohen në një dosje të veçantë dokumentet e procedurës së prokurimit, dosje të cilat duhet të arkivohen për llogari të çdo viti ushtrimor, si dhe trajnimi i punonjësit të ngarkuar me detyrën e personit përgjegjës dhe sekretari-arkivit.</p>	I Mesëm	Çështja VI.5; Gjetja nr. 5		Menjherë dhe në vijim	
<p><b>13</b></p> <p>- Strukturat përgjegjëse të marrin masa të menjëhershme që në DST dhe në kushtet e kontratës të përcaktohen datat e takimeve, ndërsa marrja në dorëzim dhe afatet e monitorimit të kontratave si dhe likuidimi, duhet të jenë në përputhje me dokumentet dhe aktet përkatëse.</p> <p>- Të merren masa nga institucioni për arkëtimin e vlerës 153,626 lekë nga OE “Optima Communication” shpk Tiranë, i cili ka shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.</p>	I lartë	Çështja IV. 5; Gjetja nr. 6		Brenda vitit ushtrimor	

<p><b>14</b></p> <p>- Të bëhet hyrje në magazinë sipas zërave të stendës vlera e munguar prej 1,782,000 lekë, të evitohen pagesat e parakohshme nga financa, komisioni i monitorimit të mos nënshkruaj në mënyrë fiktive pa marrë pjesë në panair dhe pa dokumente justifikuese.</p> <p>- Në të gjitha panairt e organizuara, AK për çdo kontratë të krijoj komision të marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve, të bëhen hyrje artikujt e kthyer dhe të pa përdorur, veprime që kanë krijuar efekt financiar negativ në buxhet në vlerën 6,331,980 lekë, vlerë e cila institucioni e përdorte për prirje përcjellje dhe evente të tjera vijuese.</p>	I Lartë	Çështja IV. 5; Gjetja nr. 7	Menjêherë dhe në vijim	
<p><b>15</b></p> <p>- Të administrohen në një dosje të veçantë dokumentet e procedurës së prokurimit për prokurimet elektronike, dosje të cilat duhet të arkivohen për llogari të çdo viti ushtrimor, si dhe të mundësohet trajnimi i punonjësve të komisionit të blerjeve të vogla dhe punonjësit të ngarkuar me detyrën e sekretari-arkivit.</p>	I mesëm	Çështja IV. 5; Gjetja nr. 8	Në vijim	
<p><b>16</b></p> <p>- Të gjitha urdhër transfertat e plotësuar për kalimet në bankë (BKT), përveç datës së veprimit të plotësohet edhe me numër rendor, të regjistruhen në ditarët financiarë në mënyrë kronologjike sipas numërit rendor të shpenzimit të kryer, dhe faturat e subjektit të regjistruhen me datën e faturimit dhe jo me datën e likuidimit në bankë, gjithë aktivitetit ushtrimor të vitit kalendarik.</p>	I mesëm	Çështja VI. 6; Sistemi i Pagesave Gjetja nr. 1	Menjêherë dhe në vijimësi	
<p><b>17</b></p> <p>- Nëpunësi Zbatues dhe përgjegjësit i financës, të marrin masa, lidhur me paraqitjen për likuidim në kohë në BKT Tiranë, me Urdhër-transfertë për rastet e pagesave ndaj OE, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore dhe shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura.</p>	I mesëm	Çështja VI. 6; Gjetja nr. 2	Menjêherë	
<p><b>18</b></p> <p>- Të respektohet disiplina buxhetore, të shmanget risku për krijimin e detyrimeve të prapambetura, të kryhet analizë të shkaqeve dhe vonesave, të merren masa administrative/organizative/financiare ndaj përgjegjësve për dëmin ekonomik të shkaktuar në vlerën 463,731 lekë, vlerë e cila çdëmtohet, pas vlerësimit nga grupi punes të ngritur nga titullari.</p> <p>- Të kryhet menjêherë regjistrimi dhe raportimi i plotë i detyrimeve të</p>	I Lartë	Çështja VI. 7; Sistemi për kontabilitetin, raportimi finaciar, menaxhimi e aktiveve, detyrimet	Sipas rekomandi mit deri në muajin shtator	

	<p>prapambetura, të hartohet plan veprimi për likuidimin e detyrimeve brenda 30 ditëve nga fatumet në vijim të EPO-së, për të shmangur penalitete në të ardhmen, të forcohet monitorimi dhe të integrohet në sistemet e brendshme për të parandaluar përsëritjen.</p>		Gjetja nr. 1		2026	
19	<p>- Të plotësohen lëvizjet e automjetit me fletë-udhëtime të nënshtuar nga nëpunësi urdhërues dhe udhëtues, me datë nisje- kthimi dhe terheqje kuponi tatomor, si dhe të përcaktohet norma e konsumit të karburantit për mjedin e institucionit.</p>	I mesëm	Çështja VI. 7; Gjetja nr. 2		Në vijim	
20	<p>- Në asnjë rast magazinieri të mos lëshojë fletë-dalje, pa siguruar dokumentacionin e urdhër-dorëzimit, list shpendarjes per nevojat ditore, planin e shpendarjes dhe procesverbalin e konsumimit apo përdorimit të artikujve, strukturat përgjegjëse duhet të përditësohen me përcaktimet e akteve ligjore/nënligjore, në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollin dhe menaxhimit të aktiveve në njësitë e sektorit publik.</p>	I mesëm	Çështja VI. 7; Gjetja nr. 3		Në vijim	
21	<p>- Të hartohet dhe miratohet Rregullore për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe Rregullore të brendshme të kështillit mbikqyrës, për të përmirësuar funksionimin dhe organizimin e brendshëm dhe respektuar vlerat e për të penguar interesat personale të administratës së Dppi-së.</p>	I mesëm	Çështja VI. 8; Vlerësimi i komponentëve të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit Gjetja nr. 1		Deri në muajin Korrik 2026	
22	<p>- Të ngrihet grupi i punës për hartimin e gjurmës së auditimit për çdo detygjori, dhe çdo strukturë përgjegjëse në DPP1, si dhe të miratohet nga Titullari Gjurma e Auditimit.</p>	I mesëm	Çështja VI. 8; Gjetja nr. 2		Menjëher ë	

Mbyllet me nr. 22 (njëzet e dy).

*F. Shalini*  
*F. Sesi*